

**ROLI I LIGJËRIMIT FETAR TË KLERIKËVE  
MYSLIMANË NË TOLERANCËN, HARMONINË DHE  
BASHKËJETESËN FETARE NË SHQIPËRI GJATË VITEVE  
1912-1945**

**AHMED KALAJA**

Dorëzuar  
Universitetit Europian të Tiranës  
Shkollës Doktorale


Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës

Antropologji Kulturore, me profil doktorant, për marrjen e gradës shkencore  
“Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Aleksandër Dhima

Numri i fjalëve: 50.110

Tiranë, Tetor 2017



## **DEKLARATA E AUTORËSISË**

Unë deklaroj se studimi është punë origjinale e imja dhe informacioni në këtë punim është marrë dhe paraqitur në përputhje me rregullat akademike dhe sjelljen etike.

Unë, gjithashtu deklaroj që, siç edhe kërkohet nga këto rregulla dhe sjellje, kam cituar dhe referuar të gjitha materialet dhe rezultatet që nuk janë origjinale në këtë punim.

## **ABSTRAKTI**

Toleranca dhe harmonia fetare në Shqipëri është një fakt i njohur edhe përtej kufijve të vendit tonë. Popullsia muslimane me dy komunitetet e saj, sunitët dhe bektashijtë dhe ajo e krishterë me dy komunitetet e saj, katolike dhe ajo ortodokse në Shqipëri bashkëjetojnë në harmoni të plotë ndër shekuj pa cënuar besimet përkatëse dhe kjo përkatësi nuk ka penguar në asnjë rast bashkimin dhe bashkëpunimin e tyre sidomos për interesa kombëtare.

Po cili ka qënë roli i ligjërimit fetar të klerikëve muslimanë në tolerancën dhe harmoninë fetare në Shqipëri ? Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje jemi fokusuar në ligjërimet fetare të klerikëve muslimanë në periudhën 1912 deri në vitin 1945. Zgjedhja e kësaj periudhe është bërë duke mbajtur në konsideratë vitin 1912 si vit i krijimit të shtetit Shqiptar që daton me shpalljen e pavarësisë duke vazhduar me periudhën e mbretit Zog, kur filloi të konsolidohej një shtet laik. Në të njëjtën kohë vetë komuniteti musliman shqiptar konstituohet institucionalisht, krejtësisht i pavarur nga ndikimet e mëparshme osmane. Analiza jonë shtrihet deri në vitin 1945, vit në të cilin diktatura komuniste u vendos në vendin tonë. Arsyeja përse jemi kufizuar deri në vitin 1945 lidhet me faktin se pas kësaj periudhe ndikimi i diktaturës komuniste fillon të tkurrë, deri sa e eliminon plotësisht, rolin e besimit në shoqëri.

Metodologjia e përdorur për këtë kërkim është cilësore, për faktin se shtrirja kohore i përket një periudhe të kaluar dhe jam fokusuar në botimet zyrtare të kohës, ku përfshihet botimet e Revistes “ Zani i Naltë” dhe pas mbylljes së kësaj reviste kam vijuar me botimet zyrtare të revistës "Drita Islame". Janë analizuar në mënyrë të detajuar të gjitha ligjërimet fetare dhe mesazhet e përcjella në popull, ku evidentohet qartë toni paqësor, toleranca ndërfitare dhe bashkëpunimi ndërmjet përfaqësuesve të klerit , sidomos sa i përket çështjeve madhore të kombit.

*Dedim*

*Prindërve të mi...*

## ***Mirënjohje***

*Do të doja të falenderoj ekipin dhe bordin e të gjithë profesorëve të Universitetit European për kontributin që japin në fushën e arsimit dhe edukimit. Unë shpreh falenderimin tim të sinqertë ndaj udhëheqësit tim Prof, dr Aleksandër Dhima për udhëzimet, ndihmën, kritikën, sugjerimet lidhur me këtë studim.*

*Për ata që kanë kontribuar me asistencën dhe këshillat, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ata meritojnë mirënjohjen time të madhe.*

*Së fundi do të doja të falënderoja fëmijët e mi, miqtë dhe kolegët, të cilët më kanë dhënë kurajon dhe motivimin për të përfunduar këtë studim.*

Ahmed Kalaja

## **TABELA E PËRMBAJTJES**

### **HYRJA**

- I. Toleranca dhe harmonia fetare në Shqipëri
- II. Identiteti, etnia, feja dhe politika
- III. A përbën feja identitet fetar apo social ndër shqiptarët?
- IV. Nacionalizmi, tiparet shqiptare
- V. Ligjërimi, toleranca, bashkëjetesa

### **KAPITULLI II**

- 2.1. Themelet teoriko-epistemologjike: konstruktivizmi dhe ndërtimi i subjektit shkencor
- 2.2 Hipoteza kryesore e studimit dhe nën-hipotezat
  - 2.2.1. Hipoteza
  - 2.2.2. Nën-Hipotezat
  - 2.2.3. Shqyrtimi i literaturës ekzistuese
- 2.3 Objektivat e kërkimit në terren
- 2.4. Struktura e punimit
  - 2.4.1. Metodologjia e ligjëritimit fetar në transmetimin e predikimeve fetare në institucionet shqiptare të kultit sot
  - 2.4.2. Metodatat e diskursit fetar (të ligjëritimit dhe predikimit fetar) në institucionet e kultit fetar (xhamitë)
- 2.5. Etimologjia e fjalës “tolerancë”
  - 2.5.1. A ka kufinj toleranca fetare?
  - 2.5.2 Gjenealogjitë e tolerancës
  - 2.5.3. Konturet e tolerancës
  - 2.5.4. Koncepti liberal i tolerancës
  - 2.5.5. Koncepti sjelljes dhe koncepti praktik i tolerancës
  - 2.5.6. Qëndrime mbi tolerancën

### **KAPITULLI III : KONTEKSTI HISTORIK**

- 3.1 Harmonia ndërfitare në shqipëri gjatë viteve 1912-1945

- 3.2 Nacionalizmi, kombësia dhe feja.
- 3.3 Kleri fetar dhe krijimi i Shtetit Shqiptar
- 3.4 Liderët myslimanë; Kontributi edhe roli i tyre në Kongresin e Lushnjës
- 3.5 Vazët, hytbet dhe artikujt në shërbim të misionit.
- 3.6 Jashtë objekteve të kultit edhe brezi i ri” .

## KAPITULLI IV

### MEDIA NË FORMIMIN E IDENTITETIT TONË KOMBËTAR NË VËTET 25-44

- 4.1 Zani i Naltë dhe ndikimi në tolerancë dhe harmoni
- 4.2 Revista “KULTURA ISLAME”
  - 4.2.1 Pasqyrimi i përvjetorëve të pavarësisë në shtypin fetar 1913-1944
  - 4.2.2 Revista “HYLLI I DRITËS”
  - 4.2.3 “Zani i Naltë” për flamurin
  - 4.2.4 Shtypi ortodoks
  - 4.2.5 Revista “LEKA”
  - 4.2.6 Revista “KULTURA ISLAME”
- 4.3.Roli i komunikimit përmes objekteve të kultit Islam në Shqipëri
  - 4.3.1 Roli i komunikimit përmes ligjërimeve te klerit katolik e orthodox

## KAPITULLI V: Analizë mbi tolerancën fetare në rang ndërkombëtar

- 5.1 Komunikimi ndërfetar në sytë e një të krishteri
- 5.2 Toleranca në fenë Islame dhe hulumtuesit e paanshëm të perëndimit.
- 5.3 In/ toleranca fetare dhe laike. Rast studimor
  - 5.3.1 Abuzivizmi me lirinë dhe konfliktet sociale përtej kufinjve shqiptarë

## KAPITULLI VI: Konkluzione dhe Rekomandime

## BIBLIOGRAFIA

SHTOJCE 1

SHTOJCE 2

SHTOJCË 3

## **HYRJE**

### **I. Toleranca dhe harmonia fetare në Shqipëri**

Feja ka depërtuar në shoqërinë shqiptare dhe ka lënë në të gjurmët e saj për bashkëjetesën dhe harmoninë fetare. Shqiptarët janë tolerantë ndaj besimit të tjetrit dhe jetojnë në një harmoni dhe pluralizëm fetar.

Teoritë e modernitetit perëndimor mbështesin në thelb *sekularizmin* dhe mbrojnë shtetin laik.<sup>1</sup> Megjithatë koncepti i *laicitetit* ka shfaqur disa kufizime thelbësore, pasi ai nuk mund të projektohet mbi të drejtat dhe liritë vetjake. Ky studim do të fokusohet tek studimi i mendimit sociologjik fetar në Shqipëri, duke hulumtuar mënyrën e ndërtimit historik të ndërjegjes kolektive fetare shqiptare, përkundëjt laicizmit si pjesë integrale e identitetit kombëtar. Ai ka si qëllim parësor të kuptojë shkallën e përnjëmendte të tolerancës dhe harmonisë fetare në Shqipëri, praninë dhe mungesën e tensioneve midis laicitetit dhe fesë, të cilat intensifikohen ose zbehen në periudha të ndryshme historike. Këto raporte mund të mos absorbohen me kalimin e kohës, por akumulohen duke kufizuar gjithmonë e më tepër hapësirat e bashkëjetesës.

Duke synuar të studiojmë ndërtimin historiko-sociologjik të këtij fenomeni në Shqipëri, studimi shqyrton projektimin e fesë në shoqërinë shqiptare duke marrë përsipër të studiojmë ligjërimin e revistës “Zani i Naltë”, organ i Komunitetit Mysliman Shqiptar në vitet 1920-’30. Qëllimi është ndërtimi konstruktivist i kësaj dukurie në rastin e Shqipërisë. Përmes interpretimit konstruktivist të ligjërimin mund të kuptohet më mirë kontributi historik dhe identitar i komunitetit fetar mysliman tek harmoninë fetare dhe bashkëjetesa në Shqipëri.

### **II. Identiteti, etnia, feja dhe politika**

---

<sup>1</sup> Popper, Karl (1966). *The Open Society And Its Enemies*. London: Routledge, vol 1-2.



Procesi i formimit etnik dhe ndarja e kufijve gjeografikë të shteteve ballkanike në fund të shekullit të XIX-të dhe fillim të shekullit të XX-të krijoi pashmangshmërisht një numër minoritetesh fetare, të detyruara të akomodoheshin brenda shumicave fetare. Kështu, bullgarët kishin dhe ende kanë minoritete myslimane në proporcion të njëjtë me minoritetin fetar që nuk i përkasin edhe etnisë Bullgari.<sup>2</sup> Edhe brenda Greqisë u krijuan një numër minoritetesh fetare, etnike, gjuhësore. Serbia gjithashtu pati minoritete fetare, por të gjitha këto vende e mbështetën luftën për pavarësi nga Perandoria Osmane tek identiteti dhe përkatësia e tyre fetare, shpesh duke ushtruar genocid apo shpërngulje ndaj minoritetve të tyre fetare me gjuhë të përbashkët.<sup>3</sup> *Pyetja themelore kërkimore që shtrohet është përse rilindësit nuk e ngritën identitetin e Shqipërisë mbi një identitet fetar?* Në përgjigje të kësaj pyetjeje fundamentale historike janë shpërfaqur një sërë qasjesh që ndryshojnë thelbësisht nga njëra-tjetra.<sup>4</sup>

Identiteti shqiptar përbën një rast të veçantë studimor. Shqipëria ka përbërje etnike homogjene, ndërsa raportet fetare midis shumicës dhe pakicave fetare nuk ngërthehen në ndarje etnike. Përfaqësuesit e etnive të tjera në Shqipëri nuk janë dominantë në asnjë besim, por përfshihen secili sipas besimit të tij në komunitetin e tij fetar përkatës. Për këtë arsye feja nuk ka qenë historikisht tipar identifikues dhe diferencues ndër shqiptarë.<sup>5</sup> Shqiptarët ishin një shoqëri multifetare dhe një komb kompakt. Për këtë arsye çështjen kombëtare e shihnin të gjithë njëjloj si pjesë e të njëjtës etni ndërsa fenë si zgjedhje personale.<sup>6</sup> Hulumtimi i etapave historike nëpër të cilat ka kaluar sendërtimi i shtet-kombit shqiptar, nga Lidhja e Prizrenit deri tek Shpallja e Pavarësisë, e cila ishte përmbushja e qëllimit klerikët e të gjitha besimeve kanë marrë pjesë aktive në to me emra e personalitete eminentë në fushën e besimit. Pikërisht marrja në konsideratë e kësaj performace historike përbën bazën e analizës së këtij studimi.

---

2. Max Weber et Emile Durkheim, religionene verstehen, Viesbaden:verlag fur sozialwissenschaften, 2011,p.41-91

3. MWG I/22-2, p. 121 ; trad. fr. (2005), p. 79.

4 Tyrell (2008).

5. Cf. Tyrell (2003), p. 216 sq.

Feja ishte tabu tek shqiptarët deri para dy dekadash, ndërsa ekzistojnë premisat që e trajtojnë atë ende si tabu. Ky është një nga elementet e shumtë që tregon se harmonia fetare është e njëanshme dhe kërkohet që të respektohet nga autoritetet fetare, por jo domosdoshmërisht nga ato laike (në këtë aspekt nga këtej e tutje ateistët do të trajtohen si besimtarë, sepse besojnë në diçka që nuk mund ta provojnë empirikisht, pra ata besojnë në mosegzistencën e Zotit) dhe është pjesë e ligjërimit sekularist në vend.

Feja ka depërtuar në shoqërinë shqiptare dhe ka lënë në të gjurmët e saj për bashkëjetesën dhe harmoninë fetare. Shqiptarët janë tolerantë ndaj besimit të tjetrit dhe jetojnë në një harmoni dhe pluralizëm fetar, duke u nisur nga ndarja e parë e tyre, ortodoksë-katolikë e duke ardhur më vonë tek islami. Nëse do kishte qënë vetëm njëra nga fetë që do kishte luajtur rol në këtë pikë atëherë bashkëjetesa do kishte qënë e vështirë. Por dhe duke mos kontribuar qoftë edhe njëra nga fetë apo ndarjet fetare në vend, bashkëjetesa do kishte qënë e pamundur ose e vështirë. Megjithatë në këtë studim do të studiojmë dhe nxjerrim më në pah atë pjesë të viteve të Pasluftës së Parë Botërore e cila është më pak e eksploruar në rrafshin social, fetar, politik dhe ideologjik.

Natyrisht, mbas Luftës së Dytë Botërore ishte detyrë e sistemit komunist, si fitimtar dhe qeverisës i vetëm i vendit, që të studionte me vëmendje, të kishte fjalën e tij dhe të merrte përsipër sqarimin e kësaj periudhe historike. Jo se studime të historisë shqiptare kanë munguar, por sepse për këtë periudhë sistemi komunist ruante stigmën më të lartë në gjithë historinë e vendit me një lloj armiqësie, pasi shumë nga idetë dhe njerëzit që sistemi/regjimi goditi, vrau burgosi dhe internoi, kishin qënë personazhe të kësaj periudhe. Ky regjim përdori gjithë aparatën e tij shtetëror për të ruajtur dhe krijuar një mjegullnajë rreth kësaj periudhe, pra të viteve kur në pushtet ishte Ahmet Zogu. Por sa më shumë që shkëputemi nga kjo periudhë aq më shumë boshllëqe krijojmë për perceptimin kulturor të saj si dhe problemin që lind me perceptimin kulturor dhe se si kanë ndikuar tek shqiptarët periudha të caktuara historike. Besoj se 50 vjet boshllëk mbi këtë temë dhe këtë periudhë kanë qënë të tepruara. Sistemi shkoi aq larg sa të ndalonte të vetmin kujtim që të lidhte me këtë periudhë, fenë.

Nëse ne nuk bëjmë përpjekjet tona për këtë periudhë dhe në çështjet e bashkëjetesës fetare të kësaj periudhe, atëherë do mbetemi po aq përgjegjës sa sistemi i kaluar, ku mund

të them se gjurmë të kësaj mendësie ndjehen tek të gjithë sot, për periudhën në fjalë që duam të vëzhgojmë. Natyrisht që traumat e një regjimi lipset të tejkalohen.

Teza se shqiptarët janë indiferentë ndaj fesë do të rrëzohej në Greqi më 1821–31, ku shqiptarët ortodoksë të Peloponezit, Atikës dhe Beotisë etj, ku shqiptarët ishin elementi kryesor përbërës i popullsisë, krijuan shtetin e parë shqiptar ortodoks të quajtur Greqi (J. Fallmerayer, 2003: 10).

Në letrën e Bajronit të dërguar nënës së tij thuhet se në Mesolongj të rrethuarit janë shqiptarë ortodoksë dhe rrethuesit shqiptarë myslimanë. Këta shqiptarë, të cilët ishin elementi kryesor në Greqinë e asaj kohe, të njohur si Arvanitas, pinjollët e të cilëve janë Arbëreshët e Italisë, e lanë identitetin e tyre shqiptar për shkak të një identiteti që tek ata kishte më shumë rëndësi, pra identitetin fetar. Për shkak të rëndësisë që kishte për ta identiteti fetar, ata braktisën gjuhën, cka i trembej Fallmerajeri (J. Fallmerayer, 2003: 25). Të tilla ngjarje me ndikim të madh kanë ndodhur kur njerëzit i kanë dhënë më shumë rëndësi një identiteti sesa një tjetri, duke bërë që njëri të mbizotërojë mbi tjetrin, siç ka qenë rasti i sirianëve, i berberëve që përvetësuan arabishten, apo i bullgarëve që përvetësuan sllavishten.

Megjithatë, siç thotë edhe Della Roka, "*a është e mundur që të mbrohet teza se shqiptarët historikisht të jenë ateistë apo në të kundërt të jenë fetarë? A është e mundur që të argumentohet shkencërisht një gjykim i tillë?*" (R.M. della Rocca, 1994: 7-8). Pra nuk mund të marrim raste të veçanta për të vërtetuar një teori të tillë si të tërë, nëse përdorim studime, me pyetësorë etj, sepse në çdo rast do kishim të bënim me një element aq delikat siç është besimi, saqë një studim i tillë do përbente abuzim që në nisje të tij. Ne, ndërkohë, mund të përqëndroheshim lirshëm në elementë përbërës historikë që mund të na plotësojnë tablonë, e një studimi, të cilën shumë njerëz, duke përfshirë dhe historianë, e kanë gjymtuar.

Gjithashtu në këtë aspekt vihet re karakteri atomist i shpjegimit të dukurive shoqërore në shoqërinë shqiptare. Është tërësia e elementëve të grupeve shoqërore që mund të çojë në shpjegimin e një fenomeni të caktuar në shoqëri. Në shoqërinë shqiptare mungesa e vështrimit holist në kuptimin e dukurive shoqërore i bën ato të çënueshme nga paragjykimi dhe keqinterpretimi jo dashakeq i fenomenit. Fenomenet shoqërore nuk mund

të shpjegohen si dukuri të veçanta të anëtarëve të saj që të përgjithësojë fenomenin, por si shumë e gjithë anëtarëve të grupit (Popper, 1966: 16). Kështu kur ne shohim procese të veçuara të një fenomeni në shoqërinë tonë, do të gabonim duke e thjeshtuar problematikën duke ia veshur fenomenin gjithë shoqërisë.

Nëse ne do të pohojmë se shqiptarët nuk e kanë marrë seriozisht fenën, prandaj ata kanë bashkëjetuar në një harmoni fetare, ne kemi lënë jashtë diskursit të gjitha pjesët si dhe individët e tjerë të grupit që formojnë shoqërinë shqiptare. Në këtë mënyrë, ne kemi dëmtuar shpjegimin e historisë dhe të fenomeneve të ndryshme brenda saj duke u gjendur të papërgatitur në shpjegimin e fenomeneve të reja që nuk u japim dot shpjegim nën dritën e shpjegimeve dhe teorive që kemi hedhur deri tani. Si fjala bie, si do e shpjegojmë faktin se përse me dhejtra dhe qindra shqiptarë po angazhohen më jetën e tyre në konfliktin e armatosur në Siri kundër qeverisë aktuale atje.

Një tjetër argument i rëndësishëm që bëhet pjesë e natyrshme e debatit është edhe ndihmesa e fesë në formimin e identiteteve në vendin tonë. Në shumë shoqëri ballkanike si në Greqi, Serbi, etj., feja ka qënë treguesi parësor i unitetit kombëtar.

Feja jo vetëm ka prodhuar një identitet kombëtar, por ka qënë dhe premisa e lindjes së nacionalizmit në këto vende. Herë-herë feja tek kombet e tjera ka qënë nismë i lindjes së konflikteve, të cilat duhet të quhen dhe konflikte fetare e jo vetëm etnike. Për këtë arsye në konfliktet Bosnjë-Serbi-Kroaci, ishte feja baza e formimit identitar dhe e konfliktit megjithëse banorët e këtyre vendeve flisnin të njëjtën gjuhë. Pra, gjuha mbërriti të depërtonte thellë në formimin identitar të këtyre vendeve. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për Greqinë. Ndërkohë, në Shqipëri feja nuk ishte pjesë e një konflikti të tillë dhe për këtë arsye shqiptarët gjetën të përbashkëtat e tyre brenda gjuhës.

Ky konflikt fetar i heshtur apo i munguar në vend, krijon përshtypjen e mungesës së vëmëndjes së fesë ndër shqiptarët, natyrisht kjo mund të krijojë përshtypjen apo të nxjerrë në pah shfaqjen e karakterit oportunist që karakterizon shqiptarët në lidhje me fenë. Pra duke mos përbërë tek ata veçse një mjet, ajo nuk mund të ishte e aftë të prodhonte konflikte me karakter fetar. Pra shqiptarët me shpirtin e tyre pragmatist i kanë përkatur një feje apo një tjetre dhe është diçka që mund të vazhdojnë ta bëjnë dhe në të ardhmen. Por nëse ne i përmbahemi një karakteri kaq simplicitist të shpjegimit të disa fenomeneve, atëherë çfarë i

shtyn shqiptarët pas periudhës komuniste të zgjojnë reagime fetare dhe të konvertohen në fe, reagime të cilat deri tani historiografia i ka trajtuar si mundësi oportuniste për shqiptarët?

Nëse shqiptarët do ishin oportunistë, nuk do kishte rizgjim të praktikantëve fetarë në vend pas diktaturës komuniste dhe teza se shqiptarët nuk e kanë marrë seriozisht fenë duhej të vihej në pikëpyetje shkencore se cilat janë të dhënat mbi të cilat bazohet teza për të projektuar ndryshimet në të ardhmen në një shoqëri. Për këtë arsye tradita e mospërplasjeve fetare, duhet kërkuar mbase diku tjetër dhe jo në kanlizimin historik që i bën një mendim i pambështetur në fakte, kësaj tradite. Kështu dalim dhe njëherë në përfundimin se është e pavënd që të shkëpusim nga konteksti simbiozën e ngjizur tjetërkund për të shpjeguar fenomene të shoqërisë në mënyrë autonome. Pra është *holizmi* ai që na vjen përsëri në ndihmë për të shpjeguar fenomenin duke studiuar grupin shoqëror në tërësi.

Shqiptarët janë pjesë e dy qytetërimeve abrahamike, atij të krishterë dhe atij islam, dhe përplasjet e këtyre qytetërimeve, ashtu siç supozohet nga studiues të caktuar, nuk kanë ndodhur në Shqipëri. Në Shqipëri kanë ndodhur përplasje ushtarake dhe shqiptarëve u është dashur politikisht të shohin me interes për vete animin politik të tyre sa në njërin krah, në tjetrin. Kështu në Shqipëri, siç edhe thotë një analist që me shfaqjen e Islamit, kanë ekzistuar dy rryma të mendimit politiko-shoqëror. Ata që ishin pro Papës, Skënderbegasit, pra Krishterimit, dhe ata që ishin pro Sulltanit, vasalistët, pra pro Islamit Pra, Skënderbeu që mendonte se e mira e vendit ishte me Krishterimin dhe Ballaban Pasha me Hamza Kastriotin që mendonin se të përkrahje perandorinë Otomane ishte më mirë për vendin megjithse Ferraj i përdor këto terma për të shprehur qasjen kombëtare që është shumë herët si periudhë për të thënë nëse ekzistonte në atë kohë një identitet kombëtar gjuhësor tek shqiptarët. Duke qenë se ata niseshin nga premisa "për të mirën e vendit", ne nuk kemi si i quajmë të dy palët veçse patriotë me koncepte të ndryshme politike. Në historinë e vendit tonë, këto figura duheshin ngritur gjithmonë si figura atdhetare dhe të dashura në të gjitha kohërat, por është interesant dhe krijon pak hilaritet fakti që njëra palë në historinë e vendit është sfumuar deri në harresë sa herë që pala tjetër ka triumfuar dhe triumfi ka përkuar me rritjen apo vënien e peshës politiko ekonomike të njërit prej dy qytetërimeve. I pari Skënderbeu për qindra vjet dhe tashmë Hamzai me Ballabanin në kushtet e rënies së

influcencës politike të botës islame. Pra, është e natyrshme që të gjejmë një formë agresiviteti ndaj atyre që i rizbulojnë këto figura historike, sikur ata të kishin kryer një blasfemi.

Gjithkush ka vendin e tij në histori dhe të lëmë jashtë historisë apo nën hijen historike njërën palë, do të thotë të mos ta integrosh si pjesë përbërëse të tëndën. Ka një mungesë të theksuar përvoja të caktuar në qasjen që i bëhet problemeve fetare dhe besimit, shumë studiues në Shqipëri i janë qasur çështjes së besimit me metoda sasiore. Jo vetëm për çështje që statistikisht plotësonin kuadrin e plotë të shifrave në Shqipëri duke shuar jo vetëm kureshtjen, por edhe shfrytëzimin e këtyre numrave nga zgjedhjet lokale dhe vendore deri tek metodat e marketingut që mund të shfrytëzohen nga bizneset dhe nga prodhuesit në vend, por duke u marrë pa hezitim edhe me probleme të brendshme që i përgjigjen realiteteve sociale në lidhje me besimin. Të tilla kanë qenë kërkimi në metoda sasiore rreth pyetjeve si "Pse besojnë shqiptarët" apo "Sa.....". Për probleme që janë thellësisht shpirtërore, çështjet nuk mund të trajtohen si në shkencat ekzakte, sepse kështu nuk do kuptojmë si duhet fizionominë e grupit. Për këtë arsye, në këtë aspekt metodat duhet të jenë cilësore. Përndryshe, ato mund të mos jenë të referueshme për të parashikuar veprimet e grupit në të ardhmen.

Nëse studimet nuk bëhen për këtë arsye atëherë çfarë është ajo që duam të studiojmë. Çfarë do bënim me të dhënat që do dilnin se sa dhe si besojnë shqiptarët dhe të nxirrije në përqindje sipas pyetjeve, që rastësisht ti ja ke dhënë grupit, arsyet pse besojnë. Fjala vjen cili është korrelacioni, marrdhënia mes çështjes "përfitimi nga besimi", besimi më ndihmon të jem më i mirë dhe përqindjet në studim 38 % të të anketuarve (F. Sinani, 2010: 119). Si i përgjigjet në të ardhmen aspekteve historike të grupit në lidhje me përqindjen ndaj kësaj përgjigjeje, studimi? A mund ta shpjegojë një përgjigje e tillë aftësinë që të kuptojmë se të gjithë ata që janë përgjigjur kanë të njëjtën të kaluar dhe kushte që i përgjigjen brendisë së grupit? Kështu, në lëmë jashtë shumicën e arsyeve që i nevojiten realisht grupit për t'iu përgjigjur pyetjeve të tilla shoqërore.

### **III. A përbën feja identitet fetar apo social ndër shqiptarët?**

Shqiptarët kanë tri fe të ndryshme dhe feja nuk përbën një identitet kombëtar për ta, por ai qëndron si një identitet social me të cilën njerëzit përcaktojnë përkatësinë e tyre, ashtu siç ka identitete lokale, prej Dumresë, prej Dibre etj. Por gjithsesi, ajo mbetet një identitet.

Mund të mos ketë ndodhur kështu mbase në Kosovë, ku 95 % e popullsisë janë myslimanë, të shkëputet prej trungut, feja aty ka pasur, sipas Gani Bobit, konotacione kombëtare (G. Bobi, 2011: 28). Pra, identiteti - njohja apo perceptimi i vetvetes- mund të ketë shkallë të ndryshme. Në përgjithësi, ajo ka të bëjë me shfaqjen tënde. Përpara gjuhëfolësve ti je shqiptar, por lokalisht ti je dibran, për një evropian ti je një ballkanas, për një arab je një mysliman, për një indian ti je evropian, nga ana sociale një i papunë, kulturalisht një repist, ndërkohë që mund të kesh dhe shfaqje të tjera të kulturave që ti përfaqëson dhe që të çojnë drejt identitetit tënd të plotë. Problemi është se shpesh ne duam të dimë se çfarë përfaqësojmë në të vërtetë ne për një evropian dhe i cili është identiteti që mbizotëron te ne sot. Ndërkohë, që a mundet dikush të copëtojë në mënyrë të kushtëzuar identitetin tënd? Pra nëse je shqiptar, nuk mund të jesh mysliman? Identitete të gjymtuara është ajo që perceptojnë myslimanët shqiptarë nga disa trajtime në media. Cili është kuptimi i një identiteti të copëtuar? Mos vallë turqit apo arabët duhet të më kërkojnë të mos jem shqiptar ndërkohë që jam mysliman?

Nuk mund të ketë prevalenca të një identiteti kundrejt një identiteti tjetër. Një jugosllav i para shumë viteve nuk do thoshte kurrë se jam boshnjak apo kroat, ndërkohë që sot ata mburren për një përkatësi tjetër të tyre (A. Maalouf, 1998: 18). Pra, një identitet është i zbatueshëm apo mbizotëron ndaj një identitet tjetër nëse kushtet gjeopolitike kërkojnë diçka të tillë apo të paktën kjo ka ndodhur në rajonin tonë që me krijimin e shteteve të reja mbas shkëputjes nga Perandoria Osmane. Në kushte normale, askush nuk mund të kërkojë diçka të tillë çfarëdolloj agjende që të ketë, nacionaliste, patriotike etj., siç ishte rasti i regjimit komunist, që shihte si problem të unitetit kombëtar jo thjeshtë largimin e fesë nga shteti, por largimin e fesë në tërësi nga ekzistenca e saj. Por dhe kjo ndasi ishte konvencionale, sepse në thelb, toleranca e kishte krijuar kulturën e saj në vend.

#### IV. Nacionalizmi, tiparet shqiptare

Një numër i madh studiuesish mbi nacionalizmin mendojnë se nacionalizmi është një krijim dhe nevojë e modernitetit. Po ashtu, krijimi i shteteve kombe do zhdukte ndikimin e fesë mbi shtetin dhe entitetet e ngritura mbi universalizmin do të gjenin barrierë në këtë parim. I pari që e zbatoi në politikë doktrinën e shtetit komb ishte Kardinali Rishëlje. Natyrisht që në bazë të politikave të shteteve krijohen dhe identitetet dhe njerëzit fillojnë t'i përshtaten realitetit të ri politik. Në këtë aspekt është e rëndësishme të kuptojmë se sa i dobishëm është një identitet i caktuar për një realitet të caktuar. Teoria moderniste e nacionalizmit studiohet në aspektin teorik politik, ekonomik dhe në teorinë e komunikimit social. Nga këto tri aspekte të teorive moderniste të nacionalizmit aspekti ekonomik jep një përgjigje neutrale me anë të Gelnerit. Ky autor e ka trajtuar *nacionalizmin* në disa libra dhe ka pasur ndryshim të qëndrimeve të tij nga libri në libër, duke ardhur tek vepra e tij e fundit, dhe mund të themi më e plotë, "Nationalism". Megjithatë, gjurmë të nacionalizmit janë gjendur dhe në evropën mesjetare, sic është rasti i Anglisë e cila themeloi kishën Anglikane, e cila në vetevete është një kishë romane katolike që nuk ka të bëjë me lëvizjet protestante në Europë, dhe teoria e modernitetit nuk ka mundur t'i japë një përgjigje adekuate të gjitha rasteve. Në Perandorinë Osmane, e cila kishte një sistem teokratik të qeverisjes, idetë nacionaliste hyjnë shumë vonë dhe pasqyrohen në fillim të shekullit XX në jetën politike me lëvizjen e Turqve të Rinj. Gjithsesi në punimin tonë ne do të shohim nacionalizmin në kuadrin e teorive moderniste, pasi nuk shohim që nacionalizmi të ketë pasur një pasqyrim politik në mjedisin shqiptar deri në shekullin XIX.

Në Shqipëri, ashtu sikurse gjithkund, *nacionalizmi* qe produkt i *modernitetit*. Vetë rilindasit gjatë përpjekjeve për krijimin e nacionalizmit shqiptar kërkojnë një Shqipëri jo të prapambetur, moderne dhe të shmangur nga fundi i pakthyeshëm i perandorisë. Megjithëse nacionalizmi në Shqipëri u shfaq nga ideologë dhe intelektualë, qëndrimi i tyre mbi nacionalizmin kishte karakter ekonomik dhe në Evropë qasja ekonomike është trajtuar nga marksistët dhe Ernest Gellner. Ne mund të trajtojmë këtu dhe rastet e çuditshme të nacionalizmit në ambientin social e politik gjatë komunizmit, i cili është një sistem që mundohet ta zgjidhë çështjen e nacionalizmit me zhdukjen e klasave. Pyetja shtrohet me të



drejtë se si në një nga sistemet më absolute komuniste të lindte dhe zhvillohej nacionalizmi sidomos mbas viteve 70 të shekullit të XX. Mbase, siç thotë Gellner, "*komunizmi ishte më shumë hyjnor dhe më pak profan*" (Gellner, 1998: 88), çfarë duhej të kishte qenë krejt e kundërta. Natyrisht që *nacionalizmi* në vendet që dolën nga perandoria osmane ka një tjetër karakter nga nacionalizmi dhe formimi i identiteteve në vendet evropiane dhe mund të kërkojë një qasje teorike që mund të merret me identitet e shtypura në perandori apo me qasje teorike që mund të mos provohen me teoritë perëndimore mbi nacionalizmin. Në Shqipëri, nacionalizmi do mund të trajtohet në aspektin ekonomik dhe kërkesa e rilindësve kishte të bënte me distancimin nga epoka agrare, e cila ishte ende e lidhur me sistemin feudal në Perandorinë Osmane. Është i njohur fakti se shkrimtari Naim Frashëri ka bërë një pastrim të fjalorit në krijimet e tij nga fjalët turke, arabe dhe perse, duke i konsideruar ato mbetje dhe elementë që e lidhnin vendin me të kaluarën e tij feudale dhe agrare.

Me shkrirjen e shtetit komb si rrjedhojë e globalizimit, njerëzit fillojnë të krijojnë njësi më të mëdha identitare siç janë arti, feja, kultura etj, gjë që paradoksalisht lë të zbuluar një element identitar shumë të investuar dhe promovuar siç është gjuha. Njerëzit fillojnë identifikohen me elemente të tjera nga ato të shtetit komb. Ky është një element shumë i rëndësishëm në shoqërinë shqiptare postkomuniste dhe në vendet dhe shoqëritë islame, postkolonialiste, ku elementi surprizë i shekullit XX është karakteri i fortë, i gjallë dhe shekullar-rezistent i Islamit si dhe kolapsi i menjëhershëm, total, i pakundërshtuar dhe i turpshëm i komunizmit. Asnjë prej të dyve nuk ishte parashikuar nga shkencat sociale (E. Gellner, 1998: 85).

Studiuesit e *sociologjisë politike* dhe të *sociologjisë së fesë* kanë përdorur terma që përmbajnë ndryshime në formën e nuancave për *tolerancën*: historianët e fesë dhe teologët flasin për "ekumenizëm ndërjetar"<sup>7</sup>; njohësit e Mesjetës dhe etnologët përdorin termin "harmoni ndërjetare"; sociologët dhe historianët sekularë priren nga termat "tolerancë", "bashkëjetesë" apo "harmoni fetare".<sup>8</sup>

---

<sup>7</sup> Kruja, G. (2008). *Shqiptarët përballë sfidave të mirëkuptimit ndërjetar*. Tiranë: Arbëria

<sup>8</sup> Duka, F. (Mars, 2011) "*Sfondi historik i tolerancës fetare në Shqipëri*", Simpozium ndërkombëar 'Këndëvështrimi i diversitetit fetar, kulturor dhe shoqëror në Ballkan nga prespektiva globale', Tiranë: Prizmi.

Toleranca dhe barazia njerëzore padyshim janë fryt i njohjes hyjnore në formën e saj të dliirë. Zoti e ka pajisur qëllimisht botën njerëzore me njohuri, në mënyrë që të kuptojmë vetveten dhe rolin tonë në shoqërinë njerëzore dhe si rrjedhojë e kësaj të zhvillojmë marrëdhënie njerëzore të bazuara në tolerancë dhe në barazi.

Larmia, ndryshueshmëria si dhe llojllojshmëria e njerëzve është një akt i qëllimshëm i Zotit për njohjen dhe afrimin e tyre me njëri-tjetrin, e jo për të treguar ose shprehur urrejtje ndaj njëri-tjetrit në baza racore fisnore apo edhe religjioze. Këtë e thekson edhe *Kur'ani* që në fillim të shpalljes së tij: *“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe prej një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete. Ndërsa më i ndershmi ndër ju është ai i cili më së shumti ka frikën e Zotit. Zoti është i gjithëdijshëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë “* (Ajet Kuranor 49: 13). Shqiptarët myslimanë falë predikimeve të drejta të prijësve të tyre fetarë, që herët i kishin kuptuar këto fakte të rëndësishme hyjnore, duke e kuptuar fenë si vlerë shpirtërore të çdonjërit e jo si element përçarës.

Toleranca fetare e popullit shqiptar mbështetet në vetëdijen kombëtare në faktin se të gjithë shqiptarët e të gjitha besimeve janë të një gjaku dhe të një gjuhe, kanë origjinën, truallin dhe traditën e përbashkët. Kjo vetëdije ka ndikuar fuqishëm në kohezionin kombëtar në përmasa më të gjëra dhe ka mobilizuar popullin shqiptar gjatë historisë për tu bërë rezistencë e përpjekjeve të vazhdueshme që ta përçajjnë apo ta sundojnë.

Referimi politik i një entiteti fetar ka përmasat e veta, por në Shqipëri feja nuk ka pasur gjithmonë vazhdimësi historike dhe sociale, kjo për shkak të referimit politik. Në Shqipëri katolikët kanë Vatikanin në Romë, të krishterët ortodoksë i referohen Kostandinopojës apo Romës së Lindjes, ndërkohë që myslimanët, duke mos e bërë dallimin e fesë me shtetin në modelin e një lloji të caktuar teokracie, e humbën orientimin e tyre shpirtëror dhe politik kur Kalifati i fundit me qendër në Stamboll (Roma e Lindjes), ra përfundimisht. Për këtë shkak, myslimanët nuk kanë më një qendër shpirtërore, sepse ai brenda pritshmërisë së myslimanëve duhet të jetë një Khalifat, ku Khalifi te jetë lideri shpirtëror, ushtarak dhe politik. Sot myslimanët janë të hutuar dhe të përçarë dhe pse kanë një mbështetje të fortë në parimin e *umma-s* (ymetit).

Por pavarësisht kësaj, Islami në kontroll apo jo të pushtetit ka konkurruar suksesshëm me nacionalizmin (E. Gellner, 1998: 89) dhe në Shqipëri i ka rezistuar një identiteti të prodhuar pikërisht duke mos pasur një ndërhyrje nga jashtë, por duke u bazuar vetëm në karakterin e tij integruar.

Pra shqiptarët, jo se janë të pakujdesshëm ndaj fesë, por atyre iu kërkua që lidhja kombëtare, ideja kombëtare do bënte që të refuzohej “tjetri” (i krishteri) etj. Në interes të kësaj, pra të parimit të bashkimit të kombit, (që ka të bëjë dhe me territore shtetërore), shqiptarët toleruan nga feja dhe nga disa parime fetare për interes të kombit ashtu siç ishte projektuar dhe ideuar nga rilindasit në projektin e tyre për bashkimin e kombit.

Nacionalizmi shqiptar, në ndryshim nga fqinjët kishte një problem të madh, religjionin (dy fe, dy identitete të ndryshme). Kapërcimi i religjionit, përkatësisht identitetit fetar, drejt unitetit kombëtar i cili nuk mund të bazohej mbi unitetin fetar ishte një detyrë primare për shtetin shqiptar.

Thirrjes se harmonia fetare lind si atribut i kombit, i cili ka përparësi ndaj fesë, (për këtë arsye një i krishterë e toleron shqiptarin mysliman, apo mysliman atë të krishterë), janë prirje që do tregonin se kombi është më i rëndësishëm për shqiptarët se feja. Në realitet, kjo tipologji të perceptuari shpie ujë në hullinë e rilindësve dhe nacionalistëve, por në vetvete është një konstatim i cili mund të jetë lokal. Në fund të fundit, diçkaje ne do ia atribuojmë bashkëjetesën, por nëse në atë që themi ka elemente kundërtë, atëherë elementet lokale nuk mund të jenë përgjithësuese, por ato e kanë burimin te fenomene më të mëdha. Jo se ndërgjegjja kombëtare nuk i përmbush kushtet për këtë, por ajo në të kaluarën nuk ka qenë dhe aq e qartë në një gadishull ku myslimanët pa përjashtim cilësoheshin turq, ortodoksët grekë dhe katolikët romakë. Mjafton të marrim dhe dy ngjarje të rëndësishme në kohë për të gjetur elementet që plotësojnë tablonë. E para, ardhja e Skënderbeut në atdhe, e cila u shoqërua me përndjekjen e popullsisë myslimane në vend, çka mund të ketë qenë dhe një nga arsyet që e detyruan Hamza Kastriotin të largohej prej tij, por këtë mund ta hamendësojmë sepse nuk kemi fakte konkrete që ai u largua për këtë arsye, por kjo mund të ketë qenë një nga shumë arsyet.

Ngjarja e dytë historike është Revolucioni Grek, i cili ishte një kryengritje e të krishterëve ortodoksë shqiptarë të Peloponezitet (Moresë), Atikës e Thesalisë, treva të

njohura dhe sot si arvanitase, ndaj administrimit Turk. Kjo ngjarje u shoqërua nga një përndjekje të tmerrshme të shqiptarëve myslimanë në vend dhe përbënte preludin e asaj që më vonë do të quhej dhe të merrte emrin në të gjithë ish perandorinë si spastrim etnik, por në të gjitha rastet bëhej fjalë për spastrime fetare ku feja barzvlërësohej me etninë. Duke qenë se Greqia doli e para e pavarur nga perandoria, ata janë të parët që nisën zbatimin e kësaj doktrine. Në rastin në fjalë, spastrimi vazhdoi deri në shekullin XX me largimin e çamëve dhe konvertimin me dhunë të të mbeturve. A ndodhi kjo me të krishterët në Ballkan? Natyrisht që po. Madje dhe me shtetin e ri turk, por është një dukuri që nuk haset përgjatë historisë së perandorisë Osmane. Madje dhe forma e nacionalizmit të myslimanët pas shkëputjes nga perandoria është krejt e ndryshme nga ajo e të krishterëve të perandorisë. Duke qenë se të krishterët patën kishën si promotore të luftës për pavarësi, për ta feja ishte elementi kryesor i lindjes së nacionalizmit dhe dihet që në vendet e krishtera të shkëputura nga perandoria, feja është nyja e fortë e identitetit kombëtar. Në vendet me shumicë islame që u shkëputën nga perandoria, ishte pikërisht goditja ndaj fesë që do mund të krijonte një identitet ndryshe dhe duke i shpëtuar lidhjes së Umma-s(ose ymetit). Në këtë mënyrë, mund të shohim lindjen e një ndërgjegjeje panarabe, turke dhe shqiptare të bazuar te gjuha, arabishtja, turqishtja apo shqipja në rastin tonë, e jo të bazuar te feja. Çdo referim fetar do i bënte të pamundura identitetet fetare në këto vende.

## **V. Ligjërimi, toleranca, bashkëjetesa**

Në se myslimanët nuk janë konvertuar me dhunë por me dëshirë atëherë kishte një premisë që të binte teza se ata nuk e marrin seriozisht fenë dhe për të trajtuar problemin më tej duhet të thelloheshim në arsye të tjera objektive. Shumë studiues nuk bëjnë një përpjekje që kjo të vërtetohet apo të ketë studime të mirëfillta mbi këtë tezë sepse vetë hedhja e tezës nga ana e tyre vetë apo e atyre që e kanë hedhur, ku në rastin më të mirë janë figura publike të letrave në Shqipëri, përbën në vetvete abuzivizëm me termat dhe historinë, pasi i përgjigjet në kohë kërkesave të politikave shtetërore sekulariste. Duhet shtuar gjithashtu se njerëz që mund të kenë qënë pjesë e kësaj axhende është e vështirë të hedhin poshtë shkencërisht pohime dhe artikulime të tilla.

Pra, shqiptarët, në bazë të kësaj hipoteze, duhet të standardizohen si komb që përshtatet lehtësisht me fenë, por që feja nuk u mvishet si një identitet, pra në sfidën e tyre për t'u evropianizuar ata do pësonin metamorfozën e ardhshme dhe do të shndërroheshin në atë që u kërkohet pa bërë ndonjë sakrificë. Por nuk mund të trajtosh anën subjektive të njeriut me atë objektive të tij (G. Kruja, 2008: 187). Janë parametra që ndryshojnë njëri nga tjetri, përndryshe nuk do të kishim largim masiv të çamëve myslimanë nga tokat e tyre, por në të njëjtën kohë jo dhe lëvizje apo zhvendosje të çamëve ortodoksë nga tokat e tyre. Fakti për shëmbull që kontinenti evropian është i krishterë, nuk do të thotë detyrimisht se një i krishterë evropian e ka marrë seriozisht fenë e tij, pasi nuk do kishim të pranishëm as termin "kulturalisht i krishterë", që përdoret për kontinent sot. Shpesh në Evropën e disa shekujve më parë kemi pasur dhe realitete të imponuara që janë bërë shkak që evropianët ta ndajnë më vonë fenë nga politika. Nëse është kështu, atëherë përse një shqiptar duhet ta merrte seriozisht fenë?

Siç vihet re me të drejtë, toleranca në Shqipëri mund të jetë dhe fryt i mospërballjes dhe i mungesës së dialogut ndërfaqetarak (A. Fuga, 2010: 30), por ne nuk do ta dimë këtë derisa komunitetet fetare të shkojnë drejt dialogut dhe pse jo edhe drejt debatit, pasi në këtë mënyrë rrespektimi i statuskuose nuk do na imponohet por do fitohet. Shqiptarëve u duhet të bashkëjetojnë për shkak të bashkëjetesës dhe kështu ata nuk do e testojnë kurrë se sa e vërtetë është ajo. Por nëse marrin përgjegjësinë për t'i zgjidhur problemet që mund të ketë ndërmjet komuniteteve, sic është rasti i xhamisë kishë në Shkodër (F. Lubonja, 2006: 73-74), me anë të nismave për dialog, do arrijnë të shfryjnë tensionin që krijon akumulimi i problematikave në një shoqëri.

Shteti Shqiptar e ka parë të arsyeshme laicitetin si një formë politike sociale që qëndronte mbi palët duke rregulluar marrëdhëniet mes tyre me ligje në teori të paanshme. Por sidoqoftë në mungesë të debatit fetarak dhe të dialogut të mirëfilltë, dhe në mungesë të një lënde fetare në shkollat publike ku të përftoheshin disa koncepte fetare, nuk mund të jemi të bindur se harmonia dhe toleranca e kanë burimin pikërisht nga mungesa e debatit dhe dialogut. Kështu që mbetet për ta shpjeguar këtë proces ose te mungesa e një kontakti për dialog dhe hermetizimi fetarak, ose mbetet të kalojmë në një periudhë tjetër që të

shpjegojmë fenomenin dhe të përqëndrohemi në periudhën e sundimit Otoman në Ballkan. Ky është një moment që do preket në vijim.

Shpesh reagimet dhe ligjërimi në Shqipëri krijohet nga librat dhe autorë të ndryshëm, por termat dhe konceptet që hidhen janë të pastudiuara. Ato nuk lidhen me një realitet historik, por me një agjendë politike të studiuesit, shkrimtarit etj.. Cilësime si pushtuesi turk, 500 vjet robëri, mbijetesë për 500 vjet, feja e shqiptarit është shqiptaria, janë terma ose cilësime të njëanshme që përdoren dhe në librat e historisë zyrtare në Shqipëri. Ato i përkasin një ligjërimi të caktuar dhe kanë karakter politik pasi këto terma nuk janë trajtuar brenda një diskursi historik, ato e pranojnë historinë si statike dhe merren si të mirëqënë si terma pa mundësinë e kundërshtimit. Shumë syresh e kanë përshkuar këtë udhë që nga sistemi komunist, disa të tjerë dhe më parë. Ku qëndron problemi? Duke qënë pjesë të ligjëritit zyrtar, ato si terma nuk u përgjigjen realiteteve historike dhe janë terma që janë pjesë e një agjende të caktuar, politike, nacionaliste, etj, e cila në fund të fundit kurrë nuk mund të jetë konstruktive për gjithë shoqërinë. Fakti se ne kemi qënë qytetarë me të drejta të barabarta brënda Perandorisë Osmane ka një bazë të vërtetë, përderisa Shqiptarë të ndryshëm, me përkatësi islame, kishin pozicione administrative nga ai i deputetit, ministrit deri tek kryeministra. Gjithashtu dhe popullsitë e krishtera kishin të drejtat e tyre në respekt të ligjit dhe kryesisht trajtoheshin dhe mbroheshin të drejtat e tyre sipas ligjit të fesë së tyre dhe institucioneve të tyre fetare. Por krijimi i klisheve nuk e ndihmon diskursin dhe evolucionin historik të një shoqërie. Dhe në shoqërinë shqiptare këto lloj kliseshë janë hallkat false që lidhin dhe shpjegojnë evolucionin e historisë tonë në 100 vitet e fundit.

Një problem tjetër i madh është se ne vazhdojmë të prodhojmë klishe, siç fjala vjen toleranca; shqiptarët kanë një tolerancë të caktuar fetare. Jemi të pafuqishëm të tregojmë realitete dhe shpesh duhet t'i prodhojmë ato. Kur vetë tolerancën e trajton si një çështje sociale, ajo e humb kuptimin në një studim të mirëfilltë. Ajo me të cilën studiuesit merren janë konfliktet dhe aty ku nuk ka konflikte do të thotë që një element i pamundur për tu studiuar dhe për t'u vërtetuar si toleranca bëhet klisheja e radhës. Shqipëria është një vend në një rajon kaq të pasur me histori dhe ngjarje sa nuk duhet të jenë klishetë ato që e përshkojnë historinë, por vetë faktet historike, natyra e tyre dhe studimi analitik i tyre. Prandaj këto klishe janë pjesë e ligjëritit politik, nationalist dhe për këtë arsye ato kanë

pasur një agjendë të caktuar që i përgjigjej realitetit që po ndërtohej qoftë politik apo nacionalist siç u tha më sipër.

Ka pohime të hershme dhe të sotme të politologëve që kur ka një reagim fetar të myslimanëve ky reagim fetar mysliman sipas tyre nxitet nga Serbia dhe Rusia (sipas disa historianëve) që të trazojnë ujërat dhe ta paraqesin si shembull tipik të përkatësisë islame të vendit. Ata nuk rreken ta kuptojnë problemin nga brenda kur problemi mund të kishte të bënte, me izolimin që i është bërë këtyre njerëzve nga politika e cila shumë pak adreson hallet e tyre në Maqedoni apo Kosovë dhe ato kanë zgjedhur fenë si një alternativë mbështetjeje, kur faktori politik ka dështuar në ambjentin social? Pra gjenden klishe për të shpjeguar realitetin, por klisjet nuk të lejojnë që të depërtosh përtej tyre dhe të gjesh apo studiosh më me saktësi se pse ndodhi një reagim, cilët ishin faktorët që i shtynë këta njerëz. Duke mos studiuar këto probleme, klisjet bëhen përjashtuese të të vërtetave të tjera historike dhe kjo popullsi për shembull edhe pse shqiptare përjashtohet nga ligjërimi politik zyrtar. Pra klisjet, duam apo s' duam, janë forma përjashtuese dhe për këtë arsye janë të dëmshme.

Për tolerancën dhe intolerancën kemi shumë pikëpamje të ndryshme në lidhje me të, por gjithsesi është e kuptueshme, që ato veprojnë kur grupe më të mëdha shoqërore vihen përballë grupeve më të vogla. Grupet shoqërore të mëdha apo të vogla e shoqërojnë këtë fenomen me identitete të caktuara. Dhe janë pikërisht identitetet ato që vihen në shënjestër të tolerancës apo intolerancës ose më saktë janë subjekt i intolerancës prej të cilës krijohet raporti i tolerancës, pra masim intolerancën në raport me tolerancën. Identitete të caktuara mund të jenë etnia, feja, gjuha, raca etj, por ka disa identitete që kanë karakter ambig dhe shpesh mund të ngatërrohen duke lënë të ekspozuar ndaj keqkuptimit një entitet të caktuar kur nuk gjejmë dot shpjegime për një konflikt të caktuar. Si shembull, identiteti fetar mund të mos jetë i ndryshëm për vende si Greqia, Pakistani, Izraeli etj. me atë etnik. Pra, nëse konflikti është etnik apo fetar, në këto vende ne nuk do dimë ta themi me siguri kështu që dhe probleme sociale që lindin siç është toleranca do ishte e vështirë për t'i dhënë një përgjigje adekuate apo burimore. Për këtë arsye ridefinimi i termave dhe bërja praktike e tyre është një sfidë e hapur për studiuesit kudo në botë.

Gjatë periudhës së Perandorisë Osmane, sistemi i mileteve përcaktonte pjesëtarë të një besimi të caktuar si etnikisht të njëjta, paçka se ata mund t'u përkisnin gjuhëve të ndryshme. Dhe përkatësisht myslimanët konsideroheshin turq, ortodoksët konsideroheshin grekë apo serbë etj. Në kohën e rilindësve dhe gjatë luftës për pavarësi deri në formimin e shtetit shqiptar më 1920, intelektualët shqiptarë u munduan që identiteti fetar të lihej mënjanë dhe përparësi t'i jepej atij gjuhësor. Mehdi Frashëri, lideri i "perëndimorëve", ai vetë me prejardhje myslimane, boton më 1928-29 një varg artikujsh në shtypin e regjimit, në të cilat ia ngarkoi vetëm islamit gjendjen e prapambetur të Shqipërisë (R.M. Della Rocca, 1994:135). Identitet mundet të flenë për një periudhë të caktuar dhe befas zgjohen dhe befasojnë edhe bartësit e tyre për forcën që ato kanë dhe energjinë që çlirojnë në mjedisin social.

Pasi tejkaluan problemin e identifikimit kombëtar, shqiptarët iu përveshën kauzave politike qoftë ato dhe me karakter fetar. Pjesa më e diskriminuar dhe me një pozicion në mbrojtje ishte ajo e myslimanëve suni. Kjo në radhë të parë si shkak i shkëputjes së tyre si politikisht ashtu dhe ideologjikisht nga Turqia. Kujtojmë se komuniteti mysliman bëri shkëputjen nga myftinia e Stambollit më 1923. Të njëjtën gjë u munduan të bëjnë në një ceremoni të dyshimtë edhe të krishterët ortodoksë me në krye Fan Nolin (R.M. della Rocca, 1994: 54-55) ndërkohë që katolikët që ishin tërësisht të varur nga Vatikani kishin rrjedhimisht dhe një agjendë politike pasi Vatikani në vetvete ishte dhe shtet apo një qeverisje teokratike ku Papa është kryetar i shtetit. Qëndrimi i tyre bëhet më i qartë kur ata nuk njohin ligjin që rregullon komunitetet fetare më 1929 si dhe për përkrahje e politikës italiane në Shqipëri.

Komuniteti mysliman me anë të organit "Zani i Naltë" kaloi në një mbrojtje totale prej shkrimeve që i vinin nga botimet në periodikë dhe në të përditshmet në vend. Çdo fjalë kundër fesë dhe islamit do të përlligjej nga qëndrimi që mbante Evropa ndaj botës islame, një qëndrim që mbante mbi shpinë si barrë e gjithë elita shqiptarë. Dukej sikur ligjërimi kundër kalbëzimit të një perandorie kishte kaluar në atë të shtratit të një feje të vetme si bashkëpërgjegjëse për realitetet aktuale asokohe në vend. Presioni i cili më së shumti ka qënë kulturor, ka pasur një zgjatje tek intelektualët dhe qeveritarët, edhe pse shumica e posteve në administratë zotërohej nga shqiptarët myslimanë. Por ky ishte ligjërimi që



shoqëroi shoqërinë shqiptare në atë periudhë. Dhe në lidhje me ligjërimin, një nga problematikat më të mëdha është mënyra e perceptimit, ose mënyra si fillon pyetja. Mënyra se si vihen në pikëpyetje fenomenet është mënyra që ne gjejmë për t'iu shmangur përgjegjësisë që mbart përgjigjja. Siç thotë Foucault, "Nuk dua t'i hyj kësaj bote të rrezikshme të debatit. Nuk dua të kem të bëj me të sa kohë që është vendimtare dhe finale" (M. Foucault, 1972: 215).

Patjetër që klasa intelektuale shqiptare që e pretendon veten sekulariste dhe rrjedhimisht pranohet si ateiste thajse nuk duan t'u qasen termave të tillë si tolerancë, harmoni fetare etj. Kjo ka pasojë jo mbi termin në vetvete, por mbi subjektin të cilit i atribuohet materialisht. Shumë syresh preferojnë ta quajnë bashkëjetesë, pasi me të drejtë toleranca është një term që të ngjall imponim apo që nuk të ngjall asnjë lloj ndjesie. Por nëse ne nisemi nga bashkëjetesa pa e vënë në pikëpyetje, atë atëherë nuk e kuptojmë dot fenomenin dhe i vidhemi si për t'i shpëtuar përgjegjësisë se çfarë e prodhoi atë tolerancën. Pra, nëse ne pyesim se si mund të bashkëjetosh ti me një fqinj apo me disa fqinjë që nuk krijojnë homofili me ty, nëse ti je i bardhë dhe ata janë të zinj, nëse ti je i krishterë dhe ata janë myslimanë, nëse ti je shqiptar dhe ata janë grekë e kështu mund të vazhdojmë duke ngritur gjithmonë e më shumë dyshime mbi bashkëjetesën. Nëse tjetri nuk do ishte tolerant ndaj përkatësisë tënde, a nuk do kërkonte ai që t'i përngjaje më shumë atij sesa diçkaje tjetër? Pra, mos është ikja e përgjegjësive modeli i ligjërimin të intelektualëve në Shqipëri? Çfarë i mundon që nuk krijon siguri futja e termit tolerancë? Natyrisht që Islami nuk është në listën e atyre ideve të shekullit tonë që projektojnë diçka pozitive. Mjafton të hapësh librat e mjekësisë, filozofisë, sociologjisë, kimisë, matematikës etj dhe të mos gjesh asgjë aty për kontributin e myslimanëve në këto fusha a thua se njerëzimi u zgjua në shekullin e XV.

Shmangia e një vlere që u prodhua nga bashkëjetesa për 500 vjet si të një myslimani dhe një të krishteri krah për krah njëri tjetrit, krijon një vakum historik për shpjegimin e shumë fenomeneve shoqërore. Fjala vjen, si do e shpjegojmë ne bashkëjetesën në komunizëm pas abrogimit të fesë dhe zhdukjes së çdo besimi tjetër përveç atij zyrtar? Nëse ne nuk kemi një shpjegim sociologjik për 50 vjet histori, atëherë si do kemi një shpjegim të qartë për 500 vjet histori?

Siç thotë Foucault, "në dukje, të shprehurit nuk ka ndonjë rëndësi, por ndalesat (përrjashtimet) që i bëhen, tregojnë qartë lidhjen me dëshirën dhe fuqinë" (M. Foucault, 1972: 216). Natyrisht që Islami nuk është në konflikt me Krishtërimin, i cili në vetvete është spostuar politikisht në ambientin evropian, por e ka një konflikt të hapur me sekularizmin. Shoqëritë islame dhe islami politik nuk e shikojnë, në përgjithësi, të shkëputur shtetin nga feja siç kërkojnë sekularistët. Në këtë prizëm, pra, në prizmin politik Islami shfaqet shumë dinamik. Sekularizmi tenton të shtypë anën shpirtërore të masave duke shpikur shumë lloj ideologjish apo teorish sociale. Pra, sekularizmi që priret nga ateizmi, një besim i pavërtetuar se Zoti nuk ekziston, rrezikohet ekzistencialisht nga pjesëmarrja e fesë apo e ideve fetare në qeverisje dhe ky rrezik vjen si shfaqje e pamjaftueshmërisë që ka çdo ideologji tjetër përpos asaj fetare që të merret me problemet e brendshme të njeriut edhe kur kanë marrë zgjidhje problemet e jashtme. Kujtojmë këtu numrin e lartë të vetëvrasjeve në vendet skandinave, që kanë nivelin më të lartë të jetesës në Evropë. Duke u krijuar ky realitet, sekularizmi tenton të jetë gjithmonë dhe më pak tolerant ndaj fesë dhe ndaj Islamit në veçanti në kohët moderne.

Gjatë kësaj periudhë, kemi lindjen e termave si fundamentalizëm islamik, ekstremizëm islamik dhe terrorizëm islamik. Janë të gjithë cilësime të stisura 50 vitet e fundit dhe duke mos qënë politikisht korrektë si terma, përjashtojnë çdo lloj fundamentalizmi, ekstremizmi dhe terrorizmi tjetër përveçse atë islam. Pra, ne nuk dëgjojmë ndonjë lloj fundamentalizmi, ekstremizmi apo terrorizmi që të emërtohet me një emërtim ideologjik apo fetar përveçse të shoqëruar me termin islam i cili duket si prapashtesë e tyre. Pra, diçka nuk shkon me termat dhe emërtimet. Ato janë aty dhe flasin për një konflikt të padukshëm mes shekullarizmit dhe Islamit. Në këtë mënyrë, Islami përjashtohet nga diskursi historik dhe nga faktori pjesëmarrje apo nga pjesëmarrja si një mundësi. Në këtë rast, i referohemi rastit të Vëllazërisë Myslimane në Egjipt, e cila është një organizatë politike që ishte etiketuar si terroriste nga shumë media në botë, por arriti që të vinte në pushtet me zgjedhje të lira, por dhe të rrëzohej nga një grusht shteti ushtarak. Fare pak kohë pasi formacioni politik Vëllazëria Myslimane mori pushtetin, rrjeti mediatik britanik BBC kërkoi falje publike që e kishte etiketuar këtë grupim politik me ideologji

islame, si një organizatë terroriste. Raste të tilla tregojnë se jemi para një agjende që nuk mund të jetë ndryshe veçse sekulariste.

Nëse kthehemi në vendin tonë, shohim që ky ligjërim përjashtues në media është pasojë e mospërpunimit të lajmit, por ndërkohë dhe e pranimi të heshtur të këtij ligjërimi. Duket se terminologjia është e pranuar dhe mbetet një realitet i pandryshueshëm. Ky lloj realiteti i pranuar hap rrugën që çdo lloj debati të shtrihet mbi të njëjtin skelet. Në këtë kakofoni termash, është e vështirë të bësh dallimin mes një mendimi konstruktiv dhe një mendimi paragjykues, pasi termat duken si të pacënueshëm. Por siç e thamë më lart, vetë termat e tillë “fundamentalist”, “ekstremist” dhe “terrorist”, të përdorur në mënyrë përgjithësuese për të gjithë myslimanët, çojnë drejt përjashtimit dhe natyrisht që kemi një konstrukt përjashtues të faktorit fetar dhe përkatësisht të atij islam në hapësirën publike.

Shumë studiues e shohin *sekularizmin* si të shenjtë dhe të paprekshëm, sepse shumë e shohin zhvillimin në vetvete të metafizikës si një shndërrim të teologjisë në shkencë (Al-Attas, 1993: 2). Cdo ide ndërtohet dhe përcohet nga shtyllat e saj, por nëse hapësirat ngushtohen, ato veniten dhe të parit e realitetit bëhet monokromatik dhe detyra e cdo ideologjie është që të shtojë sa më shumë ngjyra, por dhe të krijojë opozitarizëm konstruktiv duke mos e lënë një të vërtetë si absolute ndaj cdo të vërtete tjetër dhe mbase është kjo ajo që po bën Islami, mbase në mënyrë të pavetëdijshme, në një mjedis shumë të huaj për të.

Institucionet fetare, si dhe besimtarët, por edhe ateistët dhe sekularistët, duan të gjejnë hapësirat e tyre publike tashmë, në media, në rrugë. S'ka rëndësi që këto janë hapësira të munguara prej paragjykimit dhe keqligjërimit, i cili në Shqipëri ka shkaktuar refuzimin e tjetrit. Pra, dikush është në luftë për t'i fituar hapësirat publike dhe dikush mendon që i është zënë hapësira publike. Me këtë lloj mendësie, të dyve u është zënë hapësira publike. Ky lloj perceptimi mund të eliminohet me eliminimin e llojit të ligjërimeve stereotipizuese. Në këtë studim, do të merremi me ligjërimin fetar islam të viteve 20-30 dhe se si ky ligjërim përcohet në kohë dhe vjen te ne jo vetëm për të mbushur boshllëkun e këtyre debateve, por për të kuptuar fizionominë e bashkëjetesës në Shqipëri dhe se si është përçarur ajo nëpërmjet kontributit ligjërues.

# KAPITULLI I

## METODOLOGJIA

### **1.1. Themelet teoriko-epistemologjike: konstruktivizmi dhe ndërtimi i subjektit shkencor**

Ky punim doktoral do të bazohet në interpretimin e formësimit të një elementi identitar të kombformimit, si ai i tolerancës dhe harmonisë fetare në Shqipëri midis fundit të shekullit të XIX-të dhe deri në ditët e sotme. Për këtë, ai do të tentojë të ndërhyjë në një debat teorik si ai i konstruktivizmit, i implementuar në një rast studimor, atë të identitetit kombëtar shqiptar të kohëve moderne. Për shkak se kjo tematikë kërkon interpretim diskursi dhe analizë ligjërimit, ai do të informohet nga një numër i madh burimesh parësore ligjorimore dhe fetare. Punimi ka si objektiv parësor të studiojë reagimin e variablës së varur të tij, tolerancën fetare, në mjedisin shqiptar të periudhës së sipërpërmendur.

Për të ofruar një rezultat objektivisht shkencor dhe të testueshëm në periudha të ndryshme historike, studimi përdor analizën e periudhave historike për të pasqyruar zhvillimin evolutiv të krijimit të koncepteve dhe skemave të menduarit mbi fenë dhe tolerancën fetare në Shqipëri. Kjo metodë ka si qëllim identifikimin e gjendjes aktuale të kuptuarit të tolerancës dhe harmonisë fetare në vënd, në Ballakn e në rang ndërkombëtar, duke përdorur një tërësi burimesh parësore dhe dytësore lidhur me tolerancën dhe harmoninë.

Metodologjikisht ajo ndërtohet mbi raportin midis disa variablave, të cilat janë sa historike aq dhe teorike. Kështu do të synohet të provohet se koncepti identitar i “harmonisë dhe tolerancës ndër-fetare në Shqipëri” është një variabël e varur, si produkt i proceseve të gjera historike të formësimit të identitetit shqiptar. Ky punim është një kërkim shkencor cilësor, bazuar kryesisht në të dhëna empirike parësore, si tekstet bazë fetare, apo edhe ligjërimet e klerikëve shqiptarë e të huaj. Studimi bazohet në një numër të konsiderueshëm burimesh parësore, të pashqyrtuara më parë.

Teoria bazë për studimin e kësaj teme është ajo konstruktiviste. Ideja se sistemet kombëtare janë një strukturë sociale mund të shqyrtohet në terma shumë të thjeshtë. Strukturimi i diçkaje është një veprim i cili i jep jetë një subjekti ose objekti që në kushte të tjera nuk do mund të ekzistonte dot. Kështu për shembull, një substancë materiale si druri ekziston në natyrë, por mund të formohet në çdo numër objektesh, si për shembull trugu në shtëpi, në pushkë, në vegël muzikore apo shtyllë totemi. Megjithëse këto përfaqësojnë në vetvete objekte materiale, ato nuk ekzistojnë në natyrë por janë krijuar nëpërmjet akteve të krijimtarisë njerëzore. Sapo ndërtohen, secili prej këtyre objekteve ka një domethënie dhe përdorim të caktuar brenda një konteksti. Ata janë konstrukte sociale në kuptimin që forma e tyre është e mbushur me vlera sociale, norma dhe hipoteza, në vend që të jenë produkti i mendimit ose domethënies së pastër individuale. Në mënyrë të ngjashme, fenomenet krejtësisht sociale, si shtetet edhe institucionet ndërkombëtare – pra, subjektet kolektive të marrëdhënieve ndërkombëtare, mund të ndërtojnë materialin bazë të natyrës njerëzore, por ato marrin forma specifike historike, kulturore e politike, të cilat janë produkt i ndërveprimit njerëzor në një botë sociale.

Temat kryesore të ndryshimit, aktivitetit social dhe proceseve të ndërveprimit nxjerrin në pah vlerën e shtuar të konstruktivizmit brenda një fushe që ka vënë theksin tek përgjithësimi në kohë, tek materializmi dhe zgjedhjet racionale. Megjithatë, sikurse është pohuar më parë, “jo të gjithë konstruktivistët e kanë kënduar himnin nga e njëjta partiturë”. Shumica e konstruktivistëve kanë paraqitur një lloj kritike ndaj racionalizmit. Megjithatë, në ndryshim nga poststrukturalizmi, kjo kritikë nuk ka përfshirë një mohim tërësor të metodës shkencore. Marrëdhënia midis individit dhe strukturës sociale është e rëndësishme si për racionalizmin ashtu dhe për konstruktivizmin, por ajo konceptohet në mënyra të ndryshme. Për racionalistët struktura është në funksion të konkurrencës dhe të shpërndarjes të aftësive materiale. Pikësëpari, dhe çka është më e rëndësishme, strukturat kufizojnë veprimet e shteteve. Subjektet e racionalizmit udhëhiqen nga një logjikë pasojash. Sipas kësaj të fundit një veprim racional është një veprim që do të prodhojë një rezultat që maksimalizon interesat e njësisë individuale. Racionalistët hamendësojnë një botë egoistësh *apriori* dhe jo-socialë, të cilët interesohen pikësëpari për interesat e tyre materiale. Ndërsa

konstruktivistët nuk e mohojnë rëndësinë e interesave, ata i lidhin ato më drejtpërdrejtë me identitetin e subjektit. As identiteti dhe as interesat nuk mund të shqiten prej një bote me kuptimësi sociale. Siç sugjerohet në seksionin e mëparshëm, identiteti, si për shembull një demokraci liberale, nuk mund të veçohet dhe as të shqitet nga interesi në prodhimin e përfitimit. Në mënyrë të ngjashme, identitetet mund të formohen në konflikt, për shembull si armiq që kanë interes të vetëmbrohen. Përtej të qenit i shkëputur nga bota materiale, identiteti dhe interesi që e pason atë, mund të përbëjnë një botë të populluar nga lloje specifike objektesh.

Çështja e qëllimshmërisë në përvijimin e objekteve ose institucioneve materiale ngre një tjetër çështje rreth rolit të arsytimit njerëzor. Shumë konstruktivistë janë bazuar në një konceptim veberian të *Verstehen* (të kuptuarit), i cili i referohet temës hermeneutike se “veprimi duhet kuptuar gjithnjë nga brenda” dhe, kështu, kuptimi social është funksion i asaj “çka ndodhet në mendjet e njerëzve” (Adler 1997: 326). Theksi konstruktivist në *Verstehen* është interesant pasi Webber ishte gjithashtu një burim i hershëm i modelit të aktorëve racionalë. Ndërsa racionalistët nënvizojnë racionalitetin e vendimeve në lidhje me interesat vetjake duke minimizuar kështu rolin e kontekstit, konstruktivistët kanë rikthyer dimensionin social brenda tij. Kuptimësitë ndërsubjektive nuk janë vetëm kolektorë grumbullues të bindjeve individuale, por kanë një status të pavarur si dije kolektive, bazuar në nocionin se, ndonëse “secili prej nesh ka mendimet e tij, konceptet tona i ndajmë me bashkëqytetarët tanë” (Toulmin 1972: 35). *Verstehen* nënkupton “interpretimet, praktikat dhe institucionet e përbashkëta të vetë aktorëve” (Adler 1997: 326).

Theksi tek *Verstehen* nxjerr në pah një ngjashmëri e një ndryshim midis racionalistëve dhe konstruktivistëve. Dallimi qëndron në faktin se racionalistët e vënë theksin tek individi kurse racionalistët tek socialja. Megjithatë, nëse hedhim një vështrim më në brendësi të rolit të dijes individuale dhe të racionalitetit në konstruktivizëm, atëherë ndryshimi fillon e venitet. Logjika e përshtatshmërisë e vë theksin tek individi (Sending 2002). Proceset e mendimit racional të Alter dhe Egos së Wendt (1992) i paraprijnë ndërveprimet social. *Verstehen* thekson njohjen dhe atë që ndodhet “në kokë” (Adler 1997: 326).

Siç u nxor më lart në pah, konstruktivizmi shton qartazi një dimension social i cili mungon në qasjet racionaliste. Gjithsesi, ai përmban disa mospërputhje, por ato do të shqyrtohen në seksionin pasardhës. Këto mospërputhje e paqëndrueshmëri lindën prej kombinimit të ontologjisë sociale me epistemologjinë. Ky kombinim bazohet në ndarjen e botës së jashtme nga proceset e brendshme të mendimit të individëve. Në këtë tablo konstruktivizmi përfshihet në gjuhën pozitiviste të shkakësisë dhe testimit të pandehmës, duke u plotësuar me fokusimin tek racionaliteti i individëve, ndonëse të ngulitur më thellë brenda një konteksti social. Theksi në njësinë individuale të analizës, qoftë ai individ ose shtet, nuk arrin të shprehë në mënyrë të mjaftueshme problematikën e formësimit të njësisë individuale. Duke pasur parasysh theksin tek ontologjia, errësohet autonomia e sociale dhe roli i gjuhës, si në marrëdhëniet që ata kanë me botën materiale ashtu dhe me dijen individuale.

Konstruktivistët shfrytëzojnë një ontologji ndërsubjektive. Ata theksojnë normat, faktorët dhe strukturat sociale si dhe përbërjen e ndërsjellë të identitetit, megjithëse pranojnë një epistemologji që i detyrohet pozitivizmit, e cila përfshin testimin e hipotezave, shkakësisë dhe të shpjegimit. Ted Hopf (1998: 171) argumenton se theksi mbi ontologjinë është pjesë e përpjekjes për të kapërcyer një pjesë të skepticizmit rreth konstruktivizmit – skepticizëm që lind nga një përplasje me qasjet postmoderne– si dhe për shkak se supozohet që konstruktivistët janë ambivalentë karshi metodave shkencore sociale të rrymës mbizotëruese. Hopf e dallon konstruktivizmin “konvencional” nga distanca që ky ruan prej teorisë kritike. Ai i referohet konstruktivizmit konvencional si një “tërësi parimesh, i dalë nga teoria sociale por pa përndjekjen më të qëndrueshme teorike dhe epistemologjike të kësaj të fundit” (Hopf 1998: 181). Si racionalistët ashtu dhe konstruktivistët pretendojnë se nuk i ndajnë diferenca të mëdha epistemologjike ose metodologjike (Wendt 1998: 116; Katzenstein, Keohane dhe Krasner 1998: 675).

Si qasje, konstruktivizmi nuk e pranon përpjekjen neorealiste ose neolibérale për të kërkuar dhe gjetur ligjësi shkencore. Në vend të tyre, ai synon të identifikojë përgjithësime të mundshme dhe shpeshherë, si formë shpjegimi, ofron një përshkrim të dendur. Disa prej debateve më të rëndësishme në shkencat sociale dhe sidomos shkencat politike sot vërtiten

rreth kuptimit të termave *sovrانيتet, të drejtat e njeriut dhe interpretime të ndryshme politike të doktrinave fetare*, çështje për të cilat konstruktivistët kanë më shumë për të thënë ngase qasjet e tjera më të vjetra (Barnett, f. 260). Ndonëse herë pas here të formuluar lirshëm dhe të papajisura me ndonjë fuqi parashikuese, qasjet konstruktiviste na kujtojnë atë çka mungon shpeshherë nga realizmi dhe liberalizmi. Është e rëndësishme të shohim përtej racionalitetit instrumental të ndjekjes së objektivave aktualë dhe të shtrojmë pyetjen si ndonjëherë identitetet dhe interesat e ndryshueshme mund të sjellin ndryshime të papritura në politikat shtetërore, të cilat mund të shoqërohen me ndryshime të thella në strukturën sociale. Konstruktivistët na ndihmojnë të kuptojmë si formësohen preferencat dhe gjykimet.

Epistemologjia pozitiviste bazohet në përkimin e teorisë së gjuhës, pra objektet supozohet se ekzistojnë pavarësisht domethënies, kurse fjalët veprojnë si etiketa emërtimi për objektet brenda këtij realiteti. Testimi i hipotezave përfaqëson një shprehje të kësaj hipoteze rreth gjuhës. Kjo është një metodë e krahasimit të pohimeve shkencore rreth botës me vetë botën për të parë nëse ato korrespondojnë. Në të kundërt, një epistemologji konstruktiviste, si produkt i kthesës linguistike, është ndërtuar bazuar në nocionin se nuk mund të shkojmë përtej gjuhës sonë për ta krahasuar atë me atë çka përfaqëson (shih Wittgenstein 1958). Gjuha është më tepër e lidhur ngushtësisht me botën sesa një pasqyrim i saj. Gjuha e një figure kalorësi në lojën e shahut, nuk mund të ndahet nga objekti material; pikërisht nëpërmjet kësaj gjuhe ne mund të dallojmë kalorësin dhe rregullat që aplikohen mbi të nga një pjesë druri.

Dallimi midis konstruktivistëve konvencionalë dhe atyre kritikë bazohet shpeshherë në pandehmën se e para pranon ekzistencën e një bote objektive, kurse e dyta thekson ‘vetëm dhe thjesht’ gjuhën. Megjithatë, sikurse vëren Kratochwil (2000: 91), “vështirë se mund të dyshojë ndokush se ‘bota’ ekziston ‘pavarësisht’ mendjeve tona. Çështja është në fakt nëse mund ta njohim dhe pranojmë këtë në mënyrë të pastër e të drejtpërdrejtë [...] ose nëse ajo çka njohim e pranojmë është gjithnjë e organizuar dhe formuar paraprakisht nga disa elemente të caktuar kategorikë dhe teorikë.” Përcaktimi ‘ose/ose’ i botës objektive



përkundrejt relativizmit interpretativ është tepër i ngurtë. Një qëndrim më i nuancuar e kupton gjuhën si të bazuar në rregulla.

Përgjithësisht në debatin midis racionalistëve dhe konstruktivistëve është injoruar roli i gjuhës. Shmangia e gjuhës është pjesërisht reflektim i përpjekjes për të krijuar distancë nga poststrukturalistët, të cilët lidhen me relativizmin interpretues. Ajo simbolizon gjithashtu një reflektim të fokusit që terreni i ndërmjetëm ka mbi ontologjinë. Një qasje ndaj gjuhës e cila është në përputhje me ontologjinë sociale të konstruktivizmit duhet të zërë gjithashtu një hapësirë të ndërmjetme epistemologjike. Midis një pikëpamjeje të gjuhës si një pasqyrë e botës ose interpretim i pastër, qëndron kuptimi i gjuhës e i veprimit si të bazuara mbi rregulla. Ky konceptim i gjuhës bazohet në një dallim midis rregullave (shqetësimi i konstruktivistëve) dhe interpretimit (siç theksojnë poststrukturalistët). Të ndjekësh një rregull ndryshon prej interpretimit të tij. Siç pohon Wittgenstein: “Ekziston një mënyrë e të kuptuarit të ligjit e cila nuk është *interpretim*, por ekspozohet në atë që ne e quajmë: ‘t’i bindesh një rregulli’ dhe ‘ta thyesh atë’ në rastet e jetës reale. Por duhet ta kufizojmë interpretimin e termit në zëvendësimin e një shprehjeje të rregullit me një tjetër.” (Wittgenstein 1958: para. 201)

Pikëpamja unitare e shkencës bazohet në dikotominë midis objektivitetit dhe subjektivitetit. Sipas kësaj qasjeje gjuha operon si një grup emërtesash për realitetin objektiv ose për proceset mendore të individëve. Por kjo dikotomi sfidohet nga një qasje konvencionale konstruktiviste ndaj gjuhës. Sipas kësaj pikëpamjeje përdorimi i gjuhës është rrënjësisht social. Ne shoqërizohemi brenda saj dhe gjatë procesit mësojmë jo vetëm fjalë, por edhe si të veprojmë në botë – çfarë do të thotë të premtosh, kërcënosh e gënjesh, llojet e konteksteve në të cilat këto akte ligjërate janë të përshtatshme ose marrin kuptim, madje edhe se çfarë do të thotë të formulosh një pandehmë, të votosh ose të dislokosh një raketë. Gjuha është pjesë e veprimit në botë. Pa gjuhën ne nuk do të mund të fillonim të komunikojmë me njëri-tjetrin, t’u jepnim kuptim objekteve ose të vepronim në botë, të kishim mendime individuale ose të shprehnim ndjenjat tona. Testimi i hipotezave në shkencat pozitiviste bazohet në pandehmën se emërtimet mund të jenë të vërteta ose të pasakta. Një qasje që e koncepton gjuhën të bazuar mbi rregulla kërkon të “vështrojmë dhe

të hulumtojmë” mënyrën se si vihet në përdorim gjuha nga aktorët socialë ndërsa këta ndërtojnë botën që i rrethon. Kategoritë etnike ndërtojnë dallime të qarta historike, fetare e politike midis grupeve të ndryshme. Këto kategori kanë filluar si interpretime, pasi ato zëvendësuan një rregull identiteti me një tjetër, por ato morën tipare rregullash në përvijimin që i bënë identitetit por edhe në veprimet që e pasuan këtë. Në tranzicionin nga Jugosllavia drejt konflikteve të dhunshme, fqinjët, të cilët kishin jetuar në paqe për shumë vite, u bënë objekte të spastrimeve etnike. Një qasje konstruktiviste konsekuente ndaj gjuhës e zhvendos theksin drejt prodhimit të kuptimit, normave e rregullave nga subjektet e analizës, sikundër ato shprehen në gjuhë. Gjithashtu ajo shqetësohet më pak për qëllimet e individëve, sikurse sugjerojnë konstruktivistët konvencionalë (shih March dhe Olson 1989; Sendin 2002; Adler 1997), sesa qëllimi i shprehur në veprimtarinë sociale. Siç pohonte Wittgenstein (1958: para. 337): “Një qëllim ngulitet në situatën e tij, në zakonet dhe institucionet njerëzore”. Papajtueshmëria tjetër në dukje në ndërtimin e konstruktivizmit *vis-à-vis* racionalizmit është theksi i vazhdueshëm tek shkakësia (Checkel 1997, 1998; Finnemore 1996: 28; Adler 1997: 329). Në sipërfaqe kjo shfaqet si një çështje e thjeshtë e përdorimit të fjalëve. Por shkrirja e arsyeve dhe e shkaqeve ngre një pikëpyetje edhe më serioze që ilustron nga shembulli pasues.

Sidoqoftë, konstruktivizmi ndryshon nga teoria kritike, në theksin e saj mbi *analizën empirike*. Disa konstruktivistë kanë vazhduar të punojnë në nivelin meta-teorik (Onuf 1989; Wendt 1999), por shumica kanë kërkuar qartësime konceptuale dhe teorike përmes analizës sistematike të enigmave empirike. Ekuilibri i studimit kritik është zhvendosur në këtë mënyrë prej mënyrave të mëparshme të argumentit abstrakt filozofik drejt studimit të komunikimit dhe praktikës njerëzore përtej kufizimeve të ngushta të teorive klasike sociologjike. Aty ku teoricienët kritikë të valës së parë e kishin hedhur poshtë përshkrimin racionalist të qenieve njerëzore si egoistë atomistë dhe shoqërinë si hapësirë strategjike –duke ofruar një përfytyrim alternativ të qenieve njerëzore si shoqërisht të mishëruara, të ndërtuar në mënyrë komunikuese dhe kulturalisht të sanksionuar–konstruktivistët e kanë përdorur këtë ontologji alternative për të shpjeguar dhe interpretuar aspekte të tjera të formësimit të identitetit, duke futur edhe studimin e ndërthurjes së kombit me fenë. Dhe aty ku teoricienë më të hershëm kanë dënuar metodologjinë neo-pozitiviste të

këtyre pikëpamjeve, duke bërë thirrje për mënyra analize më interpretative, racionale dhe historike, konstruktivistët i kanë përdorur këto teknika për të çuar më tej studimet empirike. Në këtë mënyrë, studimi i tolerancës fetare në rastin shqiptar inkuadrohet fare mirë në teorinë konstruktiviste, si pjesë e hulumtimit empirik të diskursit nacionalist, përkundrajt atij fetar.

## **2.2 Hipoteza kryesore e studimit dhe nën-hipotezat**

### *2.2.1. Hipoteza*

Toleranca dhe harmonia ndërfaqetare në Shqipëri ka shërbyer si komponent ekzistencial i identitetit kombëtar shqiptar dhe është sendërtuar në mënyrë konstruktiviste bazuar në diskursin publik të etërve themelues të kombit dhe procesin historik të shekullit të XX-të.

### *2.2.2. Nën-Hipotezat*

Toleranca dhe harmonia fetare në Shqipëri ka qenë komponent jetik për formësimin e një identiteti homogjen shqiptar në fillimet e shekullit të XIX.

Roli i klerit shqiptar ka qenë vendimtar në promovimin e këtij procesi dhe në eliminimin e përplasjeve fetare.

Diskursi rilindas dhe ai fetar kanë patur si emërues të përbashkët prioritizimin e formësimit të një identiteti të përbashkët kombëtar, duke vendosur në plan të dytë identitetin fetar.

### *2.2.3. Shqyrtimi i literaturës ekzistuese*

Ekziston një shumëllojshmëri materialesh, studimesh dhe reflektimesh mbi rolin që ka luajtur kleri, ligjërimi klerikal dhe në përgjithësi realiteti i bashkëjetesës fetare në Shqipëri, por si risk, qëndron fakti që studimet janë të panjohura për lexuesin shqiptar, pasi nuk ka shumë botime në gjuhën shqipe dhe autorët janë kryesisht të huaj.

Teza e punimit është bazuar në të dhëna empirike dhe në punë kërkimore në terren, e cila përfshin udhëtime nëpër qytete të ndryshme shqiptare me peshë argumentuese sa i

përket temës në fjalë do të jenë pjesë e kampionit tim. Rezultatet e kërkimit në terren janë të tilla që mundësojnë marrjen e informacioneve shkencërisht të sakta, pa tonalitete e ngarkesa psikologjike, duke ruajtur kështu aspekte etike të punës në terren, përmes një plani zbatimi korrekt e konkret, bazuar në skemën e krijuar tashmë sipas linjës qendrore të temës.

Rezultatet kanë qënë të kënaqshme, pasi informacioni fizik i gjendur pranë bibliotekës Kombëtare, Akademisë së Shkencave të Shqipërisë si edhe pranë bibliotekave të shumë prej organizatave jo-fitimprurëse që kanë investuar në këtë lëmi, më kanë mundësuar kontakte fizike me libra, shënime, revista dhe me çdo format tjetër.

Ndërkohë, vështirësitë dhe kufizimet e hulumtimit qëndrojnë në aspektin e shumëllojshmërisë së materialeve jo krejtësisht me baza të vërteta shkencore, materiale me prezencë të qartë ndjesish e qasjesh psikologjike si dhe në oshilacione që shfaqin autorë të ndryshëm përmes trajtesave të tyre të dykuptimta dhe ambivalente.

### **2.3. Objektivat e kërkimit në terren**

Prej objektive kryesore të punimit ka qënë kontributi në literaturë mbi këtë tematikë, kontributi për çdo bibliotekë përmes një studimi cilësor akademik.

Duke hulumtuar në botime e shkrime të ndryshme, duke pasur parasysh faktin që tema është konceptuar bazuar mbi ligjërimin kritik lidhur me *tolerancën*, unë sjell këtë këndvështrim teorik të natyrës kritike.

Nëpërmjet teorisë konstruktiviste, si metodë e hulumtimit shkencor, ky studim paraqet karakteristikat thelbësore të marrëdhënieve mes shqiptarëve sa i përket jetës sociale në përgjithësi dhe asaj “fetare” në veçanti.

Analiza dokumentare përfshin marrjen e të dhënave nga dokumentet ekzistuese, pa pasur nevojë të marrim në pyetje njerëzit përmes intervistës, pyetësorëve ose vëzhgimit mbi sjelljen e tyre. Analiza dokumentare është rruga kryesore që kryesisht historianët por jo vetëm ata marrin të dhëna për subjektet e tyre kërkimore, por analiza mund të jetë gjithashtu një mjet i vlefshëm për shkencëtarët bashkëkohorë socialë, studiues të ndryshëm etj.

Dokumentet janë materiale të prekshme në të cilat rregjistrohen fakte apo ide dhe realitete. Në mënyrë tipike, artikujt e shkruar ose të prodhuar në letër, të tillë si artikuj gazetash, të dhënat e politikave qeveritare, fletëpalosje dhe procesverbaleve të mbledhjeve, artikuj në media të tjera kanë qenë objekt i analizës dokumentare, përfshirë filmat, dokumentare, libra studimorë, faqe të ndryshme në internet, fotografi etj.

Disa dokumente janë pjesë e fushës publike dhe janë lirisht të qasshme, ndërsa dokumentet e tjera janë klasifikuar konfidenciale dhe jo në dispozicion për publikun. Në këtë sens kam pasur mundësinë të hulumtoj mbi tekste të rëndësishme të vençantë pranë Bibliotekës Kombëtare dhe materiale të rëndësishme pranë organit të Komunitetit Musliman të Shqipërisë, kopje të hershme të Revistës "*Zani i Naltë*" etj .

#### **2.4. Struktura e punimit**

Ky disertacion paraqitet brenda një kornize konceptuale dhe rasti studimor ku dhe dalin në pah qartë anët e forta dhe të dobëta të qasjes së zgjedhur dhe se si kam arritur t'i adresoj ato në çështje që kanë të bëjnë më shumë me çështje teknike se sa konceptuale.

Gërshetimi i materialeve të ndryshme dhe sjellja në dritë e shumë realiteteve të palexuara më parë kanë ndihmuar në orientimin drejt metodave të zgjedhura kërkimore, përfshirë bazën teorike dhe literaturën mbështetëse të tyre. Unë mendoj se metoda është "provuar dhe testuar" dhe për këtë jemi mbështetur në materiale autentike mbi të cilat dalin qartazi rezultatet, ku patjetër që ka hapësirë për të diskutuar në kuadro edhe më të gjera.

Kështu, kjo temë kërkon të parashtrojë dhe parashikojë një pasqyrë kronologjike të marrëdhënieve sociale politike, duke përfshirë ngjarjet kyçe që kanë ndodhur kryesisht brenda periudhës së marrë në studim, si bazë për analizën e dimensioneve të marrëdhënieve bilaterale ose multilaterale ndërmjet këtyre nëse do shpreheshim kështu mes komuniteteve, atij musliman, të krishterë dhe orthodox, por edhe përmes fjalës dhe ligjërimit klerikal. Kjo tezë do të diskutojë marrëdhëniet më tipike dhe realitetet ideologjike ndërmjet këtyre dy apo më shumë komuniteteve kryesisht në vitet e marra në studim.

Më tej do të paraqiten perceptime sociologësh, politologësh e ekspertësh të fushave të ndryshme lidhur me rendin ndërkombëtar si edhe me çështje të perceptuarit të tyre dhe se

si ata ndërtojnë identitetin shqiptar nën lupën e të vëzhguarit të tyre përmes konceptimit mbi sjelljen, etikën qeverisjen apo mirëqeverisjen e një shteti karakterizuar për një harmoni ndërfaqetare që njihet në mbarë botën.

#### *2.4.1. Metodologjia e ligjërimit fetar në transmetimin e predikimeve fetare në institucionet shqiptare të kultit sot.*

Si një rast studimor do të përzgjidhet metodologjia e ligjërimit fetar nga klerikët e angazhuar në institucionet myslimane të kultit në Shqipëri, për shkak të veçorisë që ajo mbart në raport me mesazhin fetar. Referuar ligjërimeve të përfaqësuesve të komunitetit mysliman në Shqipëri, konstatohet se format e përcjelljes së mesazheve janë të shumëllojshme. Ato kombinohen me mesazhe me karakter social, janë të diversifikuar në raport me grupin dhe shtresën e individëve që u drejtohet mesazhi, si dhe me kuadrin historik në të cilin operohet.

1. Lloji i parë i ligjërimeve të vërejtura nga klerikët myslimanë shqiptarë lidhet me shpjegimin e teksteve në gjuhën arabe, duke filluar nga Libri i Shenjtë, Kurani. Ky lloj diskursi fetar nuk përqendrohet vetëm tek problemet gjuhësore, por analizon në thellësi dhe në detaje edhe problemet ideore. Sa i takon diskursit linguistik, ligjërimi i përfaqësuesve të komunitetit mysliman në Shqipëri tenton të ruajë të saktë shqiptimin dhe leximin e drejtë të tekstit të shenjtë. Megjithatë, historikisht janë vërejtur një sërë vështirësish, që lidhen me kuadrin teorik, përgatitjen fetare, analizën kuptimore dhe përmbajtësore në shpjegimin e tekstit, në zbërthimin e kuptimeve dhe interpretimin e problemeve që paraqet një Hadith (e njohur ndryshe edhe si Fjala Profetike) apo citim uranor në një paragraf apo disa prej tyre, sipas tematikës së caktuar. Në këtë punim doktoral, hulumtimin e diskursit fetar do ta mbështet mbi një sërë shembujsh, si ai i intelektualit të shquar të fesë Islame në Shqipëri, Hafiz Ibrahim Dalliu, përkthyes dhe studiues i Kuranit; Hafiz Ali Korça, Hafiz Ismet Dibra, Vehbi Dibra, etj. Të gjithë këta studiues dhe intelektualë në predikimet e tyre në gjuhën arabe dhe atë shqiptare kanë marrë në shqyrtim elementët përbërës të doktrinës fetare dhe kanë ofruar studime të plota analitike,

gjuhësore e kuptime të predikimeve fetare myslimane. Leximi i saktë i tekstit të Kuranit që merr parasysh grupet ritmike brenda frazës i ka ndihmuar ata që të përkthejnë e të komentojnë përmbajtjen duke orientuar e udhëhequr problemet që trajtohen në predikimet e ndryshme apo në Hytbe.

2. Një lloj tjetër diskursi është ai që transmetohet nëpërmjet përkthimit dhe shpjegimit të teksteve nga gjuha arabe në gjuhën shqipe, duke filluar nga libri i shenjtë, Kurani. Intelktualët shqiptarë kanë dhënë një kontribut thelbësor jo vetëm historik por edhe bashkëkohor për procesin e përkthimit dhe interpretimit të Kuranit në gjuhën shqipe. Kjo është bërë në periudha të ndryshme historike dhe ka synuar të ofrojë një kuadër sa më të plotë interpretimi të doktrinës fetare jo vetëm për institucionet e kultit dhe përfaqësuesit e tyre, por edhe për besimtarët e thjeshtë, për t'u ardhur atyre në ndihmë me transmetimin e njohurive, normave dhe parimeve të fesë Islame. Megjithatë, kontributi i intelektualëve shqiptarë ka vijuar edhe me përkthimin e librave të tjerë në gjuhën shqipe, të cilët lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë me doktrinën fetare myslimane, për të krijuar më tej një mundësi studimi dhe thellimi në fenë myslimane për të gjithë besimtarët shqiptarë që paraqesin interes të thellojnë njohuritë e tyre sociologjike dhe antropologjike në këtë drejtim.
3. Një lloj tjetër diskursi është ai i ndërthurur me proceset edukative. Këtë diskurs në rastin e këtij studimi e shohim tek raporti i udhëheqësve fetarë të komunitetit mysliman me: a) edukimin kulturor, fetar dhe social të brezit të ri të individëve, sidomos nëpërmjet institucioneve edukative si Medresetë (ku ndër më të spikaturat prej tyre është Medreseja e Tiranës); dhe b) nëpërmjet procesit të drejtimit të institucioneve të kultit.
4. Një tjetër formë e përcimit të mesazhit është nëpërmjet organizimit të një programi të qartë dhe të detajuar me tematikat e nevojshme për t'u trajtuar në institucionet e kultit. Bëhet fjalë për programet për të cilat përfaqësuesit e institucioneve të kulteve përgatiten, i studiojnë në mënyrë sistematike dhe ua prezantojnë besimtarëve në forma të ndryshme dhe në periudha të ndryshme kohore. Një fenomen i tillë është i shtrirë në kohë dhe rezulton të jetë zbatuar (siç do të provohet më poshtë gjatë këtij

punimi doktoral) edhe në epokat e mëparshme të historisë së fesë në Shqipëri, përveçse ai tashmë është shumë i pranishëm në ditët e sotme. Në këtë mënyrë besimtarët informohen në mënyrë të strukturuar por edhe të organizuar nga pikëpamja shkencore për çështje të besimit. Gjithmonë për të vërtetuar saktësinë e dispozitave të Islamit është nxitur përdorimi i argumentimit të mbështetur në citimet e drejtpërdrejta në Kuran, për ta kuptuar e për ta bërë më të qartë idenë e shprehur në një Hutbe ose në vazë (predikim). Kështu mund të marrim si shembull në këtë rast intelektualin më të spikatur në Shqipëri të Islamit, Hafiz Ismet Dibra, i cili ka bërë një cikël të mirëfilltë temash shkencore me një shprehje të vetme uranore: “A ke dyshim në ekzistencën e Zotit?”<sup>9</sup> Aty Hafiz Ismet Dibra sjell një tërësi argumentesh jo vetëm prej citimeve të Librit të Shenjtë (Kuranit), por edhe duke arsyetuar mbi to mbi baza mirëfilli shkencore, në kuptimin e shkencave sociale. Sipas Dibrës: *“E gjithë natyra që flet është argument i një Krijuesi të plotë-ditur e të plotfuqishëm, pa një fillim e pa një mbarim kohor; që nëpërmjet ligjeve krijoi çdo gjë dhe më të përsosurin njeriun, që i dhuroi mendjen për të shfrytëzuar gjithçka. Ai përgatiti për të.”* (Dibra, *ibid.* f. 40-44). Në procesin e ligjërimit të tij Hafiz Ismet Dibra siguroi një lidhje më organike midis ligjëratis me edukimin e besimtarëve, me formimin si teorik ashtu dhe praktik në adhurimin e pesë kohëve të ditës, të agjërimit etj. Si teolog i shquar dhe mendimtar i thellë i fesë Islame Hafiz Ismet Dibra njihte mirë dhe problemet sociale e ato psikologjike.

5. Një tjetër formë e diskursit fetar lidhet me programin e diferencuar, veçanërisht për ditët me kuptim të veçantë shpirtëror dhe të pasqyruara si të tilla në dokumentet themeltare fetare (si e Premtja, Muaji i Madhërishtëm i Ramazanit, etj.). Programi i zgjedhur përshtatet jo vetëm me nevojat e besimtarëve, por edhe të komunitetit. Në fakt ky i fundit jo domosdoshmërisht përfshin vetëm besimtarët myslimanë. Në të vërtetë format dhe metodat janë ato që i japin gjallëri brendisë së temës që paraqitet veçanërisht për ditët e Premte, të festave fetare si të Ramazanit, Bajramit etj. Për të tilla raste përcaktohen synime e kërkesa organizative me në qendër besimin me

---

<sup>9</sup> Për më shumë mbi këtë tematikë, shih librin e Hafiz Ismet Dibrës: “A ke dyshim në ekzistencën e Zotit?”, Shtëpia Botuese “Lilo”, fq. 37-130).



vetëdije të plotë tek hyjnorja që përshkon të gjithë boshtin e një teme të caktuar, e lidhur ngushtë me edukimin, formimin e besimtarëve me njohuri të shëndosha me normat e parimet e islamit dhe me rregullat praktike të adhurimit. Në përputhje me kërkesat organizative të festave madhore të Islamit leksionet predikuese bashkë me adhurimin (faljen) janë zhvilluar kryesisht në mjedise të hapura për mungesë mjedisesh institucionale të përshtatshme. Këtu duhet përdorur një metodë më aktive mbasi niveli është i gjerë që përfshinë jo vetëm mosha të ndryshme, por edhe nivel arsimor e kulturor të ndryshëm e më të lartë. Veprimtari të tilla kërkojnë orientime e horizonte për metoda më efektive dhe jo standarde.

6. Një formë tjetër diskursi shfaqet shpeshherë në organizimin e diskutimeve në institucionet e kultit (xhami) dhe/ose nëpër konkurse të ndryshme të testimi të njohurive fetare. Synimi në këto raste është gjithëpërfshirja dhe interaktiviteti mes ligjëruesit dhe besimtarëve. Në raste të veçanta, predikuesit në qytete kanë zhvilluar takime në grupe duke përdorur metoda problemore, kërkimore, konkursi e diskutimi të gjerë. Në këtë pikë vlen të theksohet edhe eksperiencia personale e doktorantit në këtë punim doktoral. Një ligjërimit të tillë e kam bërë dhe unë në praktikën e punës time si predikues institucioni. Mbi bazën e udhëzimit të shpalljes hyjnore të Kuranit që është themeli i Islamit, kam shtruar idetë e tij nëpërmjet këtyre metodave të cilat kanë rritur interesin e pjesëmarrësve për mësimin e fesë Islame dhe për edukimin e të rinjve me vlerat e tij. Për të ndërtuar metoda sa më efektive kërkimore dhe për të forcuar aftësitë analitike nga çdo drejtues i një xhamie që me gjuhën fetare quhet imam, kërkohet ndërtimi i një teksti bazë, i programuar, mbi bazën e kritereve të studiuara me anëtarë të shquar të fesë Islame, teologë të afirmuar me eksperiencë të gjatë pune, sepse niveli i tyre nuk është në shkallën e duhur tek të gjithë institucionet. Kjo krijon mundësi që besimtarët të njohin e të kuptojnë më mirë konceptet e Islamit dhe nuk i lihet rast spontanitetit ose jo të sakta për normat e parimet e fesë Islame. Po kështu besimtarët njihen përmes këtyre formave të edukimit dhe forcimit të aftësive dhe kapaciteteve të tyre analitike me një volum të caktuar njohurish të fesë Islame si dhe në nivel më të lartë, që nuk lejon interpretime të ndryshme. Teksti i Hoxhës në strukturën e ndërtimit synon që

programi javor të kompaktësohet me të gjithë imamët, si vazhdim i njëri-tjetrit duke krijuar një lidhje organike mes tyre.

#### *2.4.2. Metodatat e diskursit fetar (të ligjërimit dhe predikimit fetar) në institucionet e kultit fetar (xhamitë)*

Metodat e të ligjërimit nga predikuesi fetar janë rrugët, mënyrat, ecuritë e predikimit, didaktika që përdor përpara auditorit (në këtë rast i njohur ndryshe edhe si “xhemati Islam”) për transmetimin e njohurive fetare sipas temave të posaçëm të përcaktuara dhe të përzgjedhura qartë, kuadrot fetarë, predikues e imamë duke u mbështetur tek Shpallja Hyjnore (i njohur ndryshe në këtë rast edhe si Kurani – i cili përbën bazën prej nga ku burojnë të gjitha ligjet e Fesë Islame) përgatiten për të referuar Hutben ose vazin para faljes me një metodë të caktuar. Metoda e zgjedhur e ligjërimit fetar influencon direkt tek përmbajtja e ligjërimit përkatës dhe efektivitetin e tij te dëgjuesit. Në vijim të këtij punimi, për të pasqyruar edhe më qartë rastin studimor të analizës dhe interpretimit të diskursit fetar, duke shfrytëzuar kuadrin teorik të teorisë së konstruktivizmit social, do të paraqiten një sërë metodash praktike dhe teorike të ligjërimit fetar që janë përdorur ndër vite nëpër institucionet e kultit në Shqipëri, në kuadrin e predikimeve të doktrinës fetare Islame.

1. *Shpjegimi:* Kjo metodë përdoret për të paraqitur një material të ri, i cili është rëndom i vështirë për t’u kuptuar nga shtresa të caktuara shoqërore. Metoda e shpjegimit ka të bëjë më së shumti me probleme të interpretimit të ligjeve që rrjedhin nga Kurani. Fjala e predikuesit duhet të jetë e qartë dhe e saktë. Ajo duhet të jetë në gjendje të krijojë bindje të plotë tek dëgjuesit në auditorin e objektit të kultit (Xhamisë). Materiali referues duhet të jetë i zbërthyer mirë, duhet të gjejë shprehje dhe argumentim të thelluar në Librin e Shenjtë (Kuranin) dhe të bazohet gjithashtu në argumente të tjera shkencore, për të krijuar një unitet në mes shkencës dhe fesë. Shpallja Hyjnore është burim i të gjitha diturive, pasi ajo konsiderohet si fjala e Perëndisë e dërguar në Tokë nëpërmjet profetit Muhamet.
2. *Kallëzimi* – Kjo metodë përdoret për të përshkruar ngjarjet më të rëndësishme të njerëzve të shquar si profetët Ibrahim, Jakub, Jusuf, Musa, Isa (Mesiha) dhe në fund

Muhamedi a. s. Të gjithë këto kanë ngjarjet e veçanta e mrekulli shumë të ndjeshme praktike. P.sh. H. Ibrahim desh të flijojë djalin e tij Ismailin për të vërtetuar besnikërinë ndaj Zotit të Lartësuar. (Kuran 3 / 33; 4 / 54; 6 / 161; 87; 19 / 54; 38 / 48). H. Jusuf i hedhur në pus nga vëllezërit për smirë e xheloz, shpëtoi nga karvani tregtar. (Kur'ani 12/3 – 104; 40/34 ); H. Musa i sapolindur, e ëma detyrohet ta fusë në një kuti e ta hedhë në lumin Nil, e shpëton Faraoni, ai që dha urdhër për zhdukjen e të gjithë djemve meshkuj që do të lindin. (Kur'ani 51; 53 / 55; 60; 61; 67 / 87; 92; 108; 136; 246; 248). H. Isai me shkopin magjik shëronte njerëz (Kur'ani 2 / 84; 3 / 45; 60; 4 / 156-159; 171; 172; 5/17; 46; 72; 75; 109). H. Muhamedi me mrekullinë e Kuranit (2 / 177; 8 / 41; 9 / 60; 17 / 24), etj. Të gjitha këto i kanë bërë sipas Perëndisë si argumente që njerëzit të besonin se ekziston një Zot. Kallëzimi është bërë me mënyra të tilla që të ushtrojnë ndikim te dëgjuesit, të ngjallë te ata emocione e vlerësime mbasi kallëzimi ka pas renditje logjike.

3. *Bashkëbisedim i drejtpërdrejtë*: Kjo është metoda më e thjeshtë e predikuesit, që përdoret si brenda institucionit të kultit ashtu dhe jashtë tij. Biseda po organizohen dhe nga imamët në grupe për tema të caktuara e veçanërisht ato praktike për rregullat e disiplinën e adhurimit, faljes së namazeve ditore etj.
4. *Konkursi*: Kjo metodë është përdorur me grupet e të rinjve që grumbullohen në ditë dhe orar të caktuar për të mësuar të lexojnë Librin e Shenjtë – Kuranin, si dhe tema rreth islamit. Në fund të çdo viti me grupet e ndryshme të xhamive brenda qytetit e jashtë tij organizohen konkurse dhe jepen çmime simbolike. Kjo mënyrë ka ngjallur interes tek të rinjtë dhe i ka nxitur ata që të marrin informacion sa më shumë rreth islamit, për ta bërë besimtar të devotshëm.

Nga pikëpamja metodologjike është me interes që ky punim diplome të analizojë impaktin e synuar të ligjëritimit fetar që realizohet në institucionet e kultit?

1. Krijimin e një komunitetit të identifikuar mbi bazën e besimit fetar.
2. Instalimin e një marrëdhënieje të veçantë të bashkëpunimit dhe të ndihmës së ndërsjellë pa shpërblim mes anëtarëve të këtij komuniteti të identifikuar mbi bazë

feje (në përgjithësi anëtarët e një komunitetit fetar mbi bazën e besimit e identifikojnë njëri-tjetrin si vëllezër dhe motra).

3. Promovimin e normave të moralit të mirë, si karakteristikë dalluese e anëtarëve të komunitetit, si një shprehje e devotshmërisë ndaj urdhërimeve të Krijuesit.
4. Identifikimi dhe promovimi i praktikave të mira dhe i modeleve të mira në komunitet.
5. Pjesëmarrje e përbashkët në praktikat e adhurimit.
6. Pjesëmarrja e përbashkët në ligjërimet e drejtuesve të institucionit fetar dhe në diskutimet në xhami që ndikon drejtpërdrejt në edukimin e besimtarëve dhe orientimin e tyre në praktikat më të mira.
7. Komuniteti i krijuar dhe i identifikuar mbi bazën e besimit fetar krijon premise për respekt, mos-cënim dhe bashkëjetesë me komunitetet e tjera të krijuara dhe identifikuar mbi bazën e besimeve të tjera fetare.
8. Promovimi i vlerave të respektit, bashkëjetesës, bashkëpunimit dhe mbrojtjes në momente të vështira si një shprehje e pjekurisë dhe forcës në besim të komunitetit fetar.

Po cili është roli i përfaqësuesve të komunitetit fetar në ligjërimet fetare në institucionet e kultit? A ndikojnë në rezultat veçoritë psikologjike të ligjëruesve fetarë dhe aftësive teologjike të tyre?

1. Në procesin e kualifikimit të kuadrit fetar por edhe të vetë-kualifikimit marrin rëndësi dhe proceset psiko–didaktike që lidhen drejtpërdrejtë me aftësitë e tij dhe metodën e organizimit të ligjërimet në Hutbe apo predikime gjatë procesit të adhurimit. Domethënë kërkohet një përgatitje e mirë e tij me kulturë të përgjithshme dhe teologjike e psikologjike.
2. Nga shkalla e përgatitjes së kuadrit fetar, imami, drejtues i institucionit të kultit, i formimit të tij psikologjik e metodik, varet drejtpërdrejtë niveli i ligjërimet. Një imam i ditur, i kulturuar me horizont të gjerë kulturor fetar, dallohet për saktësi në transmetimin e rregullave, dispozitave të fesë Islame. Një imam i tillë gëzon autoritet e respekt tek besimtarët, ndihmon në përgatitjen e duhur edukative të tyre,

kontribuon në ushqimin e tyre shpirtëror dhe nxit energjinë e besimit për të përballuar me sukses të gjitha pengesat që i dalin në jetë.

3. Prandaj është i domosdoshëm kualifikimi për zgjerimin e horizontit kulturor në njohjen e problemeve sociale, duke i paraprirë vazhdimisht me burime të informacionit fetar, që ka në themel besimin te Zoti si i vetmi ilaç shërimi i plagëve të shoqërisë. Sukses në punën e detyrën fisnike që ka çdo imam do të ketë kur ai është i ngritur e i formuar psikologjikisht e nga pikëpamja e metodës së përçimit të mesazhit fetar – pra kapaciteteve të tij komunikuese dhe diskursive. Gjithashtu rëndësi të veçantë marrin edhe aftësitë dhe shkathtësitë e tij në organizimin e procesit të ligjërimit. Këto aftësi e ndihmojnë imamin apo predikuesin të ndjekë dhe qëndrimin e besimtarëve, sa ata janë të interesuar të dëgjojnë. Në rastet kur ai sheh lëvizje duhet menjëherë të ndryshojë metodë për të tërhequr vëmendjen e tyre e për ta bërë bisedën tërheqëse.
4. Në praktikë ndodh që disa predikues e përqendrojnë vëmendjen vetëm tek shpjegimi apo kallëzimi i materialit dhe nuk ndjekin auditorin, i cili mund të humbasë vëmendjen kur diskursi fetar nuk i tërheq apo është e nivelit të ulët. Me një fjalë predikuesi duhet të jetë i aftë të kuptojë atmosferën psikologjike të dëgjuesve që kanë ardhur për të kryer detyrimin fetar, ku disa predikues që janë vetëm zbatues mekanik të parimeve, normave e kërkesave të Islamit. Ata bëhen skllav të skemave të vjetra stereotipe metodike e shabllonizmit të traditës. Prandaj është i domosdoshëm kualifikimi i kuadrove fetarë, imamëve për gjetjen e të rejave në fushën e ligjërimit të strukturës, brendisë, formave, metodikave e mjeteve të tij. Kjo do të bëjë të mundur dhe autoritetin e tij. Ky autoritet do të rritet kur në personalitetin e tij do të manifestohen cilësi psikologjike e aftësi teologjike. Gëzojnë autoritet dhe ata imamë që dallohen për figurën e pastër morale, që janë shembull në familje dhe në jetë, që nuk e ndajnë fjalën nga veprimi. Besimtarët e besimtarët e vlerësojnë imamin e tyre nga e gjithë sjellja në jetën e tij, nga ndershmeria, drejtësia, shpirtmadhësinë në mendime, gjykime e veprime. Ndërsa ftohtësia, indiferentizmi dhe dobësi në kualifikim nuk gëzojnë autoritetin dhe respektin tek besimtarët e zonës tij.

5. Ka rëndësi të veçantë për imamin mënyra e komunikimit me besimtarët dhe me të gjithë komunitetin ku jeton. Por në ligjërim të folurit e imamit duhet të jetë i gjallë, i qartë, shprehës, me ngjyrimë emocionale, i saktë dhe dashamirës. Pra, të përshkohet nga emocionet e ndjenjat e tij; i aftë për të zotëruar të gjithë auditorin e tij.
6. Në aftësitë didaktike të imamit duhet të dallohet për organizimin e drejtë të Hutbes apo predikimit mbi baza të shëndetshme në Kuran e në Hadith, në përcaktimin e çështjeve që do të trajtojë si dhe në metodën e përshkrimit të gjithë këtij procesi.

## 2.5. Etimologjia e fjalës “tolerancë”

Është e rëndësishme të bërit e dallimit etimologjik të fjalëve, kryesisht në shqip, të *tolerancës* dhe *tolerimit*. *Tolerimi* është një *set* i çuditshëm vlerash; ai është, siç vëren Bernard Williams (f. 126), ende i pamundur, por edhe i nevojshëm brenda shoqërisë bashkëkohore pluraliste, ku mosmarrëveshjet midis personave janë një aspekt i përhershëm i jetës. Domosdoshmëria e *tolerancës* është një mësim historik që e pati fillësën në luftërat fetare të shek. XVI dhe që vazhdon të nxisë polemikat më të fundit mbi fetë në sferën publike, që përfshijnë debate akoma banale mbi mësuëset myslimanë të veshur me *hixhab*, përdorimin publik të simboleve fetare në Gjermani, ku ndalohet *burka* në Francë dhe ndalohet zëri i lartë nga minaretë në Zvicër. Shembuj të tjerë përfshijnë argumentet mbi praktikën e ndasive gjinore që ka një fe nga tjetra, kundërshtitë e dhënies homoseksualëve të drejta të barabarta për institucionin e martesës dhe sensibilitetet në lidhje me lirinë e shprehjes së ekstremistëve.

*Toleranca* është një qëndrim i pranuar nga besimet e ndryshme dhe praktikat e të tjerëve që provokojnë pakënaqësi në ato që palët ndjekin si linjë të besimit të tyre dhe nuk mund të përcillen me indiferencë ose skepticizëm. Toleranti duhet të ketë arsye për të refuzuar praktika të tilla, si p.sh. besimet e kundërta ose të ndryshme, martesat e homoseksualëve, ndërsa në të njëjtën kohë duhet të rendisë më lart arsye morale për pranimin e tyre. Megjithatë, ky është rasti ku koncepti i *tolerancës* duket i pamundur. Si mund të artikulojmë një tipar dallues të *tolerancës* bazuar në arsye morale?

Në secilin nga shembujt e përmendur, praktika institucionale e *tolerancës* është përcaktuar shpesh nga kuptime të ndryshme të rrethanave, në të cilat toleranca është përgjigja e duhur.

### 2.5.1. A ka kufinj toleranca fetare?

Arsyet për këtë: *tolerancës i duhen gjetur kufijtë e duhur*. Pra, justifikimi objektiv i *tolerancës* do të jetë i njëjti arsyetim: se do të gjejmë qëndrime të veçanta e joarbitrare që vetëm kufizojnë<sup>10</sup>. Tipar kryesor i kësaj strategjie është të bëhet dallimi mes *idesë politike* dhe asaj *morale* të *tolerancës*. Dallimi mund të gjendet në përdorimin e fjalëve mbi *tolerancën*, përkatësisht në mes qëndrimeve personale të saj, në njërën anë, dhe praktikave sociale të institucioneve, nga ana tjetër, secili duke kontribuar në një *kulturë të tolerancës* në mënyrën e tyre të veçantë.

Unë do të përpiqem të tregoj në këtë studim se një justifikim koherent i praktikës institucionale të *tolerancës* është i mundur vetëm nëpërmjet qëndrimit personal, si virtyt moral-politik i unifikuar. Por, unë do të përpiqem për të treguar edhe të anasjelltën: se *një qëndrim moral ndaj tolerancës kërkon njëkohësisht praktikën e tolerancës*. Dallimi në mes këtyre dy projekteve është gjetur në *rregullimin strukturor* të një *regjimi të tolerancës*, një lidhje me justifikimin demokratik dhe të tjera arsyetime si ato *lejimet e babait*.

Rrjedhimisht, këtu trajtohen së pari *bazat morale* të *tolerancës*, se si qëndrimi moral i *tolerancës* lidhet me praktikat institucionale dhe vazhdimësia e debatit moral dhe politik mbi *tolerancën* mund të gjejë një mënyrë për të dalë nga natyra e tij paradoksale; kështu, ne mund të ripërcaktojmë rolin e saj në aranzhimet bashkëkohore politike të shoqërive liberale pluraliste.

Ky deduksion i lë vënd krijimit të një justifikimi moral parimor të *tolerancës*, bazuar në dy pozicione strukturore dhe parimore të justifikuara moralisht në një regjim të saj. *Pozicioni i parë* thekson përdorimin demokratik të *tolerancës*, si një virtyt moral-politik që përfshin identifikimin e një parimi normativ moral të *reciprocitetit*, që është vlerë

---

<sup>10</sup> J. Hampton, *Should Political Philosophy Be Done without Metaphysics*, f. 802.

demokratike. *Pozicioni i dytë* e vë theksin te *babai alternativ i tolerancës*, si një virtut politiko-moral, i themeluar mbi parimin moral të *autonomisë*.

Do të ishte me shumë vlerë edhe diskutimi mbi kufijtë e *tolerancës*, duke parë e hulumtuar problemet e një kufiri të pacaktuar për tolerancë, nga të cilat justifikimi parimor i *tolerancës* do të përdorej për të krijuar një limit të vendosur dhe të veçantë për 'të. Në këtë pikë, argumentet janë të trefishta: pretendimi qëndror është se një kombinim i parimeve morale të *reciprocitetit* (në bazë të konceptimit si *respekt* dhe *autonomi*, bazuar në *konceptin e lejimit*), përbëjnë një bazë më bindëse në të cilat justifikohet praktika e tolerancës. Kjo përfshin argumentin se koncepti *babai i tolerancës* në bazë të autonomisë mund të krahasohet me një version modern dhe liberal edhe ai klasik konceptin e lejimit mbi *tolerancën*.

Së fundi, mund të thuhet argumenti se *koncepti mbi rrespektin*- i tolerancës në bazë të reciprocitetit është i nevojshëm në fund të fundit të miratojë të njëjtin tip *konceptin e lejimit*, nëse dëshiron të mbajë një sistem të realizueshëm të tolerancës që do të përcaktojë limitet e duhura.

### 2.5.2 Gjenealogjitë e tolerancës

*"Toleranca është një prej arteve të bukura"* - Rainer Forst

Nëse ne do të kemi të fortë argumentin për të mbrojtur *tolerancën* dhe kufijtë e saj, ne do të na duhet një kuptim i qartë i kësaj *vlere universale*. Prandaj kam menduar se është e rëndësishme që unë të vendos së pari çfarë mendoj të përfshij në këtë kuadër. Literatura mbi këtë temë sjell idenë mbi *tolerancën*, por në dimensionet e ndryshme:

- Çfarë do të thotë nga filozofët *tolerancë* dhe në çfarë konteksti është që ajo të kuptohet?
- Pse kaq shumë filozofë besojnë që ajo të jetë një ide hutuese ose e pakapshme?

Kuadri i saj social është i rregulluar e i strukturuar dhe ne duhet të analizojmë se si mund të përcaktohet ajo në nivel personal dhe publik.

### 2.5.3. Konturet e tolerancës



Para se të jap një pasqyrë të kontureve kryesore të *tolerancës*, kam theksuar se në të kuptuarit e kësaj dukurie shoqërore ndikon edhe njohja e zhvillimit leksikor historik. Me këtë, *toleranca* vjen si një nozologji konceptuale e ngushtë dhe njëkohësisht e gjerë. Së pari, nëpërmjet literaturës analitike, disa shkrimtarë këmbëngulin në përcaktimin e qëndrimit mbi *tolerancën* në një pikëpamje reptësisht të ngushtë, që zvogëlon qëllimin e konceptit për kushtet e saj teorikisht të dallueshme nga disa karakteristika të tjera teorike që konsiderohen të jenë të ngjashme ose të barabarta me idenë e saj.

*Toleranca* duhet, për shembull, të shoqërohet me mosmiratimin e fortë apo në kundërshtim me besimet dhe praktikatat e të tjerëve që vërtet nuk i përjashton, por edhe thjesht nuk i "pëlqen". Kjo optikë jo aprovuese është konsideruar zakonisht si kërkesa më përcaktuese për 'të, sidomos nga autorë të tillë si Heyd, Galeotti, Scanlon dhe Williams.

Nga ana tjetër, autorë të ndryshëm pretendojnë përcaktimin e *tolerancës* në një mënyrë më të gjerë ose më gjithëpërfshirëse, e cila lidh konceptin e tolerancës me një larmi të madhe të konteksteve dhe përdorimeve gjuhësore, në mënyrë që ajo të mos kufizohet në gjendjen e një mosmiratimi të fortë.

#### 2.5.4. Koncepti liberal i tolerancës

Shumica e filozofëve politikë e mendojnë *tolerancën* si një koncept të dallueshëm liberal ose si një parim kryesor të *liberalizmit*. Kjo optikë e percepton atë si një praktikë sociale, që më vonë do të vijë për të shpjeguar një kontur tjetër të saj. Jean Hampton e quajti atë "zemra thelbësore e liberalizmit" ndërsa për Ross ajo "zë një vend qendror për liberalizmin"<sup>11</sup>. *Toleranca*, në këtë drejtim, është konceptuar si një virtyt konstituiv i *liberalizmit* apo si një koncept i nevojshëm nga një sjellje e *liberalizmit* konceptuar në bazë të rregullimit të të drejtave dhe vlerave të njohura liberale. *Toleranca*, në këtë mënyrë, është e përqëndruar në idenë themelore liberale se "shteti ka një pengesë parimore mbi konceptet e së mirës drejt asaj të kundërtës dhe është ngarkuar vetëm me përgjegjësinë e mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve të tij: vendosjen e drejtësisë dhe barazisë mes tyre, në

---

<sup>11</sup> H. Ross, *Democracy*, 243

kuadër të të cilave mund të lulëzojë një qëndrim i tolerancës”. Ideja e tolerancës, si një koncept liberal, është hulumtuar nga John Rawls, Reiner Forst dhe Joseph Raz.

Respekti dhe koncepti i lejimit të tolerancës, marrëveshja strukturore e një regjimi të tolerancës është ose simetrike ose asimetrike në lidhje me sistemet e ndryshme të besimit dhe praktikave brenda shoqërisë. Asimetri e tolerancës është një konceptim klasik që Forst e quan "permission conception" të situatës, toleranca në marrëdhëniet asimetrike del në pah ndërmjet autoritetit të shumicës dhe pakicës mospërfillës në atë se "*kjo është prerogativë e fortë për të toleruar të dobët, ku të dobët nuk janë në gjendje të tolerojnë të fortët*"<sup>12</sup>. Është pikërisht në këtë kuptim që tolerimi është funksion i kushtëzuar hierarkik i shumicës që lejon praktikën e diskutueshme private të pakicës. Me fjalë të tjera, "*autoriteti i jep leje të cilësuar pakicës për të jetuar sipas besimeve të tyre, me kusht që pakica pranon pozitën dominuese të autoritetit apo shumicës*"<sup>13</sup>.

Në të kundërt, mendimtarët bashkëkohorë liberalë kanë riinterpretuar dhe ristrukturuar "konceptin e lejimit" për të aplikuar në mënyrë të barabartë ose simetrike mbi palët e ndryshme anët e forta që Forst identifikon si "konceptin e respektit" kundrejt tolerancës. Kjo ide mbart peshën më të madhe normative, duke apeluar për virtyt moral të tolerancës së mbajtur nga individë që respektojnë njëri-tjetrin si të barabartë dhe janë të mbrojtur nga që kanë të njëjtat të drejta, edhe pse kanë konceptime të ndryshme mbi "të mirën". Unë do të përqëndrohem në këtë dallim për të justifikuar praktikën e tolerancës.

#### 2.5.5. Koncepti sjelljes dhe koncepti praktik i tolerancës

Rëndësia e këtij konturi të fundit vjen në lidhje rrjedhimisht edhe me konturet e mëparshme, si një lloj ure analitike që njeh tolerancën si të dallueshme mes një qëndrimi personal dhe një praktike sociale. Dallimi i parë vendos kërkesat e tolerancës përtej sferës formale në fushën jo formale si një tipar karakteri personal. Dallimi i dytë e përcakton tolerancën si një regjim ligjor apo institucional dhe është aplikuar në praktikën e

---

<sup>12</sup> R. Forst, *Toleranz im Konflikt*, 47

institucioneve si një qëndrim apo edhe një virtyt i individëve. Në fakt, duhet nxjerrë në pah rëndësia e të dyjave brenda një shoqërie të orientuar mirë liberalisht.

Këto konture na ndihmojnë të shquajmë dallimin e *tolerancës* si një qëndrim apo mënyrë e gjykimit dhe si një praktikë sociale me qëllim tejkalimin apo unifikimin e vlerës së saj si një koncept politik dhe moral.

#### 2.5.6. Qëndrime mbi tolerancën

Në një deklaratë mbi 'vështirësisë apo kufizimet e të kuptuarit të *tolerancës*, Thomas Scanlon thekson: "*Toleranca kërkon që ne të pranojmë njerëzit dhe të lejojmë praktikat e tyre dhe që ne të jemi dakord fuqimisht me ta [...]. Toleranca përfshin kështu një qëndrim që është i ndërmjetëm në mes pranimit të përzemërt dhe opozitës së shfrenuar*"<sup>14</sup>.

Unë kam përfituar nga ky përkufizim si pikënisje e mirë, nga e cila filloj hetimin dhe qëndrimin lidhur me *tolerancën*. *Toleranca* ka fuqi normative në atë kuptim që ajo është një dukuri unike morale e që bazohet në virtyt personal dhe në tipare të karakterit individual. Në këtë mënyrë, unë e pranoj *tolerancën*- në këtë fazë paraprake- në lidhje me gjysmën e parë të qëndrimit të Thomas, çka mund të thuhet se është ambivalente mes një koncepti të ngushtë dhe një koncepti të gjerë të saj, d.m.th. se mund të jetë gjerësisht një qëndrim fasadë, që nuk mund të barazohet me një qëndrim të indiferencës apo edhe me një sjellje që duket e disfavorshme. Përndryshe, në qoftë se ne jemi të përgatitur për të përcaktuar konceptin mbi një konceptim të ngushtë në mënyrë specifike, ku të përfshihen dispozita që të mos dënojmë, denigrojmë ose të ndërhyjmë në praktikat dhe besimet e të tjerëve, atëherë një tjetër do t'i dënojë ashpër ato. Samuel Scheffler e quan këtë përkufizim si "*pamje e shtypur e mosmiratimit*"<sup>15</sup>.

David Heyd thekson se *lista gjenealogjike e tolerancës* mbart ngjashmëri që varen nga mënyra se sa vend zënë nocionet liberale në 'të, ndër të tjera: ndarja e kishës nga shteti, neutraliteti shtetëror, pluralizmi i vlerave dhe skepticizmit etj., që kanë të bëjnë me

---

<sup>14</sup> Scanlon (2003), p. 187

<sup>15</sup> Scheffler, f. 316.

rolin dhe qëllimin e *tolerancës*, si një qëndrim vetëm në koncept; por kjo është e vështirë për t'u përkufizuar<sup>16</sup>.

Në të vërtetë, literatura analitike mbi *tolerancën* na ka pajisur me një listë pothuajse të pashtershme të asaj që e dallon atë nga "*kompromisi, paqja ose bashkëjetesa, indiferenca, skepticizmi, njohja, pranimi, privilegji, mendja e hapur, durimi, dënimi, bamirësia, respekti, pluralizmi dhe më shumë se kaq*"<sup>17</sup>. Si pasojë, ka pak hapësirë për interpretimin dhe artikulumin e një ideje koherente nga ajo që ka mbetur.

Steven Wall thekson se një "person tolerant" qëndron mes karakterit të asaj që ai e quan "moskokëçarje" dhe "përndjekjes efikase"<sup>18</sup>. Ai e kupton një shoqëri tolerante si skeptike apo që nuk ka shqetësim, që nuk kujdeset të shkaktojë zemërim moral dhe që është indiferente, pak e bindur dhe që mezi e pranon diversitetin. Por duke mos qenë një intolerant absolutist, ai nuk ndërhyt në besimet dhe praktikatat e të tjerëve, por është për një kohëzgjatje të shkurtër.

Unë kam zgjedhur të vendos temperamentin tolerant në mes moskokëçarjes dhe persekutimit efikas, në vend të opozitës së papërmbajtur, për arsye strategjike, çka më lejon të nxjerr në pah rëndësinë që toleranca duhet të jetë e bazuar në arsye përtej arsyeve arbitrare e instrumentale të efikasitetit.

Përveç kësaj, mungesa e vullnetit për të ndërhyrë në sjelljen e të tjerëve, sipas pikëpamjes së një mosmiratimi të ngushtë, gjithashtu mund të shoqërohet me mosmiratimin e fortë të kësaj sjelljeje. Me fjalë të tjera, sjellja në fjalë duhet të konsiderohet moralisht e gabuar. Siç shprehet Heyd, "*Vlen të vëmë në dukje në këtë fazë një pozicion efektiv të pushtetit, atëherë kur na duhet të përcaktojmë një kornizë të pranuar për të ndërhyrë me të tjerët. Në këtë aspekt drejtimi drejt tolerancës është një i qëllimshëm zgjedhja e bërë lirisht nga një individ, si një vendim më tepër se një predispozicion i lindur*"<sup>12</sup>.

---

<sup>16</sup> Heyd, f. 176, 2010. Një pjesë e konsiderueshme e literaturës mbi tolerancën lidhet me përcaktimin terminologjik të asaj çfarë nuk është toleranca, por gjithsesi bëhet fjalë për një literaturë të pasur. Shih, për shembull, Jason Cohen, "*What Toleration Is*" (2004). Shembuj brenda literaturës analitike kanë përfshirë tolerancën jo si neutralitet, dorëheqje apo braktisje idesh.

## KAPITULLI III

### KONTEKSTI HISTORIK

#### 3.1 Harmonia ndërftare në Shqipëri gjatë viteve 1912-1945

Harmonia ndërftare është një nga vlerat e veçanta të traditës së popullit shqiptar. Është e njohur botërisht që shqiptarët shquhen për këto vlera, për një bashkëjetesë shembullore mes besimtarëve të besimeve të ndryshëm që janë në Shqipëri, kryesisht muslimanë dhe të krishterë, duke iu referuar ligjëtimeve konkrete të klerit musliman të botuara në revistat zyrtare të kohës.

Ky studim sjell thelbin/bazën e këtij fenomeni, rrënjët promovuese të këtyre vlerave, duke e parë nga një këndvështrim të pa trajtuar më parë, dhe, duke tentuar t'i japim përgjigje pyetjeve: *Nga buron harmonia ndërftare në Shqipëri? Cilët janë promovuesit kryesorë të këtij fenomeni? Cili ka qenë dhe është qëndrimi i klerit fetar në Shqipëri. A kanë qenë përfaqësuesit zyrtarë të klerit (hoxhallarët e priftërinjtë), promovues të harmonisë ndërftare në Shqipëri?*

Pikërisht, janë këto disa nga pyetjet që marin përgjigje në këtë studim, duke u bazuar në *ligjërimin fetar* që sa bukur dhe me sa sensibilitet e kanë trajtuar këtë çështje përpara besimtarëve apo përpara botës.

Krerët muslimanë, në momentet më delikate të historisë kombëtare, duke qënë se kanë gëzuar reputacion të padiskutueshëm dhe me shumë ndikim në pjesën më të madhe të popullsisë, jo vetëm që kanë promovuar harmoninë ndërftare, por i kanë konsideruar besimtarët e besimeve të tjera si "*vëllezër*" duke predikuar këtë bindje të tyre para besimtarëve muslimanë. Këto predikime kanë filluar me Haxhi Vehbi Dibrën, i cili ka qënë i pari Kryetar i Muslimanëve dhe mbarë hoxhallarët pa përjashtim deri në ditët tona.

Gjithashtu nuk harrohen predikimet e priftërinjëve si: At Gjergj Fishta, At Shtjefën Gjeçovi apo Mitropoliti Visarion Xhuvani, për ta mbyllur me perlat e priftit ortodoks Fan S. Noli, i cili mahnit botën me tre fjalimet e tij para liderëve botërore, para Lidhjes së

Kombeve, duke qënë përfaqësues i mbarë shqiptarëve edhe pse besimtarët ortodoksë ishin vetëm 20 % e popullsisë së vendit.

Harmonia ndërjetare prej shekujsh mbretëron ndër shqiptarët si një vlerë e traditës së vendit tonë, e cila e ka habitur e po i habit vazhdimisht të huajt, pasi e shohin një rast unikal këtë mardhënie bashkëjetese ndërjetare. Kjo traditë nuk është e sotme, ajo nuk është as traditë e 100 viteve të fundit, por është një traditë disa shekullore, që pas vendosjes përfundimisht të sundimit osman në trojet shqiptare në fillim të shek. XVI (1500).<sup>19</sup> Për këtë traditë dhe vlerë që posedojnë, shqiptarët janë krenarë dhe janë momente të veçanta të historisë së vendit, për të cilën mbarë shqiptarët ndjehen krenarë.

Ky fakt është vërtetuar dhe nga udhëtarë të huaj të cilët kanë vizituar vendin tonë goftë në momentet më deçizive, në momentet që lufta ishte normalitet. Një rast të tillë na e shpreh zonja britanike dhe admiruesja e shqiptarëve Znj. Edith Durham (në fillim të shek. XX), e cila thotë se: *Luftërat e dëgjuaara ndërmjet shqiptarëve janë gjithmonë për grindje ndërmjet bejlerëve kundërshtarë. Të krishterët në këtë rast luftojnë kundër të krishterëve dhe muslimanët kundër muslimanëve -madje ajo thekson se- Shqiptarët muslimanë e të krishterë, para armikut të përbashkët bashkohen.*<sup>20</sup>

Një fakt i tillë u vu në dukje që nga lëvizjet e shqiptarëve për autonomi, ku shumica e nismëtarëve ishin intelektualë fetarë, dhe një pjesë e konsideueshme e tyre ishin klerikë të besimeve të ndryshme që udhëhoqën shqiptarët drejt autonomisë. Madje në Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, më 28 nëntor të vitit 1912 në Vlorë, firmëtarët kryesorë dhe me peshë ishin klerikë të të gjithë besimeve. Por bashkëjetesa mes besimtarëve të besimeve të ndryshme arriti kulmin në Kuvendi i Vlorës kur u vendos që Qeveria e Përkohshme të ketë në kabinetin e saj, pjestarë të katër besimeve fetare, pavarësisht përqindjes së besimtarëve që kishte një komunitet fetar. Akoma më e shumë do të dukej bashkëjetesa fetare mes shqiptarëve në Janar të vitit 1920 Kongresin e Lushnjës kur Shqipëria u shpall Monarki Kushtetuese. Rolin e Monarkut e kishte një Këshill i Lartë i Regjencës i përbërë nga katër persona përfaqësues të secilit besim.

---

<sup>19</sup> Nga që gjatë Mesjetës luftërat fetare me karakter sundues të 'mbretërve fetarë' kanë qënë pjesë e pandarë e mbarë historisë së njerëzimit duke mos përjashtuar këtu dhe vendin tonë deri në vendosjen e sundimit osman dhe kalimit të shumicës së popullsisë në besimin e ri.

<sup>20</sup> Edith Durham; *Brenga e Ballkanit*, Tiranë 1991.

Ky material do të trajtoje praktika konkrete me vepra e klerikëve më me zë në vend, e kryefetarëve, ligjëratat e tyre drejtuar besimtarëve, apo dhe fjalimet në raste të ceremonive të veçanta.

### **3.2 Nacionalizmi, kombësia dhe feja**

Feja apo besimi janë karakteristika që shoqërojnë individin që në lindje, për shkak të përkatësisë së tij në një familje të caktuar, e cila i përket një besimi të caktuar ose për shkak të përkatësisë në një komunitet me një besim të caktuar. Ndaj që nga lashtësia njerëzit ishin të grupuar mes tyre në fise, të cilët përgjithësisht kishin një përkatësi fetare, kishin një besim. Në antikitetet dhe veçanërisht gjatë Mesjetës, feja u bë lider i padiskutueshëm i njerëzve jo vetëm nga ana shpirtërore, por dhe materiale, politike, ekonomike e sociale. Një fakt i tillë do të kundërshtohet fuqishëm në mbarimin e Mesjetës dhe në fillimet e kohës moderne. Humanistët dhe Rilindasit e traditave greko-romake, do të vinin në diskutim ‘autoritetin’ e padiskutueshëm të Kishës (në Perëndim). Rilindasit fjalët e ‘shenjta të Biblës’ ata do t’i kalonin domosdoshmërisht nga arsyeja, për t’i vënë në diskutim, për t’i arsyetuar para se t’i zbatojnë. Për ta nuk ishte e vërtetë "çfarë ishte zbritur nga Zoti", por e vërtetë ishte ‘çfarë arsyeja-llogjika njerëzore arrinte ta kuptonte’, në të kundërtën nuk kishte vlerë. Ata nisën të shenjtëronin, jetën, lirinë e fjalës, lirinë e pronës. Vërtetë këta ishin të ‘shenjta’ edhe më parë, por shenjtëria e tyre ishte përcaktuar nga Zoti dhe jo nga arsyeja.

Si fillim ‘përplasja’ u evidentua dhe u elaburua si term në Europë, pasi në botën islame, gjatë të njëjtës periudhë nuk mund të ekzistonte një fenomen i tillë, ngaqë në islam, domosdoshmërisht lideri politik është njëkohësisht dhe përgjegjës për fenë, dhe në fenë islame nuk mund të konceptohet që feja të jetë e ndarë nga pjesa tjetër e jetës, pra nga jeta sociale, ekonomike apo dhe politike e një vendi.

Pyetja shtrohet: Cili do të ishte ideali që do të zëvendësonte pozitën e fesë? Ideali i ofruar ishte kombësia dhe nacionaliteti, kjo për faktin se kishte impakt mbi interesat personale. Termi komb apo ‘kombësi’ do të kuptojmë një *bashkësi të qëndrueshme njerëzish që është formuar historikisht gjatë shthurjes së mardhënieve fisnore në bazë të*

*bashkësisë së gjuhës, të territorit e të kulturës, e cila ka ardhur duke u zhvilluar dhe duke u forcuar.*<sup>21</sup>

Ky fenomen që në Europë njihet me emërtimin ‘nacionalizëm=kombësi’ i ka fillimet në Francë gjatë fundit të shekullit XVII dhe që u përhap në mbarë Europën gjatë shekujve në vazhdim. Identifikimi i popujve me ‘nacionalitetin/kombësinë’ e tyre, u bë një fenomen i theksuar gjatë shekujve XIX – XX, por nacionalizmi nga kombësia ka një ndryshim të vogël, por shumë thelbësor.

Pak më lart shpjeguar kombësinë dhe se çfarë kuptojmë, me të, ndërsa nacionalizmi nënkupton: *Ideologjinë apo pikpamjen që sipas të cilës një komb quhet më epror ndaj kombeve të tjera.*<sup>22</sup> Këto dy terma pothuajse të njëjtë bashkohen në disa pika të përbashkëta por kanë ndarje thelbësore në qëllimin e përdorimit të termit.

Përtej ‘bashkimit’ në disa pika të përbashkëta pozitive që solli lindja e këtij termi-fenomeni të ri, nacionalizmi na solli një të keqe më të madhe, ndarjen me ‘komshinjtë’, ndarjen me ‘të tjerët’ të cilët nuk kishin të njëjtën origjinë, gjuhë, kulturë, tradita apo zakone të përbashkëta me ‘ne’, pra me ‘bashkënationalistët’. Kështu që ky fenomen nga një nismë fillestare pozitive, me kalimin e kohës u bë nismë e problemeve të shekujve të mëvonshëm në mbarë Europën.

Herët shfaqja e këtyre termave, në mbarë botën nuk shikohej ‘nacionaliteti-kombi’ si pikë bashkimi mes një grupi të caktuar njerëzish, por shikoheshin aspekte të tjera të jetës si: sistemi qeverisës, interesa të ndryshme, të cilat lidheshin përgjithësisht me Fenë apo Besimin që kishte secili popull. Ndërsa mbas periudhës së Humanizmit dhe Rilindjes, ky term u bë pikë bashkimi e përbashkët për popujt në mbarë Europën, ku shpesh përdorej për mirë gjithashtu dhe për keq.

Konotacioni negativ që mbart fjala nacionalizem, më shumë se kudo është ndjerë në rajonin e Ballkanit. Pikërisht me ‘nacionalizmin’, por tashmë duke i shtuar dhe ‘fenë’ nga pas, si faktor përforcues, u arrit që të motivoheshin shumë popuj për tu ngritur dhe për të mos u pajtuar me sistemin e Perandorive të Mëdha, veçanërisht me Perandorinë Osmane.

---

<sup>21</sup> Grup autorësh; *Fjalor i shqipes së sotme*; botimi i parë nga AKADEMIA E SHKENCAVE, Tiranë 1984; TOENA, Tiranë 2002, f. 594

<sup>22</sup> Grup autorësh; *Fjalor i shqipes së sotme*; botimi i parë nga AKADEMIA E SHKENCAVE, Tiranë 1984; TOENA, Tiranë 2002, f. 824



Duke bashkuar këta dy elementë, popujt nisën ndarjen mes ‘të gjithëve’ që ishin nën ombrellën e Perandorisë, dhe njëkohësisht motivoheshin që të bashkoheshin rreth ‘nacionalizmit dhe fesë’ së tyre që kishin, të ndryshëm nga ‘nacionaliteti dhe feja’ e Perandorisë. Në veçanti ky fenomen u nxit në Ballkan, për mospajtimin me sundimin osman, duke sjellë për disa popuj përfitime të mëdha deri në pavarësinë e tyre si: grekët, sllavët, bullgarët, rumunët etj., dhe për disa popuj të tjerë, të cilët nuk i kishin këta dy komponentë të përbashkët, solli probleme të mëdha deri në ‘rrezikun e shuarjes’ së tyre.

Konkretisht kjo ndodhi me shqiptarët, të cilët u bashkonin me ‘nacionalitetin’ por nuk mund të bashkoheshin me një fe, me një besim të përbashkët, pasi ishin multi-fetarë, dhe nuk mund ta ndryshonin këtë realitet.

Padyshim, nacionalizmi solli një destabilitet shumëdimensional në mbarë Ballkanin, si pasojë e së cilës kishin filluar dy luftëra të mëdha botërore. Për pasojë kjo gjë e bëri Ballkanin një shesh betejash dhe luftërash ndaj vetë vetes së tyre, me pikënisje ‘nacionalitetin’ të ndërthurur me besimin. Që nga viti 1830 kur nga Perandoria Osmane u shkëputën shteti grek e më pas ai serb, duke fituar Pavarësinë, deri në vitin 1912 kur u shpall i Pavarur dhe shteti i fundit në Ballkan, pra Shteti Shqiptar. Më pas po në Ballkan nisi Lufta e Parë Botërore, po ashtu edhe Lufta e Dytë. Kështu që Ballkani nga vitit i largët 1821 deri në vitin 1999 vetëm se ka zier nga luftëra të shumta politike, ekonomike, sociale, të cilat motivoheshin nga udhëheqësit nacionalisht dhe fetarisht.

Ne do të fokusohemi më shumë te pika e fundit e këtyre përpjekjeve për pavarësi. Kjo për faktin se nuk u konsideruan të mjaftueshme luftërat me motive ‘nacional-fetare’ që u bënë kundër Perandorisë Osmane, e cila kishte një besim tjetër nga besimi tradicional që kishin popujt e Ballkanit, por ‘luftërat’ fetare vazhduan dhe brenda shteteve nacionale. Këto beteja të reja ishin kryesisht kundër muslimanëve të cilët ishin pjesë e shteteve nacionale të sapoformuara, pasi nga aty ishte larguar sundimi shekullor osman.

Si rezultat rezulton një hakmarrje, vetëm për faktin se këta njerëz mbartnin besimin e ‘pushtesit osman’ ata u diskriminuan, u keqtrajtuuan, madje u dëbuan nga trojet e tyre,<sup>23</sup> në disa raste ndaj tyre u përdor jo vetëm lufta dhe genocidi.<sup>24</sup>

---

<sup>23</sup> Për më shumë shih Alexandër Popoviç “Islamizimi Ballkanin”, Dituria, Tiranë 2006.

### 3.3 Kleri fetar dhe krijimi i Shtetit Shqiptar

Krijimi i shtetit shqiptar ishte domosdoshmëri e zhvillimeve historike ndër rajonale, që fillon me shpalljen e Pavarësisë së vendit nga Perandoria Osmane, që në të njëjtën kohë është dhe nisma më e madhe e intelektualëve patriotë-atdhetarë e fetarë, si dhe një nga veprat konkrete të klerikëve drejt tolerancës dhe bashkëjetesës fetare të vendosur si Kriter i domosdoshëm për ekzistencën e këtij kombi.

Në këtë studim ne do të evidentojmë vetëm disa nga qytetet në të cilat kleri ishte nismëtar dhe firmëtar i aktit të Pavarësisë së qytetit. Ata ishin prezentë dhe ngritësit e flamurit të Pavarësisë së Shqipërisë.

Së pari, me qytetin e Elbasanit, i cili më 25 nëntor të vitit 1912 i parapriu Pavarësisë së qyteteve të tjera drejt ngritjes së flamurit Kuq e Zi me shqiponjë. Këtë veprim ata do t'ia përcjellin Vlorës në orët e para të datës 26, rreth orës 2 të natës, me një telegram ku ndër të tjera njoftojnë se: *“Gjithë populli ynë, myslimanë e të krishterë, me një za kanë pranuar independencën e Shqipërisë...”*<sup>25</sup> Ndër firmëtarët e aktit të Pavarësisë së Elbasanit përmendim: “Haxhi Hafiz Sulejman Kungulli, zv. i Mitrop. Papa (prift) Dhimitër Dhimitraku, Aqif Pashë Biçakçiu, Shefqet bej Vërlaci, Abdullah bej Tirana, kryetari i Bashkisë Alush Saraçi, Sheih Mahmut Guma, Sheih Xhafer Pasmaqja, Papa Beniamin Deliana, Serafin Jorgaqi, Beniamin Nosi, Taq Buda, imami Hysein efendi Dorazi etj. etj.”<sup>26</sup>

E njëjta situatë paraqitet në Tiranë e në Durrës, ku intelektualë e patriotë-atdhetarë me në krye klerikët më në zë të qytetit, më 26 nëntor 1912 shpallën Pavarësinë. Firmëtarët e Pavarësisë në qytetin e Durrësit ishin: Myderiz Abdylqerim Kurti, Myderiz Hysein Mulla-Alushi, myderiz Ali Kuli, Myderiz Hafëz Jusuf Gjoni, Ismail Benja, Mahmut Benja, Hysein dakoli, Hasan Tartari, Ismail Usta Sula, Rexhep Abdurrahman Berberi, Hysein Peni, Filip Sereqi kryeplaku i katolikëve, Aqif Çelkupa, Aleks Duka, Kristaq Rama, Sotir

---

<sup>24</sup> Këtu përmendim në veçanti gjenocidin ndaj popullsisë çame, po ashtu dhe ndaj disa qyteteve shqiptare në ish-Jugosllavi.

<sup>25</sup> *Telegram i Elbasanit 25/26 nëntor 1912*, Fevziu, Blendi; *100 vjet-një ekskursion në politikën e shtetit shqiptar nga 1912-2012*; Uet-Press, Tiranë 2012, fq. 21

<sup>26</sup> Kotherja, Hyqmet; *Pavarësia e Elbasanit 1912*; *Dy Lindje, Dy Perëndime*, Tiranë 2012, f. 7-9, gjithashtu dhe në Nosi, Lef; Dok. Nr. 2, *Dokumenta Historike 1912-1920*; Tiranë 2007, f. 83

Veveçka, Hamza Tahir Himi, Muhamet Qepaxhiu, Ymer Lutfi Mallkuçi, Musa Milaçi etj.<sup>27</sup>

Firmëtarët e Pavarësisë së Tiranës ishin: Fuad bej Toptani, Myderiz Sulejmani, Myderiz Hyseini, Xhelal bej Toptani, Myderiz Ismail Ndroqi, Refik bej Toptani, Abdullah Gjinali, sheih Ahmet Pazari, Isuf Aqif Banka, Selim Petrela, Ali Shyqyri, Nikollë Nishku, Papa Nikollë Papajani... etj.<sup>28</sup>

Në qytetin e Kavajës, të Peqinit, e të Lushnjës, rezulton e njëjta situatë, ku Pavarësia u shpall një ditë më pas, më 27 nëntor 1912. Firmëtarët e Pavarësisë në Kavajë ishin: Qazim Fortuzi, Sheih Hamid Kraja, Mustë Cara, Andrea Ekonomi, Haxhi Isuf Kazazi, Pal Xhumari, Besim Sinella, Haxhi Xhoi, Zenel Biturku, Kostandin Qosja, Sali Kullolli, Hasan Nexha etj.<sup>29</sup>

Firmëtarët e Pavarësisë në Peqin ishin: Kadri beu i Demir Pashës, Myftiu Abdylbaki Biça, Sheih Tahsin Gjinishi, Myderiz Sulejman Kuçi, Kryetar i Bashkisë Ahmet Kaziu, Arslan Ballhysa.<sup>30</sup> elementi i krishterë nuk është pjesë e firmëtarëve në Peqin, pasi në këtë qytet nuk kishte të krishterë.

Firmëtarët e pavarësisë në Lushnjë ishin: Myftiu sheih Ibrahim Karbunara, myderiz Sulejman Arapi, Kadri bej Karbunara, Emin bej Vokopola, Halid efendi Gramshi, Shaqir bej Lushja, Papa Jovani, Sulejman Korreshi, Llambi Xoxi, Haxhi bej Imshta, Fejzullah bej Imshta, Thanas Paftali.<sup>31</sup>

E vazhdojmë rrugëtimin tonë për në Kryeqytetin e Pavarësisë, në Vlorë, ku ishin mbledhur krye-atdhetarët, krye-intelektualët dhe krye-fetarët e vendit. Firmëtarët e Pavarësisë në 28 nëntorit të vitit 1912 në Vlorë ishin (vetëm disa) : Për Beratin: Sami Vrioni, Ilias Vrioni, Taq Tutulani, Babë Dud Karbunara; për Skraparin: Xhelal Koprencka; Hajredin Cakrani; për Lushnjën: Qemal Mullai, Ferit bej Vokopola, Nebi efendi Sefa; për Dibrën: Myfti Vehbi Agolli-Dibra, Hafiz Sherif Lëngu (që të dy ishin Kryetarë të Komunitetit Musliman Shqiptar 1912-29 dhe 1942-45); për Matin: Ahmet Zogu, Riza bej

---

<sup>27</sup> Nosi, Lef; Dok. Nr.13300; *Dokumenta Historike 1912-1920*; Tiranë 2007, f. 81

<sup>28</sup> Nosi, Lef; Dok. Nr.2103 dhe 7098; *Dokumenta Historike 1912-1920*; Tiranë 2007, f. 82-83

<sup>29</sup> SHqarri, Muharrem; *Atdhetari Sheh Hamid Kraja*; Ombra GVG, Tiranë 2014, f. 85

<sup>30</sup> Nosi, Lef; Dok. Nr. 1146; *Dokumenta Historike 1912-1920*; Tiranë 2007, f. 89

<sup>31</sup> Gripshi, Genc; *Historia e Peqinit*, Tiranë, 2014, f. 141

Zogolli, Kurt Agë Kadiu; për Ohrin dhe Strugën: Zyhdi Ohri, Dr. H. Myrtezai, Nuri Sojlli, Hamdi Ohri, Mustafa Baruti, Dervish Hima; për Durrësin: Abaz efendi Çelkupa, Mustafa Agë Hanxhiu, Jahja Ballhysa, Dom Nikoll Kaçorri; për Tiranën: Abdi Toptani, Murat Toptani; për Shijakun: Xhelal Deliallisi, Ymer Deliallisi, Ibrahim Efendiu; për Krujën: Mustafa Merlika-Kruja; për Elbasanin: Lef Nosi, Shefqet Daiu, Qemal Karaosmani, Dervish Biçaku; për Peqinin: Mahmud efendi Kaziu; për Gramshin dhe Tomorricën: Ismail Qemal Gramshi; për Gjirokastrën: Azis efendi Gjirokastra, Elmaz Boçe, Veli Harxhi, Myfid Libohova, Petro Poga, Jani Papadhopulli; për Përmetin: Veli Këlcyra, Syrja Vlora; për Tepelenën: Feim Mezhgorani; për Janinën: Kristo Meksi, Aristidh Ruci; për Çamërinë: Veli Gërra, Jakup Veseli, Rexhep Demi, Aziz Tahir Ajdonati; për Delvinën: Avni Delvina; për Korçën: Pandeli Cale, Thanas Floqi, Spiro Ilo; për Pogradecin: Hajdar Blloshmi; për Kosovën, Gjakovën, Plavë-Gucinë: Rexhep Mitrovica, Bedri Ipeku, Salih Gjuka, Midhat Frashëri, Mehmet Pashë Deralla, Isa Boletini, Riza Gjakova, Hajdin Draga, Dervish Ipeku, Zenel Begolli, Qerim Begolli; për Shkodrën: Luigj Gurakuqi; dhe përfaqësues për Vlorën ishin: Ismail Qemali, Zihni Abaz Kanina, Aristidh Ruci, Qazim Kokoshi, Jani Minga, Eqrem Bej Vlora; për Diasporën: Dhimitër Zografi, Dhimitër Mborja, Dhimitër Berati, Dhimitër Ilo, etj. etj.<sup>32</sup>

Pjesa më e madhe e këtyre personaliteteve që ishin firmëtarë të aktit të Pavarësisë, kanë qenë fetarë, për dy arsye, së pari si njerëz me influencë në popull dhe së dyti për shkak të arsimimit të tyre, edhe pse disa disa prej tyre ishin të arsimuar për teologji madje ishin klerikë të qyteteve përkatëse që gëzonin respekt dhe kishin reputacion të padiskutueshëm në popullsinë shqiptare gjatë viteve 1912-1920. Disa prej tyre ishin myderizë = mësues feje, disa të tjerë imamë apo priftërinj apo baballarë, të cilët drejtonin objektet e kultit të qytetit të tyre. Disa të tjerë ishin dhe në rolin e Myftiut apo të Metropolitit apo zv. Metropolitit, disa ishin Dhespotë e kështu me radhë, por disa prej këtyre klerikëve ishin dhe drejtues të Bashkive përkatëse, çka nënkupton një rrezik akoma më të madh për këta klerikë. Në këtë mënyrë përfaqësuesit e popullit në Kuvendin e Vlorës në vitin 1912 ishin muslimanë e të krishterë, dhe, një numër i konsiderueshëm i tyre ishin

---

<sup>32</sup> Frashëri, Kristo; *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë 28 nëntor 1912*; Akademia e Shkencave, Tiranë 2008, f. 91-94

Klerikë ndër të cilët: *Myftiu Vehbi Efendi Agolli, Hafiz Sherif Langu, Babë Dud (Jorgji) Karbunara, Taq (Dhimitër) Tutulani, Dom Nikoll Kaçorri etj.* Në ‘Kujtimet’ e tij Ismail (Qemal) Vlora e cilëson historike dhe me shumë rëndësi aktin e Pavarësisë. Ai shkruan se: ‘*Kuvendi Kombëtar, i përbërë prej delegatësh nga të gjithë anët e Shqipërisë pa dallim feje, të mbledhur sot (28.11.1912) në qytetin e Vlorës, shpalli Pavarësinë politike të Shqipërisë...*’<sup>33</sup>

Harmonia dhe bashkëjetesa mes klerikëve dhe besimtarëve të besimeve të ndryshme, arriti kulmin në Kuvendin e Vlorës, kur u mor vendimi që Qeveria e Ismail Qemalit do të ketë në kabinetin e tij, pjestarë të katër besimeve fetare pavarësisht përqindjes së besimtarëve që kishte në popull secili komunitet fetar. Duhet theksuar se Ismail Qemali në përzgjedhjen e Qeverisë nga ana e tij kishte përfshirë 8 personalitete me reputacion, të cilat ai i shikonte më të dobishëm për një jetë të gjatë të Qeverisë, derisa të normalizohej situata. Ky kabinet i propozuar nga Ismail Vlora nuk gjeti miratimin e të pranishmëve, pasi në përbërje të tij ishin vetëm muslimanë (sunni dhe bektashi) dhe nuk kishte të krishterë. Bab Dud Karbunara ishte i pari, i cili refuzoi këtë zgjedhje duke propozuar që Kabineti Qeveritar të ketë muslimanë e të krishterë, dhe për të ruajtur integritetin e secilit, personat të cilët do të propozoheshin duhet të zgjidheshin me votë nga të pranishmit.<sup>34</sup>

Votimi i Kabinetit të Qeverisë së Përkohshme, ishte një detyrë me shumë rëndësi, që u shtrua përpara Kuvendit të Vlorës, duke treguar në këtë mënyrë një tolerancë shembullore dhe njëkohësisht një akt demokratik, pasi në secilin post ministror u zgjodh personi i cili merte më shumë vota nga garuesit pavarësisht besimit që kishte. Qeveria e Përkohshme e Vlorës u formua mbi përkatësinë fetare të Vendit, me propozimin e Bab Dud Karbunarës në të duhet të mernin pjesë muslimanë e të krishterë, dhe secili ministër do të zgjidhej pasi të merte shumicën e votave të pjesmarrësve të pranishëm. Përfundimisht Qeveria e Vlorës kishte këtë përbërje: Kryetar i Qeverisë dhe ministër i Punëve të Jashtme, Ismail Qemal Vlora; Nënkryetar i Qeverisë, Dom Nikollë Kaçorri; zv. kryeministër (25.12.1912) Preng Bibë Doda; Ministër i Arsimit, Luigj Gurakuqi; Ministër i Punëve të

<sup>33</sup> Qemali, Ismail; *Kujtime*; Toena, Tiranë 2009, f. 418

<sup>34</sup> Për më shumë shih: *Përlindja e Shqipërisë, 1913 – 1914, Gazeta zyrtare e Qeverisë së Vlorës*

Brendshme, Myfit Libohova; Ministër i Financave, Abdi Toptani; Ministër i Luftës, Mehmet Pashë Dëralla (Tetova); Ministër i Drejtësisë, Petro Poga; Ministër i Punëve Botore, Mid'hat Frashëri; Ministër i Bujqësisë, Pandeli Cale; Ministër i Postë-Telegrafëve, Lef Nosi.<sup>35</sup>

Në vijim Kuvendit të Vlores i doli një detyrë tjetër që ishte përzgjedhja e Pleqësisë e cila do të përbëhej nga 18 persona. Me propozim të Ismail (Qemalit) Vlorës u vendos që Pleqësia të ishte 'mëkëmbëse' e Kuvendit, të kishte rolin e këshilluesit, kontrolluesit dhe bashkëpuntorit me Qeverinë, por kursesi ta rrëzonte atë.<sup>36</sup> *Me propozimin e Luigj Gurakuqit, Vehbi Dira u zgjodh Kryetar i Pleqësisë (Senatit) dhe nënkryetar u zgjodh Lef Nosi i një përkatësie tjetër fetare.*<sup>37</sup> njëkohësisht Vehbi Dibra ushtroi detyrën e zëvendësimit të Ismail Qemalit kur ky ishte jashtë vendit. Kuvendi i Pleqësisë nën drejtimin e të nderuarit Myftiut Vehbi Dibra mori shumë vendime me rëndësi, me një shembull konkret të demokracisë, të tolerancës dhe bashkëjetesës fetare.

Haxhi Vehbi Dibra, ishte I pari që ndërmori nismën e 'tolerancës dhe bashkëjetesës' fetare, me cilësinë e Kryemyftiut të Shqipërisë, zëri më i lartë i muslimanëve në Shqipëri, I cili dha Fetvanë (legjitimoi fetarisht) Pavarësinë e Shqipërisë. Fetvaja e tij iu kushtua legjitimitetit të Flamurit me shqiponjë, pasi kjo nuk u pranua nga disa myftinj të vendit dhe njëkohësisht nuk u pranua nga populli, por më e rëndësishme se shqiponja ishte fakti se a na lejohet ne të pavarësohemi/ndahemi nga Porta e [Lartë që ishte koncept i lidhur shumë ngushtë historikisht edhe me vendosjen e besimit musliman në Shqipëri, sepse një popull që bashkëjetoj me osmanët nën ombrellën e madhe të Perandorisë, që një një moment aq delikat të pranonin shpëputjen nga Perandoria. Haxhi Vehbi Dibra me pushtetin që gëzonte në rolin e Kryemyftiut të vendit dha fetvanë ku ndër të tjera arsyetoi se: "...me qëllim për të ruajtur bashkimin e popullit dhe për të ndaluar mosmarrveshjet e inatet dhe me qëllim që të sigurohet qetësia e përgjithshme, figura e shqiponjës duhet. Kjo fetva është e bazuar në Sheriat dhe sipas nevojës së kohës dhe të vendit..."<sup>38</sup> Vehbi Dibra nuk u mjaftua vetëm me

<sup>35</sup> Dervishi, Kastriot; *Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005*; Shtëpia botuese 55, Tiranë 2006, f. 23

<sup>36</sup> Grup autorësh; *Historia e popullit shqiptar III (periudha e Pavarësisë 1912-1939)*; Toena, Tiranë 2007, f. 18

<sup>37</sup> Xhelili, Qazim; *Vehbi Dibra – personalitet dhe veprimtar i shquar i lëvizjes kombëtare*; Albin, Tiranë, 1998, fq. 96

<sup>38</sup> A.Q.SH. Fondi *Qeverisë së Përkohshme e Vlorës*, Dosja III, 5/2, fleta 632

fetvanë që ta konsideronte këtë problem të zgjidhur, por Ismail Qemali i la kopetenca të plota që ta zgjidhte këtë problem ashtu si mendonte ai, në rrënjë, në bazë. Kështu që Haxhi Vehbiu shëtiti në disa qytete të vendit, duke biseduar me myftinj të dhe me muslimanët, të cilët përbënin shumicën dërrmuese të popullsisë, dhe në këtë mënyrë u stabilizua gjendja.<sup>39</sup> Kryemyftiu Haxhi Vehbiu në një farë mënyrë iu drejtua muslimanë shqiptarë që tashmë fati i tyre nuk ishte me Perandorinë, e cila si dukej po perëndonte, por nga ana tjetër, ata duhet të ishin të bashkuar rreth 'kombësisë' pavarësisht përkatësisë fetare që kishte gjithsecili prej tyre. Motoja e këtij kleriku dhe atdhetari të shquar ishte bashkimi dhe vllazërimi. Ai shprehej se: "*Atdheu ynë ka nevojë për bashkimin e vllazërimin kombëtar pa dallim feje.*"<sup>40</sup>

### **3.4 Liderët myslimanë; Kontributi edhe roli i tyre në Kongresin e Lushnjës**

Janari i vitit 1920 edhe një herë nxjerr në pah tolerancën dhe bashkëjetesën fetare ndërmjet shqiptarëve, e cila del akoma më shumë në pah në Kongresin e Lushnjës, kur Shqipëria u shpall Monarki Kushtetuese. Monarku dhe roli i tij iu la si përgjegjësi Këshillit të Lartë të Regjencës i cili përbëhej nga katër persona, përfaqësues të secilit besim. Ata ishin Abdi bej Toptani, musliman sunni; Aqif pashë Elbasani, bektashi; dr. Mihal Turtulli, ortodoks; dhe Luigj Bumçi, katolik.<sup>41</sup> Rast si unik edhe pse jo zgjidhje me mend, që mund të jetë si një ndër të vetmet raste në botë, që deri më tani nuk është parë dhe dëgjuar në historinë botërore.

Kongresi I Lushnjës për formimin të Qeverisë nuk e vendos kusht të domosdoshëm që përzgjedhja e antarëve të jetë sipas një ndarjeje që përputhet apo që është në propocion të drejtë me përkatësinë fetare, për këtë arsye vëmë re se Qeveria ka në përbërje të sajë pjestarë të të gjithë besimeve fetare, kjo bie në sy, prandaj edhe ndajmë mendimin se atdhetarët indirekt e kanë menduar këtë çështje me shumë konsideratë. Qeveria e parë e dalë nga Kongresi i Lushnjës kishte këtë përbërje: Kryeministri Sulejman Delvina, Eshref Frashëri zv. Kryeministër dhe Drejtor i Përgjithshëm i Punëve Botore, Ahmet Zogu

<sup>39</sup> Xhelili, Qazim; *Vehbi Dibra – personalitet dhe veprimtar i shquar i lëvizjes kombëtare*; Albin, Tiranë, 1998, fq. 106

<sup>40</sup> A.Q.SH. Fondi 482, Dosja, 14, viti 1925, f. 191

<sup>41</sup> Grup autorësh; *Historia e Popullit Shqiptar III; TOENA, Tiranë 2007, fq. 146*

ministër i Brendshëm, Mehmet Konica ministër i Punëve të Jashtme, Hoxhë Kadri Prishtina ministër i Drejtësisë, Ndoc Çoba ministër i Financave, Sotir Peçi ministër i Arsimit, Ali Riza Kolonja ministër i Luftës, dhe Bajram Curri, Hysen Vrioni, Spiro Jorgo Koleka që të tre ministra pa portofol.<sup>42</sup> Kongresi pati mbështetje nga të gjithë si klerikë dhe atdhetarë në mbarë vendin, duke e mbështetur kështu Qeverinë që doli nga Kongresi i Lushnjës, madje duke i hapur rrugën drejt një kryeqyteti të ri, drejt Tiranës. Qeveria e Sulejman Delvinës përfundimisht u vendos në Tiranë me mbështetjen e familjes Toptani, si dhe nën kujdesin e hoxhës së nderuar Ismail Ndroqit<sup>43</sup> i cili ishte Kryetar i Bashkisë së Tiranës,<sup>44</sup> gjithashtu nën kujdesin dhe të klerikëve të tjerë potent, pjesmarrës aktivë në eventin në fjalë ose jo.

### **3.5 Vazët<sup>45</sup>, hytbet<sup>46</sup> dhe artikujt në shërbim të misionit të shtetbërjes**

Me të vërtetë jam ndjerë i privilegjuar pavarësisht faktorit kohë që hulumtoja në rreth kësaj teme, megjithëse është e pamundur që në pak rreshta ne të përmendim dhe të analizojmë të gjitha ligjëratat, fjalimet apo bisedat publike që ka bërë kleri musliman në këtë drejtim, nuk ka dyshim se e njëjta frymë ruhet te të gjithë artikujt kështu që unë po sjell më të spikaturat. Sjell në kujtesë hytbet(ligjërimet javore) të Haxhi Vehbi Dirës, i cili si Kryetar i Muslimanëve (1912-1929) por dhe si Kryetar Nderi (1929-1937) nuk reshti së predikuari para muslimanëve të “vëllazërisë” mes shqiptarëve, pa dallim rrace, ngjyre dhe fejë. Jo vetëm ai, të gjithë hoxhallarët e tjerë ishin në të njëjtën linjë, të cilët i promovuan këto vlera kudo që iu jepej mundësia, si p.sh. gjatë vazëvë (predikimeve të ditës së para faljes së Xhumasë/Premtes), apo dhe në këshillat ditore që jepnin për besimtarët muslimanë. Gjejmë haptaz qartë pa asnje luhajtje, predikim tepër rigoroz mbi tolerancën dhe bashkëjetesën fetare të shqiptarëve, e duke dhënë shembullin se si duhet të vendoset paqja

---

<sup>42</sup> Dervishi Kastriot, *Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005*; Shtëpia botuese 55, Tiranë 2006, f. 108

<sup>43</sup> Grup autorësh; ENCIKLOPEDI – 100 Personalitete shqiptare të kulturës Islame gjatë shek. XIX – XX; KMSH, Tiranë 2012; f. 103-106

<sup>44</sup> Korça, Hafiz Ali; “*Vdiq flamuri i Nacionalizmës –Ismail effendi Ndroqi*”; Revista Kultura Islame, Mars-Prill 1944, ENCIKLOPEDI – 100 Personalitete shqiptare të kulturës Islame gjatë shek. XIX – XX; KMSH, Tiranë 2012; f. 103-106

<sup>45</sup> Fjalë e imamit të xhamisë pararendëse e hytbes-ligjërates që mbahet ditën e premte pas së cilës falet edhe namazi, rit i njohur për muslimanët

<sup>46</sup> Ligjëratë e mbajtur nga imami I xhamisë çdo ditë të premte para besimtarëve, pas së cilës kryhet edhe falja e namazit



në mbarë botën në fjalimet e tyre hoxhallarët predikonin e thonin se: *Islami urdhëron për bashkëpunim në të mira dhe me idhujtarin* (atë që adhuron idhuj apo gjithçka tjetër) *që është armik i gjithë feve, dhe pa diskutim që është detyrë bashkëpunimi me besimtarët e feve të tjera, në veçanti me vllazërit Kristianë, aq më tepër me të krishterët shqiptar që i kemi dhe bashkëatdhetar.*<sup>47</sup>

Ishte pikerisht viti 1923, ku në fjalimin e tij para Kongresit Musliman, Haxhi Vehbi Dibra mbajti një referim ku ndër të tjera theksoi: *“Përveç vllazërisë fetare, kemi edhe një vllazëri kombëtare, që përmbledh të gjithë elementët që gjenden në atdheun tonë të dashur... të cilën duhet ta forcojmë e ta sigurojmë pasi në këtë mënyrë forcojmë e mbrojmë atdheun tonë të dashur.”*<sup>48</sup> Haxhi Vehbi Dibra mbështeti Qeverinë e Revolucionit të Nolit në 1924,<sup>49</sup> edhe pse Noli ishte Prift, edhe pse Vehbiu nuk kishte interesa personale, por ai e konsideroi të domosdoshme mbështetjen e Qeverisë së Nolit, pasi e gjykoi se ishte në interesin kombëtar. Si do te vente halli nëse Kryemyftiu do të jepte një tjetër urdhër për mbarë hoxhallarët e vendit, si do të shkonte gjendja e vendit!?

Hoxhë Kadri Prishtina, ish-ministër i Drejtësisë, si dhe drejtuesi i Revistës **Udha e s’Vërtetës**, në vitin 1923 në një nga shkrimet që ka bërë në numrin 2 të revistës që drejtonte vetë, me titullin *“Bisedime”*, bëri një replikë me revistën e jesuitëve *‘Lajmëtari i Jezu Krishtit’* në të cilën në një artikull flitej *“Për origjinën e Krishterë të Shqiptarëve dhe se shqiptarët nuk kishin rrugë tjetër të shpëtimit vetëm se nën besimin katolik”*. Hoxhë Kadriu, si fillim konstaton anomalinë vë në dukje se çfarë ka ndodhur, dhe se cila është arsyeja e këtyre ‘Bisedimeve’ të tij me vllazërit katolikë -si i quan vetë Hoxh Kadriu-, në një moment i kritikon ato për shkrimin, pasi sipas tij shkrimi prekte muslimanët dhe ortodoksët shqiptarë, ngaqë në revistën e tyre jezuitët kishin shkruajtur mbi *“..rrugën e vetme të shpëtimit që pretendojnë ata..., dhe për këtë ftojnë muslimanët në të kaluarën e tyre, në përkatësinë e besimit katolik, duke argumentuar se shqiptarët në të kaluarën kanë qenë katolikë...”*. Hoxhë Kadriu i kritikon për këtë pretendim madje shkon dhe më tej duke thënë që: *Ne jo vetëm duhet të jemi të bashkuar, por duhet të kemi parasysh dhe rreth*

---

<sup>47</sup> *‘Islami dhe paqi i përgjithshëm’*; Zani i Naltë, nr 10-11, viti XIII, Tetor-Nëntor 1938

<sup>48</sup> Dibra, Haxhi Vehbi; *‘Hytebeja e parë...’* Zani i Naltë, nr. 1, viti 1923, fq. 13

<sup>49</sup> Xhelili, Qazim; *Vehbi Dibra – personalitet dhe veprimtar i shquar i lëvizjes kombëtare*; Albin, Tiranë, 1998, fq. 186

*160.000 frymë të ortodoksë që jetojnë në Shqipëri dhe se nuk duhet të nxitemi me deklarata të parakohshme duke u bërë burim për përçarje.*<sup>50</sup> Hoxhë Kadri Prishtina paraqet një trajtesë që është disa faqëshe, dallohet aty për shumë elekuencë dhe kujdes më shumë se të matur në fjalët që zgjedh dhe formimin e fjalisë, në mënyrë që të replikojë por kurrësi të mos çënojnë të drejtën e tyre apo të tjerëve, për tu shprehur po pa emocione.

Duke analizuar gjendjen e muslimanëve Hoxhë Kadri Prishtina po edhe duke vënë në dukje dobësinë që ata po përjetonin, i bën thirrje që ti kthehen fesë së tyre si të vetmes rrugë që mund ti kthejë ata në krye të qytetërimeve, për këtë ai mer si shembull hebrenjtë dhe të krishterët duke i lavdëruar ata dhe duke iu treguar muslimanëve që të marin shembull se sa mirë arrijnë të fitojnë të mirat e kësaj bote duke aluduar se vetëm duke u kapur mbas parimeve fetare këta popuj kanë arritur të jenë shumë të suksesshëm (1923).<sup>51</sup>

Klerikët më të lartë edhe më me zë predikuan me zë të lartë se muslimanët jo vetëm ti respektojnë dhe të jetojnë mirë me bashkëatdhetarët e tyre të besimeve tjera, por gjithashtu, të kenë dashuri dhe të interesohen për zgjidhjen e halleve e problemeve tyre. Në Revistën Zani i Naltë (1923), në fjalimin e parë të botuar në të cilin Vehbi Dira e ka mbajtur në predikimin e ditës së xhuma (Vaze), Myftiu i Përgjithshëm trajton temën ‘Detyrimet e muslimanit’, të cilat i klasifikon si më poshtë;

1) Obligimet, detyrimet në këtë botë- në dunja; ku në vend të parë rëndit dashurinë ndaj atdheut, si urdhër që vjen nga feja, dhe ndër pikat e tjera rëndit dhe vllazërinë kombëtare.

2) Obligimet, detyrimet për botën tjetër, në të cilën përfshihen urdherat për praktikimin e fesë.<sup>52</sup> Haxhi Vehbi Dibrës, Myftiut i Përgjithshëm Shqipërisë, apo thënë ndryshe Kryetarit të Komunitetit Musliman Shqiptar të sapoformuar institucionalisht (1923).

*“O Shqiptar musliman, Mëmëdheu po të thërret”*, do të niste një nga predikimet e ditës së xhuma, qysh në gjenezë me të nisur referimin ai shpreh qartë detyrën që ka çdo musliman për të qenë i përgjegjshëm në krye të detyrave shtetërore nëse është ngarkuar me ndonjë përgjegjësi, apo nëse është i aftë të marrë përgjegjësi dhe të kontribojë për

<sup>50</sup> Për më shumë shih: “Bisedime” Revista “Udha e s’Vërtetës”, Totor 1923, viti parë, nr. 2, fq. 44-52

<sup>51</sup> Udha e s’Vërtetës, nr. 1, viti i parë, Tetor 1923, 17-18

<sup>52</sup> Revista Zani i Naltë, nr 1, Viti I, Tetor 1923

mëmëdheun qoftë kjo në pozita më të larta drejtuese për të cilat ka nevojë Shteti.<sup>53</sup> Hoxhë Vehbi Dibra ka lënë një shembull shumë sensibil edhe tepër të arsyetueshëm jo vetëm kaq ky rast është tashme i regjistruar ku ai si jo rrallë herë është një nga rastet prej të cilave këshillonte madje dhe urdhëronte muslimanët që mos jenë pasivë ndaj përgjegjësive që mund të lindin ndaj atdheut. Zani i Naltë në një tjetër predikim që është shënuar në revistën në dhjetor 1928, thuhet duke nisur me citimin e Kuranit Famëlartë: “Muhamed, a do ti detyrosh njerëzit që ata të besojnë në Një Zot!”<sup>54</sup> dhe “Ne të kemi dërguar ty (o Muhamed) vetëm përcjellës (lajmëtar) të përçosh mesazhin.”<sup>55</sup> *Vëllezër, në këtë mënyrë ka shumë ajete që na detyrojnë të sillemi mirë me njerëzit, me këdo, dhe të mos bëjmë ngatërresa dhe prapësira me asnjë. Prandaj nuk duhet të shohim as gjuhë, as ngjyrë, as ç’beson, por secilin ta shohim me syrin e vllazërimit.*<sup>56</sup>

Vëmë re se hoxhallarët e kohës (1938), shprehen: *Islami urdhëron për bashkëpunim në të mira dhe me idhujtarin që është armik i gjithë feve, dhe pa diskutim që është detyrë bashkëpunimi me besimtarët e feve të tjera, në veçanti me vllazërit Kristianë, aq më tepër me të krishterët shqiptar që i kemi dhe bashkëatdhetar.*<sup>57</sup>

Fragmente nga libri e predikimeve të hoxhë Vehbi Dibrës ndër të tjera shënohet se në një rast ai ka replikuar me një grup ateistësh të cilët shprehen shpesh herë se: “*Edukata fetare e kundërshton edukatën kombëtare, sepse feja e përçan kombin dhe nuk e lë të bashkohet*”. Duke i kthyer përgjigje atyre që kanë këta mendime i nderuari Haxhi Vehbiu shprehet se: *E kemi thënë shumë herë se ‘Feja është një institut që vllazërimin e ka parim themelor, dhe kur në ndonjë rast qoftë dhe në shkolla shfaqet diçka tjetër, në të cilën mund të bëhet shkaktar i përçarjes së një populli, atëherë kjo nuk është më fe, por është shoqni politike e fshehur nën maskën e fesë, është një fe e deformuar.*<sup>58</sup> Madje ai jep për shembull Amerikën, si proçedon në raste të tilla, ai thotë se: *Shembullin më të mirë e jep Amerika, ku ndër shkolla detyron që të respektohet dhe të nderohet liria, të drejtat dhe feja e tjetrit.*

---

<sup>53</sup> Dibra, Vehbi; ‘*O Shqiptar musliman, mëmëdheu po të thërret*’ Predikim i bërë në xhuma para besimtarëve muslimanë; Revista UDHA E S’VËRTETËS, nr. 3, viti i parë, Tiranë, Dhjetor 1923,

<sup>54</sup> Kur’an, Junus : 99;

<sup>55</sup> Kur’an,

<sup>56</sup> *Hytbe* (Predikim); ZANI I NALTË, nr 12, Viti V, Dhjetor 1928

<sup>57</sup> “*Islami dhe paqi i përgjithshëm*”; ZANI I NALTË, nr 10-11, viti XIII, Tetor-Nëntor 1938

<sup>58</sup> “*Ç’urdhëron Kurani*”, ZANI I NALTË, nr 3, Viti XI, Mars 1936

Ndërkohë në vendin tonë nuk bëhet e njëjta gjë, përkundrazi ndizet zjarri i përçarjes, dhe kjo për arsye se disa ateistë nëpër shkolla shprehin urrejtjen nëpër shkolla ndaj fesë dhe jo respektimin e fesë.<sup>59</sup> Vehbi Dibra me sarkasëm ia kthen një përgjigje mjaft diplomatike dhe me vend këtyre ‘intelektualëve ateistë’ që pretendojnë se: *tre fetë kanë futur në përçarje popullin, dhe se vetëm duke na u futur dhe ateizmi një ‘fe’ e katër ndër shqiptarë na u bënka bashkimi e kombit!?* Ai i sfidon ata duke iu drejtuar dhe duke i dhënë të drejtën ateistëve të konkurojë në lidhje me këtë çështje në masat e popullsisë, në ‘fushën e mejdanit’ si fetë e tjera, dhe jo të abuzojnë nën mburojën shtetërore, duke abuzuar me postet që kishin në administratën e shtetit, dhe në këtë mënyrë duke sjellë frymën e përçarjes në popull, me pushtetin që gëzojnë. Ai jep alarmin mbi këtë çështje duke thënë qartazi se: *Propaganda ateistë duhet të shporren një herë e mirë nga shkollat, pasi kjo po e edukon rininë me ndjenjën e nënçmimit dhe të përbuzjes së familjes, duke nënçmuar gjënë më të shenjtë të prindërve (trashëgiminë) që është besimi në Zot. Dhe llogjikshëm, nëse kemi një familje të përçarë, a mund të thotë kush që do të kemi një komb të bashkuar!?*<sup>60</sup>

Një tjetër intelektual, Hafiz Ali Kraja ishte hoxhë dhe personalitet i lartë që predikonte vllazërinë e shqiptarëve pavarësisht besimit që kanë. Hafiz Ali Kraja, në një nga predikimet e tij para besimtarëve në vitin 1934 ai thotë: *Islami nuk njeh për kundërshtarë ndjekësit e Krishtit, për më tepër, i konsideron ata si antarë të mëshirshëm. Kjo vërtetohet me thënin e Zotit në Kur’an ku i drejtohet Muhamedit: “O Muhamed! Në mes të kundështarëve, në mënyrë të dashurisë, më të afërm i gjen të krishterët.”*<sup>61</sup>, si dhe duke sjelle shembuj konkretë nga bota islame se si kanë bashkëjetuar muslimanët dhe të krishterët, shprehet: *Shembuj të shumtë në themelet e qytetërimit islam tregojnë se duke u bashkuar me të krishterët, janë në gjendje të ruajnë dashurinë kombëtare dhe ta gëzojnë jetesën e përbashkët. Kështu mund të ruhet edhe pavarësia e fituar së bashku me të gjitha sakrificat, duke kaluar mbi çdo pengesë që paraqitet ndër besimet e tyre.*<sup>62</sup>

<sup>59</sup> “Ç’urdhëron Kurani”, ZANI I NALTË, nr 3, Viti XI, Mars 1936

<sup>60</sup> “Ç’urdhëron Kurani”, ZANI I NALTË, nr 3, Viti XI, Mars 1936

<sup>61</sup> Kuran,

<sup>62</sup> KRAJA, Hafiz Ali; *A duhet feja, a e pengon bashkimin kombëtar?;* Botim i parë parë në vitin 1934; Komuniteti Musliman Shqiptar, Tiranë 2010, fq. 50-51

### 3.6. Jashtë objekteve të kultit edhe brezi i ri

Harmonia, sjelljet dhe marrdhëniet e bukura të ndërsjellta i shoqëruan klerikët jo vetëm në brendësi të objekteve të të njëjtit komunitet apo pati zhvillim në dimensione më të gjëra edhe jashtë objekteve të kultit. Asnjëherë nuk vërejmë kufizim apo mbyllje ndaj bashkëjetesës fetare të mbeten vetëm në kuadrin e këshillimit e predikimit të ditës së xhuma, por ata ishin shemuj konkretë në lidhje me këtë aspekt, gjë që trashëgohet deri më sot, prandaj duhen nxjerrë në dritë e duhen ruajtur që të shërbejnë si faner në aspiratat tona të përbashkëta si komb. Haxhi Vehbi Dira dhe prifti Visarion Xhuvani, si rasti më i veçantë për marrdhëniet tepër miqësore që dy klerikë të nderuar madje titullarë të padiskutueshëm të përkatësive të tyre fetare saqë shpesh herë dilnin në qytet duke shëtitur bashkarisht dhe duke biseduar për problemet e përbashkëta kombëtare. Shkodra megjithëse e ndjeshme po të tilla raste shënohen edhe atje pavarësisht se mbahej si qyteti i cili mbahet më fanatik në këtë drejtim, por gjithsesi kur ka qenë nevoja, kur gjendja është parë e tensionuar, klerikët kanë dhënë shembullin e tyre duke shëtitur bashkë në qytet, që të tregonin besimtarëve se: *Ndarja dogmatike që ne kemi në besim, nuk duhet të na pengojë që ne të bashkohemi në punë të ndryshme të dunjasë për të mirën e përbashkët siç është uniteti kombëtar apo ndihma reciproke që mund ti japim njëri-tjetrit në çështje të ndryshme të jetës së përditshme.*

Shumë domethenës fakti se drejtuesit fetarë dhe hoxhallarët, kishin marë nismën që këtë vlerë të kombit të tyre ata ta përçonin dhe në brezin e ri që edukoheshin dhe përgatiteshin për klerikë të ardhshëm në medresetë e vendit, duke qënë më vonë medreseja burimi më rëndësishëm i burimeve njerzore të klerit musliman po edhe i një brezi të rrallë intelektualësh e atdhetarësh. Kryemyftiu i Shqipërisë, në një vendim që mban datën 24 janar 1927, pas një diskutimi të thellë është në Këshillin e Bashkësisë Islame (Komunitetin Musliman Shqiptar), orjentohen dhe urdhërohen mësuesit dhe predikuesit e fesë që kur të kryejnë detyrat e tyre ta shikojnë mirë këtë program orientues e mos të devijojnë. Niset në të me një thënie të Profetit Muhamed (paqa qoftë mbi të) i cili porosiste duke thënë se: *Më i miri i njerëzve është ai prej të cilit kanë më shumë dobi njerëzit.* Dhe në vijim jepen

këshilla se ku duhet të mbështetet një vaiz-predikues për të ligjruar dhe cilat çështje nuk duhet t'i prekë. Nënvizohet më të madh ndër të tjera dhe shprehimisht : *Duhet ti predikohet popullit musliman që të bëjnë kujdes me bashkatadhetarët e tyre dhe të kenë dashuri për to, pasi për ndonjë pakujdesi mund të bëhet shkak për ndonjë grindje, dhe kjo është vetëm se e dëmshme, të mos akuzohet kush me 'iqfar' (tefir- si mohues i besimit në Zot- E.Sh.), gjithashtu, ska arsye që të predikohen rregullat e xhizjes etj. pasi këto i ngelen historisë.*<sup>63</sup>

Këto orjentime dhe udhëzime, shkojnë në vendin e duhur dhe përthithen nga nxënësit e medresesë. Kështu që në ceremoni të mbylljes së maturës në vitin 1935, maturanti i Medresesë së Përgjithshme në Tiranë, Adem Alikaj, trajton temën: *Vllazërimi dhe barazimi në Islam*, ai e nis me me ajetin e Kruanit, në të cilin Allahu thotë: “Vërtetë muslimanët janë vllazër...”<sup>64</sup> duke komentuar ajetin mbi detyrimet vllazërore fetare, ndër të tjera, pasi shkoqit se ç'kuptim kanë termat, pasi trajton hollësisht urdhërat fetarë në lidhje me detyrimet që kanë muslimanët ndaj njëri tjetrit apo familjarëve të tyre e më gjërë, ai vazhdon e thotë se: *Muslimani nuk e vështron me sy të keq atë që ndjek një fe tjetër, po përkundrazi edhe atë e konsideron vëlla, e sidomos në shqiptarët që përbëhemi nga dy tre fe të ndryshme, duhet të kemi një vllazërim dhe bashkim që ne të mund t'a për mirësojmë, ta zmadhojmë dhe ta zbukurojmë këtë copë Shqipëri.*<sup>65</sup> Kjo ishte një nga arritjet dhe rezultatet konkrete të punës së vazhdueshme të hoxhallarëve, dijetarëve, zyrtarëve dhe çdo punonjësi të Komunitetit Musliman Shqiptar duke arritur të përçonin tolerancën dhe bashkëjetesën shembullore mes besimtarëve muslimanë dhe besimtarëve të krishterë. Ndërsa në fjalën e tij Drejtori i Medresesë do të shprehej se: *“Kombi shqiptar është një provë e gjallë se fetë mund të bashkëpunojnë për të realizuar paqin e botës e të njerëzimit. Tre elementët e kombit shqiptar skanë asnjë dasi e përçarje mes tyre, gjithsecili ushtron fenë e vet lirisht, dhe respekton fenë e tjetrit”*<sup>66</sup>

Sa për të theksuar dua të them se e njëjta linjë bashkëjetese dhe tolerance është vërejtur gjatë gjithë kohës në institucionin e Komunitetit Musliman Shqiptar, qoftë kjo dhe

---

<sup>63</sup> “Program mbi detyrat e Myderiz-Vaizëve mbi predikimet që do të napin nëpër faltore”; ZANI I NALTË, Janar 1927, nr. 6 viti IV i botimit, ‘Ora e Shkodrës’, Shkodër 1927

<sup>64</sup> Kur’an, El-Huxhuratë : 10;

<sup>65</sup> “Vllazërimi dhe barazia në Islam”; ZANI I NALTË, nr. 12, viti X, Dhjetor 1935

<sup>66</sup> “Delegati i Lidhjes së Kishave, viziton Komunitetin Musliman Shqiptar...”; ZANI I NALTË, nr 7-8, Mars-Prill 1932

në gjendje lufte si ishte Lufta e Dytë Botërore. Qarkorja e nxjerrë në vitin 1942, Kryetari i Komunitetit Musliman Shqiptar i sapozgjedhur, Hafiz Sherif Lëngut, së pari jep një urdhër ndaj vartësve të tij, pra për predikuesit fetar, duke filluar që nga Kryemyftinjtë, Myftinjtë, Nënmyftitë, Imamet etj. Aty shprehimisht gjejmë ndër te tjera: *Pikë së pari i kërkoj funksionarëve fetarë që të predikojnë besimin popullit në mënyrën më të mirë duke mos lënë mënjëanë bashkimin e dashurinë fetare dhe kombëtare, në veçanti të kenë kujdes që të mos bëhen shkaktarë të ndonjë ndasie fetare mes vllazërve muslimanë e jomuslimanë.*<sup>67</sup> Padyshim që kjo linjë do të ruhej gjatë gjithë kohës, i vetmi problem që është shfaqur mes fetareve gjatë gjithë shekullit të parë të Pavarësisë, ka qenë ‘ateizmi’ i predikuar nga pushtetarët dhe më pas i detyruar nga Shteti që nga vitit 1945 e në vazhdim, aq sa ai nuk pranoi që të ‘konkuronte’ me besimet fetare ndershmërisht, ashtu si e pati ftuar i nderuari Vehbi Dira, por abuzivish dhe duke përfituar nga tolerance e klerikëve ateizmi arriti deri në eliminimin e praktikimit të besimit fetare (1967).

---

<sup>67</sup> “Qarkore”, Kultura Islame, Qershor-Korrik 1942 nr. 10 viti III I botimit; ribotim i shoqatës ALSAR, Tiranë 2012, fq.307

## KAPITULLI IV

### NDIKIMI I MEDIAS NË FORMIMIN E IDENTITETIT KOMBËTAR NË VITET 1925-1944

#### 4.1 *Zani i Naltë* dhe ndikimi në tolerancë dhe harmoni<sup>68</sup>

Revista “Zani i Naltë”, organ i Komunitetit Mysliman Shqiptar njihet për ndikimin e atyre që e ngritën dhe të shkruesve të saj sa i përket nxitjes së vetëdijes së kombit shqiptar për bashkim, zhvillim e prosperitet, harmoni mes feve e tolerancë ndaj njëri-tjetrit.

Kam shfrytëzuar të dhënat empirike nga leximi i kësaj reviste që nga numri i parë i saj, e deri në 1939, në shtrirje kohore prej 14 vitesh botimi. Vlen të përmendet fakti se përgjatë periudhës së botimit e deri në mbylljen përfundimtare, komunitetet fetare nëpërmjet botimeve të tyre ngritën në diskutim çështje shumë të rëndësishme e jetike të shoqërisë shqiptare, jo vetëm çështjet e besimit, por po ashtu edhe interpretime shkencore e filozofike, morale dhe etike. Në këtë revistë kanë qenë të pranishëm emrat më të shquar të elitës klerikale, njëkohësisht figura të rëndësishme të filozofisë, sociologjisë, letërsisë, gjuhës shqipe si : Hafiz Ali Korça, Nebil Çika, Haki Sharofi, Hasan Tahsini, Ferit Vokopola etj.

Drejtori i revistës “Zani i Naltë”, Ismail Maçi në parathënien dhe qëllimin e revistës thekson faktin se botimi i saj u pa si një nevojë e domosdoshme për të bashkuar elementin mysliman shqiptar “*i mbetun deri më sot i ndamun e i pa bashkumun në mes të tij*”<sup>69</sup>. Midis pikave kryesore të programit të kësaj reviste do të ishte bashkimi në një trup të fortë e të qëndrueshëm të popullit mysliman shqiptar; sipas statutit me “*plotsue vllazinn ndermietet të*

---

<sup>68</sup> Rreth revistës “Zani i Naltë”: Fillon botimin në muajin tetor 1923 me drejtor Ismail Maçin dhe vazhdoi deri në nr. 5, Maj 1939.Me një shkëputje prej 6 muajsh fillon ribotimin në mars të vitit 1925 në shtypshkronjën Mbrothësia të Kristo P. Luarasit në Tiranë, (v. II i botimit).Numrat 11 dhe 12 të vitit të dytë të botimit nuk janë botuar, rifillon botimin në muajin gusht 1926 në shtypshkronjën “Ora e Shkodrës” në Shkodër pas një ndërprerjeje prej 8 muajsh. Drejtor ishte sërish Ismail Maçi.Në vitin e tretë të botimit janë botuar 5 numra.Ndërpritet sërish në korrik-nëntor 1927.Nr. 4, Nëntor 1926 – drejtor Shyqyri Miftiu.Nr. 5, dhjetor 1926 – drejtor Hafiz Isa Domni.

<sup>69</sup> Revista “Zani i Naltë” – 1923-1939



*gjith elementeve në Shqipëri” si dhe “me forcuem edhe themelet e një politikës së shëndoshë e thjesht kombëtare në Shtetin t’onë”.*

Mund të themi se, që në fillim kjo revistë do të përcaktojë si një nga qëllimet e saj edhe bashkimin e shqiptarëve të çfarëdo feje qofshin për forcimin e identitetit kombëtar dhe shtetit shqiptar.

Në të njëjtin numër do të flitet për Hytbenë e parë<sup>70</sup> e cila pasi ka filluar në gjuhën arabe më pas *“gjuha amtare me gjith forcën e saj filloj të përndaj shpresë...”*. Më tej myftiu i përgjithshëm në këshillat e tij drejtuar besimtarëve (Këshilli i Naltë, Këshilli Ministrues, shumë deputetën dhe vllazën të Krishterë) do të veçojë *“kemi vllazën edhe një vllazni q’i gjinden në atdhenë tonë të dashtun t’onën qi këjo vllazni jo se asht vetëm me fjalë, po i madhi Zot në “Kur-ani Qerim” këtë vllazni e vërteton e thotë: jo se ishin në kombin e vet me një fe, po ishin vllazën atdheje. Këjo vllazni asht një vllazni atdhetare e lypet t’a forcojm e t’a sigurojm”*<sup>71</sup>. Pra Komuniteti Mysliman shqiptar e sheh si një detyrë themelore atdhetarinë, pasi besimtari mysliman nuk mund ta ndajë besimin shpirtëror me atë atdhetar. Gjithashtu, dashuria për atdheun shkon dhe me respektin e dashurinë për gjuhën amtare.

Pikat kyçe si: atdheu, gjuha dhe mirëkuptimi ndërfetar janë ceshtje mbi të cilat mbështetet veprimtaria e Komunitetit Mysliman. *“Feja myslimane të shtrëngon ma shumë/Për atdhen e dashur të derthsh gjak si lumë/Feja myslimane mos kurse të thotë/As shpirt as fëmijë fare gjë në botë./Po çkriji të gjitha veç shpëto atdhenë/Se n’atdhet të dashur mund t’a mbash fenë/Gjakun edhe nderin, rracën pasurinë/Mund t’i mprosh po mprojte atdhenë, lirinë... Shqipërija, kombi në lumtëri rroftë.”*<sup>72</sup>

Në numrin 9 të Qershorit 1924 Hafiz Ali Korça shkruan rreth ndryshimit të shpejtë kombëtar; i këndohet mëmës Shqipëri dhe bijve të saj që *“si kush le ta dijë s’ka shqipëtar sot/rënkimet e mëmës t’i durojë dot/mëmë po më duket se çunat e tu/pësimet e tua i shkruan ndër tru/bijtë për ty betohen për ty me u shkri/ndë kto ment ndodhet plak dhe i ri/të mos qe bashkimi a bahej kështu?/të mos qe Bashkimi a vinin këtu?...”*. Apo, *“Më fetar i saktë*

<sup>70</sup> Dela Roka, Roko Moroco, 1998. Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944. Elena Gjika: Tiranë

<sup>71</sup> Dela Roka, Roko Moroco. 1998. Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944. Elena Gjika: Tiranë.

<sup>72</sup> Zani i Nalte, nr 1

*shkrihet për atdhenë/Atdheu kuti është feja zhevahiri/Rron në kutit brenda e ruhet floriri/Mos ki turp ahere nga myslimanizma/Me atë ringjallet nacionalisma”<sup>73</sup>*

Revista “Zani i Naltë” i drejtohet më së shumti besimtarëve myslimanë, që përveç dashurisë për Zotin të ushqejnë në shpirtin e tyre edhe dashurinë për atdheun, sepse vetëm me një atdhe dhe të bashkuar shqiptarët do jetojnë në harmoni, e nuk do të jenë pjesë e ngatërresave të shumta të kohës.

Në mënyrë kronologjike konstatohet se përfaqësuesit më të lartë të Komunitetit Mysliman Shqiptar ngrenë probleme themelore patriotike edhe për trojet e ndara dhe të aneksuara nga fqinjët të Shqipërisë. Për këtë qëllim i kërkohet qarqeve të huaja evropiane, që të mbajnë qëndrim ndaj plagëve shqiptare. Kështu në lidhje me bombardimin e Serbisë në Drenicë ditën e Kurban Bajramit nëpërmjet poezisë “Vajtimet e atdheut”, Hafiz Ali Korça do të ngrejë pyetjen “*Qytetërimi ku është vallë?/përse Europa nuk iu sheh hallë?*” e mandej do të vazhdojë se Kosova “*M’i madhi krahu i Shqipërisë/M’e madhja çerdhe e trimërisë... vuan e të gjithë shqiptarët duhet të qajnë Kosovën e Çamërinë, “gjëmëzezët”, për të cilët duhet të zgjasin zinë!*”<sup>74</sup> Kështu revista përpiket të përcjellë mesazhe kuptimplota për etninë e trojet shqiptare anembanë. Jemi vetëm pak vite nga Konferenca e Londrës, por Komuniteti Mysliman Shqiptar i sheh Kosovën dhe Çamërinë pjesë të pandashme të Shqipërisë.

Ndërgjegjësimi kombëtar shqiptar do të shprehet fuqishëm sidomos në përkujtimet rreth ditës së pavarësisë. Muaji Nëntor mori vlerësimet më të mëdha si muaji më i lartë dhe më i madhërueshmi ndër muajt e tjerë, ai konsiderohet si muaji kur shqiptari nisi të marrë frymë lirisht e nisi “*me shiju amëlsinë e vllaznimit të rracës shqiptare*”. Komuniteti e kremton ditën e Pavarësisë si ditën më të lumturuar e të dëshiruar të kombit shqiptar dhe simbolin kombëtar, flamurin si “*shpresë e nderit, madhëri*”, si “*shenjë e bukur shumë e shtrenjtë*”, flamurit që nuk mund t’ia çmosh vlerën e që duhet t’i vijë “*rreth e rrotull kufisë/Në Kosovë e Çamëri*”.

Komuniteti Mysliman kërkon nga besimtarët përgjegjësi të madhe në përpjekjet dhe ndihmesën e madhe për zhvillimin e shtetit shqiptar nëpërmjet reformave të ndërmarra nga

---

<sup>73</sup> Zani i Naltë, nr 1

<sup>74</sup> Zani i Naltë, nr 9

Mbreti Zog. Ai i bën thirrje myslimanëve se është detyra e tyre të përmirësojnë ekonominë e vendit. Revista i mëshon me forcë në një shkrim të janarit 1927 *“shkundjes nga plogështia”* dhe kthimit të vëmendjes ndaj ekonomisë së vendit në mënyrë, që të sigurohen njëherë e mirë nevojat e vendit. Revista ve në vëmendjen e besimtarëve myslimanë shqiptarë se duhet të shohin se ç`po bëjnë popujt e përparuar dhe të qytetëruar e *“të ndjekim dhe na gjurmët e tyre në lamije të blerta të përparimit e në fushata të njoma të revolucionit.”*

Më vonë, Kjo do të përforcohet sërish, në fjalën e mbajtur nga Mehdi Frashëri në inaugurimin e Medresesë në Tiranë. Duke iu referuar reformave të Ataturkut, Mehdi Frashëri do të ngrejë zërin e tij se për Shqipërinë përparimi është shumë më tepër i nevojshëm e i domosdoshëm. Duke ndjerë ndjenjën atdhetare shqiptare Frashëri do të theksonte se shqiptarët janë të rrethuar nga vende që duan t`i zhdukin kështu që, *“prandaj përparimi me të shpejtë për ne shqiptarët asht një nevojë e jetesës; se në këtë botë për të mjeruemit s`ka mëshirë”* dhe do të nënvizojë më tej se *“Ay popull qi rrëzohet me këmbët e veta, s`ka të drejtë të ankohet”*. Me referimin e shifrave të popullsisë shqiptare, (1 milion brenda dhe 1 milion i roptuem jashtë vendit), Frashëri thekson se barrën më të madhe të përparimit të Shqipërisë e ka pikërisht elementi mysliman (1 milion e 700 mijë myslimanë, 200 mijë ortodoksë e 100 mijë katolikë), i cili sa *“më i shpejtë dhe i fortë të jetë aq më shumë ka shpresë qi të lirohet dhe ay 1 milion tjetër që lëngon n`robnit”*.

Për revistën *“Zani i Naltë”* përparimi i kombit nuk duhet të varet nga përngjasimi me *“të huajën”*, por shqiptarët duhet të mbështeten vetëm tek burimet dhe prodhimet e veta. *“Për ne (“Zani i Naltë”) çdo gja duhet të jetë shqiptare; pasqyrim i ekonomisë kombëtare, e cila është në krizë shkaku është se produktin kombëtar po e lufton produkti i huaj e jokombëtar.”*

Më tej revista vijon, se tregun shqiptar e ka mbërthyer produkti i huaj. Mania që shqiptarët t`u ngjajnë të huajve nuk bëri gjë tjetër veçse i varfëroi, por rrugën e shpëtimit revista e gjen në propagandën e *“Panshqiptarizms”*, dhe e përfundon me *“Çdo gja duhet të jetë vetëm shqiptare”*.

Duke analizuar problematikën shoqërore dhe ekonomike në vend theksohet se *“shqiptari përpara interesës së naltë t`Atdheut din me ba sakrifica dhe këto sakrifica i ban*

*me vullnet të patundun duke qenë gati me vuajte... Këjo sjellje dëshmon se morali i kombit shqiptar asht i naltë dhe nuk tronditet në dobi t'Atdheut"*

Revista “Zani i Naltë” mbajti qëndrim edhe për zhvillimin demografik të popullsisë shqiptare dhe këtë do ta lidhë sërish me nevojat dhe të ardhmen e atdheut. Duke u bazuar në Statistikën e 1927-1932 e Drejtorisë së Përgjithshme të Shëndetësisë revista e sheh të nevojshme patjetër organizimin e institucioneve të posaçme, si edhe rishikimin e zakonit të martesës si në Veri ashtu edhe në Jug të vendit, i cili sipas saj është shumë i kushtueshëm e për këtë arsye njerëzit druhën të martohen. Ky zakon për të është i vjetëruar e nuk e le shoqërinë të marrë frymë lirisht, apo të jetë më bashkëkohore. Kanë ardhur kohë të reja e zakonet e martesës i takojnë një të shkuare (nuk mundet që shqiptarët të vazhdojnë të “blejnë” nuset). Po ashtu revista kërkon nga mjekësia, si dhe organizatat intelektuale të propagandojnë në favor të shtimit të popullsisë pasi përndryshe kjo “është krim dhe tradhëti kundër Atdheut e shoqërisë” Me rastin e 25 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë

Revista do ia kushtojë gjithë hapësirën e saj historisë, traditës, kulturës dhe do nënvizojë faktin se Zoti e do Shqipërinë e s`mund ta lërë atë, si dhe të merret nëpër këmbë një popull, i cili zotëron gjuhë, tradita e zakone, një popull që dëshiron të jetojë me nder, një popull, lashtësinë e të cilit e dëshmon bota dhe historia. Shqiptaria i kanë dhënë të kuptojë Botës se *“në qoftë se ju preket liria kanë dhënë besën e deri sa të bëhen fli të gjithë ahëre mundet me ju prekë liria e tyre!”*

Përveç të tjerave revista do ketë në faqet e saj dhe një ekspozitë të martirëve myslimanë, të cilët ndër vite kanë luftuar e dhënë jetën për Shqipërinë dhe kombin shqiptar. Ajo iu drejtohet atyre duke theksuar, *“Mësoni o burra të pa vdekshëm se sot (martirët e lirisë kombëtare) se, gjith Shqipnia asht ba një trup i kondesuem dhe sot me një zemër feston një të katërtën e shekullit të mëvehtësisë së saj, at çast gëzimi që Juret e lajtit me gjakun dëshmor tuej; se Shqipnia u ba dhe vete drejt Qytetrimt... Krejt ambiciet e maparshme janë zhduk dhe janë zëvendësue me bashkim. Shqiptarët janë të bashkuar dhe dorë për dorë ndihmohen për të arrirë shokët e tyre”*. Më poshtë revista do të theksojë se këngët patriotike këndohen me forcë e se mbahen si të shenjta – *“Ti Shqipëri më ep nder, më ep emrin Shqiptar/Zemërën ti ma gatove plot me dëshirë dhe me zjarr...”* ka mbushur zemrën e çdo shqiptari. Kjo krenari e lartë kombëtare do të përçohet me nota të larta sidomos kur i

drejtohet Ditës së Pavarësisë, 28 nëntorit të cilës myslimanët i drejtohen *“Për ne nuk duhet të ketë çast ma të lumnueshëm se sot që arritëm këtë ditë, e cila dikur dukesh si në harresë!”*.

Në këtë numër “Zani i Naltë siç u përmend më lart” rendit një pjesë të emrave të hoxhallarëve më të njohur për kontributin e tyre për pavarësinë e Shqipërisë të renditur sipas prefekturave (43 emra).

Nga kjo, mund të thuhet se Komuniteti Mysliman ka luajtur një rol të rëndësishëm në ndergjegjësimin kombëtar shqiptar. Për të feja dhe kombi janë të pandashëm, një besimtar mysliman nuk mund të jetë i tillë nëse nuk është atdhetar i mirë.

Për intelektualët e shquar, penat e “Zanit të Naltë”, lumturia e vendit dhe kombit janë pavarësia dhe zhvillimi, qytetërimi, të cilat arrihen me dashurinë dhe përkushtimin ndaj atdheut, si dhe me dashurinë mes njëri tjetrit, qofshin myslimanë apo edhe të krishterë. “Zani i Naltë” i drejtohet besimtarëve myslimanë, por jo vetëm, i drejtohet gjithë shqiptarëve brenda dhe jashtë kufijve për të dhënë mesazhet e dashurisë dhe paqes, për të dhënë mesazhet e forcimit të dashurisë ndaj vendit dhe kombit shqiptar.

#### **4.2 Revista “Kultura Islame”<sup>75</sup>**

Revista fetare-kulturore “Kultura Islame” është organ i Komunitetit Musliman Shqiptar, e cila zëvendësoi revistën “Zani i Naltë”, numrin e saj të parë e pati në shtator 1939. Kjo revistë ishte mujore, me disa përjashtime dhe vazhdoi deri në muajin shkurt të vitit 1946.

Në rubrikën “Të ndryshme” revista citon si lajm festimin e pavarësisë. “Kjo ditë e pavdekshme e madhështore për Shqipërinë tonë të shenjtë, sivjet u kremtua me një madhështi shembullore. Në xhaminë e Vjetër u kënduan Himne fetare nga kori i medresesë dhe fjalën e rastit e mbajti myftiu i Tiranës Muharrem Mullahi. Shkrimet që kanë ardhur për rëndësinë e kësaj ditë janë të shumta, por revista ishte vënë në shtyp”.<sup>76</sup>

---

<sup>75</sup> Organ i Komunitetit Musliman Shqiptar, e cila zëvendësoi revistën “Zani i Naltë”, numrin e saj të parë e pati në shtator 1939. Kjo revistë ishte mujore, me disa përjashtime dhe vazhdoi deri në muajin shkurt të vitit 1946.

<sup>76</sup> *Kultura Islame*, Viti I. Nr.3 Nëntor 1939. Fq.124

Në poezinë “Dëshmorët e kombit” poeti u drejtohet dëshmorëve me disa pyetje retorike “A kujtoni se krejt jini harruar / A thoni se të zhdukur juve jini,/ a besoni vallë se s’ju kemi kujtuar / A thoni se emrin të humb’ e kini / Jo, jo, o burra, vëllazër të shtrenjtë / Kurr’ s’ju harrojmë, kurrë s’humbisni ...”<sup>77</sup>

Në një shkrim të karakterit historik për ngjarjen e pavarësisë, i bëhet jehonë festimit të kësaj feste “sot të bashkuar me Perandorinë Fashiste, më të fortë se çdo herë, jemi të sigurtë e të bindur se Shqipëria do të gëzojë liri dhe paqe, duke përmbledhur në gjirin e saj edhe tokat ku flitet shqipja e ku banojnë shqiptarë, për t’u bërë një Shqipëri e madhe, e fortë dhe ideale”.<sup>78</sup>

Sërish në rubrikën të “Ndryshme” jepet njoftimi për festimin e kësaj dite “në një mënyrë të thjeshtë prej popullit të kryeqytetit në xhaminë e vjetër ku merr pjesë dhe Mëkëmbësi i mbretit të Italisë Françesko Jakomoni bashkë me suitën e tij, i cili u prit nga zyrtarët më të lartë Komunitetit Musliman, dhe një shumicë njerëzish, intelektualë, klerikë etj.”<sup>79</sup>

Revista boton një poezi “28 Nëntori” në kujtimin e festës së pavarësisë ku i këndohet bashkimit të trojeve shqiptare “Flamuri Shqiptar kryelartë / Valon n’erë dhe nën ngjyrat e tij / Vllaznit e shpërndam bashkon ma s’fundi ...”<sup>80</sup>

Me një shkrim tjetër “Një përpjekje” ndaj atyre që e konsiderojnë revistën “Kultura Islame” me kuptimin pezhorativ “fetare”, lexojmë se “Përpjekja jonë është një përpjeke fetare, pse jo? Por është dhe një Përpjekje Shqiptare”. Në këtë shkrim theksohet kontributi i intelektualëve muslimanë në interes të pavarësisë kombëtare.<sup>81</sup>

Në kujtim të dashurisë për Atdheun në këtë numër botohet një shkrim me karakter historik ku tregohet momenti që Profeti Muhamed, pasi e detyruan të largohej nga vendlindja e tij, thotë “Ti je vendi më i dashur në sipërfaqen e tokës dhe më i zgjedhur për mua. Po të mos më kishin përzënë larg teje, unë kurrë nuk do të largohesha nga ti”<sup>82</sup>

<sup>77</sup> *Kultura Islame*, Viti I. Nr.4 Nëntor 1939, Refik H Bezhanit “Dëshmorët e kombit” Fq.153

<sup>78</sup> *Kultura Islame*, Viti II. Nr.15 Nëntor 1940, Refik H Bezhanit “Përvjetori i Njëzetetë i Pamvarsisë 28 Nëntor 1912” Fq.75

<sup>79</sup> *Kultura Islame*, Viti II. Nr.15 Nëntor 1940, “Të ndryshme” fq. 80

<sup>80</sup> *Kultura Islame*, Viti III. Nr.3-4 Nëntor-Dhjetor 1941, J. Kodra Guazzoni, “28 Nëntori” fq. 73

<sup>81</sup> *Kultura Islame*, Viti III. Nr.3-4 Nëntor-Dhjetor 1941, Pseudonimi A.S, “Një përpjekje” fq. 83

<sup>82</sup> *Kultura Islame*, Viti III. Nr.3-4 Nëntor-Dhjetor 1941, “Përhapja e Islamizms” fq. 85

Në këtë numër botohet poezia “Jeni të gabuar”, vazhdimi i replikës ndaj atyre, që mundohen të fusin përçarje mes muslimanëve dhe besimeve të tjera, duke na kujtuar se shqiptarët u bashkuan të gjithë kundër pushtuesit pa dallim feje, “ishin gjithë shqiptarë, nuk dallonin Fe / Feja për ta ishte Liri e Atdhe.”<sup>83</sup> Kjo ndjenjë urrejtjeje është e re për Shqiptarin “Çajupi nga Jugu, Fishta nga veriu / pse kjo farë e hidhur ndër Ta nuk mbiu? / Si këta dhe shumë, kemi dhe të tjerë / po të kësaj toke, të Shqipërisë së mjerë.”<sup>84</sup>

Në 1943, në rubrikën “Pjesa Letrare” botohet një prozë e shkurtër “Flamuri” ku tregohet rëndësia që ka ky simbol për shtetet e ndryshme. Gjithashtu sqarohet dhe domethënia e flamurit tonë kombëtar “Më mirë me vdek duke derdhur gjak se sa të jetosh me fytyrë të zezë”.<sup>85</sup>

#### 4.2.1 Pasqyrimi i përvjetorëve të pavarësisë në shtypin fetar 1913-1944

Historia e Shqipërisë për pavarësi ka njohur ngjarje, problematika dhe vështirësi të panumërta. Ajo që i ka shqetësuar “Rilindësit” tanë ka qenë pikërisht ngulitja në popull e ndjesisë kombëtare. Kjo nuk ishte e lehtë, duke pasur parasysh dhe të veçantën e popullit tonë, i cili është homogjen në etni (me përjashtim të disa pakicave të etnive të tjera) por është heterogjen në përbërjen fetare. Për këtë arsye identiteti kombëtar i shqiptarëve nuk mund të konsiderohej si një identitet i shkëputur nga pjesët e tjera përbërëse të atij që ne e quajmë “IDENTITET”. Ndaj dhe u desh një punë e madhe nga të gjithë patriotët për të nxjerrë në pah, në këto momente kyçe të ekzistencës sonë si popull, pikërisht identitetin kombëtar.

Njihen vargjet e Vaso Pashës se “Feja e shqiptarit është shqiptaria” që u bë motoja kryesore e atyre viteve të fillim-shekullit të kaluar. Duket sikur autori kërkon që t’ua zëvendësojë shqiptarëve fenë e tyre që ata e praktikojnë, aq sa e praktikojnë, me një “Fe” të re e kjo është “Shqiptaria”. Mund të duket e pranueshme për shqiptarin e thjeshtë (jo dhe aq fetar dhe aq më pak teolog) që siç e tregon dhe Edith Durham “Shqiptari mbetet gjithnjë

---

<sup>83</sup> *Kultura Islame*, Viti III. Nr.3-4 Nëntor-Dhjetor 1941, Pseudonimi Kom. “Jeni të gabuar!” fq. 86

<sup>84</sup> Po aty.

<sup>85</sup> *Kultura Islame*, viti V. Nr. 2-3 Tetor-Nëntor 1943, Veli Hafizi, “Flamuri” fq.50

shqiptar. Ai është në radhë të parë shqiptar. Feja vjen në radhë të dytë”<sup>86</sup>. Por kjo nuk është aspak në përputhje me parimet e të gjitha feve, ku teologët shqiptarë të këtyre besimeve, siç dhe do e shohim në këtë punim, kanë mbrojtur një ide tjetër, duke menduar se nuk ka mbivendosje identitetesh, por ka pjesë përbërëse të tij.

Këtë mendim e shohim dhe nga studimet e mëvonshme siç është rasti i Amin Maalouf-it ku thotë se: “Identiteti i dikujt përcaktohet dhe nga shumë elementë të tjerë si: kombësia, përkatësia fetare, një grup etnik a gjuhësor, profesioni, grupi social, bindjet politike, preferenca të ndryshme etj... Të gjitha përkatësitë kanë rëndësinë e tyre, por jo në të njëjtën kohë. Asnjëra në veçanti nuk e përmbush identitetin e dikujt.”<sup>87</sup>

Mid’hat Frashëri vjen me të njëjtën ide e hasim dhe tek “Feja mund t’i ngjitet mirë një kombësie, pa ia ndryshuar kësaj karakterin etnik. Grekët e konvertuar të Kretës na japin edhe një provë më shumë, megjithëse të myslimanizuar, askush nuk i quan turq”.<sup>88</sup>

Kjo më shtyn të mendoj se intelektualët teologë të të gjitha feve, pikërisht ata që mbajtën barrën kryesore në ngritjen në këmbë të popullit në luftë për pavarësi, menduan se feja nuk përbën pengesë për shkëputjen nga Turqia, edhe pse për shumicën e popullsisë muslimane, pushtuesi kishte të njëjtin besim me ta. Është me vend të përmendim figurën e myftiut, Haxhi Vehbi Dibrës, i cili dha “Fetvanë”, mendimin teologjik, “për shqiponjën dy krenare në mes fushës së kuqe” si dhe punoi për bindjen e popullit se “Pamëvarësia” është në të mirë të popullit tonë. Kjo personalitet do të ishte dhe kryetari i parë i Komunitetit Musliman Shqiptar që u formua në vitin 1923.<sup>89</sup>

Më pas vijnë figurat e Fishtës apo Nolit, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në arritjen e kësaj dite, por u ndala tek figura e Vehbi Dibrës, pasi bëhej fjalë për shkëputjen nga “vëllezërit e një besimi”, por me kombësi të ndryshme.

Këta teologë atdhetarë, me organet e shtypit të bashkësive fetare që ata drejtuan, brumosën tek shqiptarët ndjenjën e respektit dhe bindjes ndaj institucioneve shqiptare dhe

---

\* Doktorant në Shkencat e Komunikimit dhe Informimit në Universitetin e Tiranës.

<sup>86</sup> Edith Durham “*Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe Shqiptarët*”. Shtëpi Botuese “8 Nëntori” Tiranë 1991. fq.45

<sup>87</sup> Amin Maalouf “*Identitete Vrastare*” Botimet Onufri, Bot. i 2-të. Tiranë 2006. fq. 16

<sup>88</sup> Mid’hat Frashëri, *Shqiptarë dhe Sllavë*. Tiranë, Shkurt 1998. fq.52

<sup>89</sup> Enciklopedi “100 Personalitete Shqiptare të Kulturës Islame Shekulli XIX-XX”. Botues “Komuniteti Musliman i Shqipërisë” Fq.256-260



atdhedashurinë, e cila, në masën e saj të duhur, nuk bie aspak në kundërshtim më frymën e asnjë feje.

#### 4.2.2 Revista “HYLLI I DRITËS”

“Hylli i Dritës”, është organi zyrtar i Françeskanëve, i cili i ka kushtuar një vend të veçantë pasqyrimin të pavarësisë që në numrin e saj të dytë, i cili përkon pikërisht me përvjetorin e parë të ngritjes së flamurit. Ashtu siç e bën të ditur në akt-themelimin e kësaj të përkohshmeje: “se tuj dashtë qi edhe n’kohë t’liriës Fretnit e Sh’Franceskut t’u përkujdesshin për t’marë e t’mirë t’kombit shqyphtar si nder kohë t’kaluem: e tuj dijtë edhe sa randësi t’madhe kan n’gjetetnim t’nji komit Perkohshmjet, me letër çarkore t’15. t’Gushtit t’ktii vjetit (1913) tfaqi dishirin qi Provinca e Shqypniës t’a themelojte nji Perkohshme t’veten...”<sup>90</sup>

Drejtuesit e revistës në numrin e saj të tretë të dhjetorit të po atij viti, i rezervojnë një shkrim editorial me titull “KREMTIMI I KRYEVJETIT T’PARË T’INDEPENDENCJES S’SHQIPNIËS N’SHKODËR”. Në këtë shkrim tregohet gëzimi dhe hareja që ka përfshirë qytetin e Shkodrës në ditën e Flamurit, “si një provë e fortë kundër atyre që thonë se populli shqiptar nuk e do lirinë”<sup>91</sup> Përvjetori i parë i Flamurit është festuar gjatë gjithë ditës në Shkodër ku i madh e i vogël, mysliman e katolikë njëzëri brohorisnin “Rrnoftë Shqypnija! Rrnoftë flamuri i sajë!”<sup>92</sup>

Në këtë numër kjo revistë boton vjershën “E 28 E NANDORIT T’VJETIT 1913”, ku me një ndjenjë mërzie dhe keqardhjeje të thurur në vargje, pasqyrohet gjendja kaotike që mbizotëronte Shqipërinë e asaj kohe e cila “për një motmot te rriin aj n’anarkië / e t’bahet prralla e gazi i rruzullimit”<sup>93</sup>.

Kur hulumtojmë numrin e nëntorit të kësaj reviste shohim se festimin madhështor të përvjetorit të parë në Shkodër e hasim edhe në numrin e nëntorit të vitit 1937. Ja një detaj i kremtimit të asaj dite: “Kumbanarja e kishës së Gjuhadolit qe lidhur me minaren e xhamisë

<sup>90</sup> Revista “Hylli i Dritës” Nr. 1, 1 Tetor 1913. “Themelimi i Perkohshmjes”, Fq. 1

<sup>91</sup> *Hylli i Dritës*, Nr. i 3, 1 Dhjetor 1913, fq. 97

<sup>92</sup> Po aty.

<sup>93</sup> *Hylli i Dritës*, Nr. i 3, 1 Dhjetor 1913, fq. 98

së Fushës së Çelës me një tel mbi të cilin valvitej flamuri kombëtar ndërmjet rreshtit të gjatë të kandilave kuq e zi”.<sup>94</sup>

Pas një ndërprerjeje “Hylli i Dritës” i rikthehet botimit në vitin 1921. Në numrin e nëntorit të atij viti botohet një shkrim historik për Lidhjen e Prizrenit.<sup>95</sup> Revista ndërpret sërish botimin në vitin 1924, pasi është i njohur qëndrimi i saj antizogist, dhe rifillon botimin në vitin 1930.

Në një shkrim analitik “A jemi shqyptarë a por do të bahemi?”, diskutohen termat shtet, popull e komb ku mbrohet ideja se Shqipëria fare mirë mund të ekzistojë dhe duhet të ekzistojë si shtet i pavarur, edhe pse brenda saj mund të ketë pakica të kombeve të tjera, duke e argumentuar këtë ide dhe me rastin e Anglisë, Gjermanisë apo Spanjës ku në përbërje të tyre ka popuj të kombësive të ndryshme, duke e ndarë kështu nocionin shtet me atë komb.<sup>96</sup>

Vjersha ishte një nga format që kjo revistë përdor për të evokuar pavarësinë . Këtë e shohim në numrin e nëntorit të vitit 1933, ku botohet një vjershë nga P. Vinçenc Prenushi “NANA SHQYPTARE” ku pasqyrohet në vargje lufta e popullit shqiptar për liri.<sup>97</sup> Në të njëjtin numër kemi dhe dy shkrime të tjera historike njëri “Për historinë e Alfabetit shqip” dhe tjetri “Njëzet e pesë vjetori i Kongresit të Manastirit”.<sup>98</sup>

Njëzetepesë vjetori i pavarësisë si vit jubilar do të ketë një vend të veçantë në faqet e “Hylli-t të Dritës”. Redaksia duket se e parapërgatit lexuesin e saj që në numrin shtator-tetor të vitit 1937 me një studim me titull “Pse u ngrit Flamuri në Vlorë dhe jo në Durrës”. Aty i bëhet një përshkrim itinerarit të ndjekur nga Ismail Qemali deri në Vlorë. Autori tregon se çfarë u tha në një mbledhje të zhvilluar me parinë e qytetit ku “Ismail Qemali foli për situatën dhe rrezikun që i kanosej Shqipërisë. Pastaj zuri Myftiu të flasë gjësendi por nuk u foli dot, pastaj u ngrit Dhespoti i Durrësit Jakovi dhe tha me zë të fortë: Zotërinj. Unë që kur kam lindur, që kur kam ardhur ndër ment e gjer më sot, vetëm një flamur kam njohur, kam dashur dhe kam nderuar, dhe ky është flamuri i Osmanllisë! Nenë këtë flamur

---

<sup>94</sup> *Hylli i Dritës*, Nr.i 11, 1 Nëntor 1937, “Flamuri kombëtar në krahinë të Shkodrës”, fq. 535

<sup>95</sup> *Hylli i Dritës*, Nr.i 7, 1 Nëntor 1921, “Lidhja e Prizrenit”, fq. 307

<sup>96</sup> *Hylli i Dritës*, Nr.i 12, 1 Dhjetor 1930, fq. 650-656

<sup>97</sup> *Hylli i Dritës*, Nr.i 11, 1 Nëntor 1933, fq. 508

<sup>98</sup> *Hylli i Dritës*, Nr.i 11, 1 Nëntor 1933, fq. 514-524

dua të vdes. Mjerisht kjo fjalë e tërhoqi tërë mbledhjen për vete dhe filluan të propozonin që të njihnin vetëm flamurin e Osmanllisë. Atëherë Ismail Qemali e humbi pontin në Durrës por jo shpresën”.<sup>99</sup>

Në numrin e nëntorit janë një seri shkrimesh të karakterit historik, poetik dhe informativ. Revista hapet me një përkushtim: “Dëshmorëve, Veteranëve, Fatosave që me gjak, djersë e burrni, me pupël, besë e trimni, vllaznuen zemrat shqiptare kputën prangat e robnis qindravjeçare, tuj shpejtue agimin e Hyllit të liris”.<sup>100</sup>

Në një studim mbi historikun e flamurit kombëtar në qytetin e Shkodrës, njihemi me një sërë faktesh se si flamuri kuq e zi ishte tashmë i përhapur nëpër bajraqtet e veriut. Ja çfarë shkruhet në të: “Ka të gjitha gjasat që flamuri që u ngrit në Vlorë më 28 Nëntor 1912 të ketë qenë pikërisht ai që vetë Ismail Qemali mori nga Lec Shkjezi në Kotorr pak përpara. Nuk e dua - i pat thënë Plaku - as tepër të madh, as tepër të vogël. E Leci, që kishte flamuj me shumë përmasa, i dha një flamur të thjeshtë 2 m të gjatë”.<sup>101</sup>

Gëzimi që ka shqiptari për këtë ditë I shprehur në vargje, tingëllon shumë prekës dhe për ne pas kaq e kaq vitesh. “Ma e lumja ditë, shejmire e me oguër/ Për te me u gzue dhe gjarpni per nën guër / Paj edhe t’deknit n’vorre, / Se jo ma fmija, qi kcejnë n’per oborre.”<sup>102</sup>

Në numrin e dhjetorit kjo revistë pasqyron një festë madhështore që u organizua me rastin e 25-vjetorit të pavarësisë, në Komunën e Kastratit.<sup>103</sup>

Kur Shqipëria gjendej nën pushtimin e Italisë, në vitin 1939 në numrin e saj të prillit 1939 del qartë qëndrimi që kjo revistë do të mbajë ndaj pushtuesit fashist italian: “Dita 7 Prill shenjon fillësën e një epoke të re e fatbardhë për popullin shqypnar... Shqypnin e flamurit të Vlonës e mbyti një Esat Toptan; Shqypnin e Luigj Gurakuqit e Bajram Currit e mbyti Ahmet Zogu i Matës, por ksaj Shqypnije oksidentale, Shqypnis së gjith shqiptarëve

---

<sup>99</sup> *Hylli i Dritës*, Nr.i 9-10, Shtator-Tetor 1937, Dr. Nikolaq P. Zografi “Pse u ngrit Flamuri në Vlorë dhe jo në Durrës”, fq. 441-444

<sup>100</sup> *Hylli i Dritës*, Nr.i 11, 1 Nëntor 1937, “Kushtim”, fq. 501

<sup>101</sup> *Hylli i Dritës*, Nr.i 11, 1 Nëntor 1937, P. Donat Kurti. “Flamuri kombëtar në krahinë të Shkodrës”, fq. 515-537

<sup>102</sup> *Hylli i Dritës*, Nr.i 11, 1 Nëntor 1937, “Vorreve të Flamurit, 28 Nanduer 1912-1937”, fq. 537

<sup>103</sup> *Hylli i Dritës*, Nr.i 12, 1 Dhjetor 1937, “Myllja Sensacionale e 25 vjetorit në Komunën e Kastratit”, fq. 588

qi do të mkambet me pagjë, me drejtësi e me rregull të njëj Benito Mussolinit, s'ka me pas çka me i ba as një Esad e as një Ahmet i kësaj bote”.<sup>104</sup>

“Hylli i Dritës” i kushton një shkrim 28 nëntorit të vitit 1925, kur Ahmet Zogu e rimori dhe një herë pushtetin pas dështimit të “Revolucionit të Qershorit”. Në shkrimin “Një 28 Nanduer gjaku (1926) tregohet: “Ky (festim i përvitshëm i pavarësisë) nuk ndodhi në vitin 1925 kur qeverinë e vendit e kishte në dorë Ahmet Zogu i ardhur atëherë në fuqi me ndihmë e armë të huaja. Kjo nuk ndodhi as në nëndorin e vitin 1926 ...”<sup>105</sup> Ky shkrim tregon se edhe pas ribotimit të kësaj reviste nën regjimin e Zogut, 1930-1939, përsëri “urrejtja e vjetër” e drejtuesve të saj ndaj Zogut, akoma nuk ishte shuar.

Në këtë numër botohet shkrimi “Dita e Flamurit” ku tregohen disa veprime diplomatike të italianëve në raport me flamurin shqiptar. I tillë ishte rasti kur më 8 Prill Kolonel Scattini vendos në Shkodër krahas flamurit italian, edhe atë shqiptar, duke thënë: “...kemi ardhur tek ju jo si një popull i panjohur dhe armik. Ne ju konsiderojmë popull mik dhe vëlla... Këta dy flamuj do të valëviten për jetë së bashku në shenjë të kësaj lidhjeje vëllazërore...”<sup>106</sup>

Kështu pasqyrohet gjerësisht ceremonia e kremtimit të 28 nëntorit ku Françesko Jakomoni i dorëzon kryeministrit shqiptar, Shefqet Vërlacit, flamurin e ri kombëtar, e që nga ajo ditë, siç ishte dhe më parë, do të njëhej ditë feste më emrin ‘Dita e Flamurit’. Më pas, po në këtë shkrim përshkruhet e gjithë ceremonia e organizuar “nën kujdesin” e veçantë të Mëkëmbësit të Italisë. Në këtë shkrim të gjatë dhe analitik, përshkruhen dhe ndryshimet që ka pësuar ndër vite deri në kohën e Italisë ku “iu shtuen shenjat e Liktorit e sipër tij Kunora e Shtëpisë së Savoia”.<sup>107</sup>

Realiteti I festimit të përvjetorit të pavarësisë ndërkohë që ne kemi qenë të pushtuar nga Italia, përmes përgjigjes po në këtë shkrim Dom Lazër Shantoja. Ja një pjesë e fjalimit të tij (i cituar në normën e sotme letrare): “Ja vëllezër shqiptarë situata; kemi humbur për këtë punë pavarësinë tonë kombëtare? Manifestimi i sotëm do të konsiderohet

---

<sup>104</sup> *Hylli i Dritës*, Nr.i 3-7, Mars-Korrik 1939, “Lajme rrokull Shqypnis”, fq. 358

<sup>105</sup> *Hylli i Dritës*, Nr.i 11-12, Nëntor-Dhjetor 1939, Autori, Pseud. Gjigam “Një “28 Nanduer” gjaku (1926)”, fq. 539-542

<sup>106</sup> *Hylli i Dritës*, Nr.i 11-12, Nëntor-Dhjetor 1939, P. Marin Sirdani, “Dita e Flamurit”, fq. 611-620

<sup>107</sup> Po aty.

një anakronizëm grotesk si një farsë politike. Po flas më qartë e po ju pyes: thua populli shqiptar është mbledhur sot në sheshin e kryeqytetit e në sheshet e qyteteve e të katundeve të ndryshme të Shqipërisë për të dhënë shembullin më dallkav kolektiv e zyrtar që ka njohur historia e Shqipërisë? Ju përgjigjem: Jo! Unë do të turpërohesha sot para bashkatdhetarëve të mi, përpara vëllezërve të mi të Italisë, po të doja të luaja rolin e një xhongleri fjalësh. Unë ju them me bindjen më të plotë e më të sinqertë se sot më shumë se kurrë populli shqiptarë ka arsye dhe ka të drejtë ta kremtojë ditën e 28 Nëntorit.”<sup>108</sup>

Ne numrin e nëntorit 1941, *Hylli i Dritës*” e hap me një poezi të Fan Nolit “28 Nanduer”. Në artikullin “Kunora e Flamurit” bëhet një paralelizëm me 28 nëntorin e vitit 1443, kur Skënderbeu e ngriti flamurin në Krujë. Ndërsa duke folur për “Nëntorin e dytë” atë të vitit 1912, u bëhet jehonë, përveç figurës së Ismail Qemalit, edhe figurave të besimit katolik si Luigj Gurakuqit, Zef Harapit, Dedë Gjo’ Lulit, përmendet dhe kontributi i patriotëve Pandeli Sotiri dhe Themistokli Gërmenji.<sup>109</sup>

Me stil rrëfimitar, në një shkrim i ndërtuar në formën e një tregimi, si përgjigje për pyetjen e bërë nga bija, tregohet rëndësia që ka festa e pavarësisë për çdo popull. Artikulli është i mbushur plot me informacione dhe data historike si evokim i historisë së popullit tonë që nga koha e Skënderbeut.<sup>110</sup>

#### 4.2.3 “Zani i Naltë” për flamurin

Festa e flamurit zë vend të rëndësishëm në faqet e kësaj reviste. Flamuri konsiderohet simbol i bashkimit kombëtar “Përpara këtij bashkimi çduket çdo dasi krahinore e religjioze”.<sup>111</sup>

Në një poezi të drejtorit të përgjithshëm të kësaj reviste, Haki Sharofi, “Flamuri Kombëtar” ndër të tjera autori thur lavde dhe ndaj Mbretit Zogu i Parë: “Shqipëri ngreje

---

<sup>108</sup> Po aty.

<sup>109</sup> *Hylli i Dritës*, Nr.i 11-12, Nëntor-Dhjetor 1941, F.A “Kunora e Flamurit”, fq. 462-463

<sup>110</sup> *Hylli i Dritës*, Nr.i 11-12, Nëntor-Dhjetor 1939, Bardhyli, “Kujtime për Lirinë dhe Vetëqeverimin e Shqipërisë”, fq. 484-492

<sup>111</sup> *Zani i Naltë*, Nr. 3, Nëntor 1931, “Valo Flamur!”, fq. 76

ballin kryelartë / Mbretërinë ke kuror / Dhe mburojës, shtyllë hekuri dhe të zjarrtë / E ke Zogun Arbënor!...<sup>112</sup>

Vlerësohet kjo ditë feste dhe gëzimi për mbarë popullin edhe në editorialin “28 Nanduer 1932. Ç’kuptim ka festa e Flamurit?” Pyetjes së shtruar në titull, redaksia i përgjigjet: “Sot kësaj pyetjeje nuk mund t’i japim përgjigje, sepse fuqia mendore nuk punon, mirëpo shpirti, i cili vetë nuk shihet dhe që efektet nuk i fsheh, na e tregon përgjigjen. Ai nëpërmjet syrit derdh dy pika lot. Ky lot na tregon pse bëhet gjithë kjo festë kaq e madhe. Loti i parë tregon se sot u mbushën plot 20 vjet që Kombi Shqiptar fitoi Lirinë e vet. Ndërsa loti i dytë tregon se ideali i dëshmorëve të Atdheut, që dhanë jetën për liri, është nderuar...”<sup>113</sup>

Revista i kushton gati të gjithë hapësirën e saj përkujtimin të këtij përvjetori jubilar. me rastin e 25 vjetorit të pavarësisë, në numrin e saj të nëntorit, Në editorial “Dy fjalë mbi 25 vjetorin”, i bëhet një panoramë historisë sonë, duke u ndalur pastaj në ngjarjet e vrullshme të fillim-shekullit të shkuar. Herë me nota poetike e herë historike, shkrimi i përcjell lexuesit një panoramë të gjallë të asaj dite gëzimi mbarëkombëtare. Shkrimi i kujton lexuesit vargjet e njohura nga poema “Bagëti e Bujqësi”: “Ti Shqipëri me jep nder / më jep emrin shqipëtar / zemrën ti ma gatove / plot më dëshirë e me zjarr.” Në shkrim nuk mungojnë dhe nderimet për Mbretin Zog. Autori u drejtohet dëshmorëve të kombit duke u thënë: “Prehuni të qetësuar dhe kaloni çaste gëzimi se Shqipëria u bë dhe shkon drejt Qytetërimit nën drejtimin e Prijësit Gjeneral të Saj, Nalt Madhërisë Tij Zogut I-rë, Mbret i Shqiptarëve.”<sup>114</sup>

Tek ky numër, revista ka një rubrikë të sajën me titull “Veteranët e Klerit Musliman”. Shkrimi ka një qasje unike në trajtimin e problematikës së prezencës së fesë islame edhe para ardhjes së osmanëve si dhe të pranimit të fesë nga pushtuesi, duke e konsideruar fenë si “një çështje individuale, që çdo person duhet ta zgjedhë sipas dëshirës dhe ndërgjegjes së tij. Feja është një institut, që ka për qëllim me ia përgatitë njeriut jetën pas vdekjes në një mënyrë të lumtur. Për këtë feja nuk ka lidhje me kombësinë. Kjo është arsyeja që shumica e pranoi Fenë Islame, megjithëse iu komunikua nëpërmjet armikut

<sup>112</sup> *Zani i Naltë*, Nr. 3, Nëntor 1931, Haki Sharofi “Flamuri Kombëtar!”, fq. 77

<sup>113</sup> *Zani i Naltë*, Nr. 3-4, Nëntor-Dhjetor 1932, “28 Nanduer 1932. Ç’kuptim ka festa e Flamurit?”, fq. 452

<sup>114</sup> *Zani i Naltë*, Nr. 11, Nëntor 1937, Neshet Çami “Dy fjalë mbi 25 vjetorin”, fq 321-328,

kombëtar... Kjo fe e naltë s'mundi me e afri shqiptarin me turkun, sepse turku nuk ndoqi një politikë fetare Islame, por një politikë kombëtare turke. Prandaj shqiptarët pranuan Fenë Islame por qëndruan larg nga influenca kombëtare e turqve”.<sup>115</sup>

Me sa hulumtojmë tek ky shkrim i redaksisë na tregon se klerikët muslimanë shqiptarë nuk gjenin pengesë nga parimet e fesë islame për t'iu kundërvënë atij që nuk respekton të drejtat dhe liritë që Zoti ia ka falur, siç është ndër të tjera dhe mësimi i gjuhës amtare.

Në shkrim lexojmë disa prej emrave (43 emra) të këtij kleri, që kontriboi për çështjen kombëtare. Ndër ta lexojmë: Hafiz Vehbi Dibra, firmosësi i aktit të pavarësisë dhe kryetari i parë i Pleqësisë, Hafiz Ali Korça, anëtar i Kongresit të Manastirit, Hafiz Ibrahim Dalliu, mësues i Normales së Elbasanit.<sup>116</sup>

Në shkrimin “28 Nandori Fatbardhsija e Shqipërisë” përmendet sërish akti i pavarësisë: “...del në Vlorë një Plak mjekër-bardhë, Ismail Qemali dhe me 28 Nëntor 1912, bashkë me një grup shqiponjash, ngre Flamurin Kuq e Zi, atë që sot na valon mbi krye”, ku nuk mungojnë dhe lavdet për Mbretin Zog që konsiderohet nga autori mbrojtës i sovranitetit të Shqipërisë.<sup>117</sup>

#### 4.2.4 Shtypi ortodoks

Shtypi ortodoks në këtë periudhë prezantohet me organin e saj të shtypit, Fletore “Gjergj Kastrioti, Skënderbeu, Organ Shpirtnuer për Orthodoxët e Shqipnisë”. Themelues, pronar, drejtues dhe artikull-shkrues Vissar Xhuvani, teolog. Kjo “Fletore” u shtyp në shtypshkronjën “Gjirokastra” në maj të vitit 1924 me 4 faqe. Emri i saj, siç e sqaron dhe botuesi i saj, është vendosur në nder të heroit tonë kombëtar. Fillimisht u botua një herë në javë, më 7 korrik po të atij viti del 3 herë në muaj. Më 19 tetor 1924 fillon të dalë sërish një herë në javë çdo të diel. Ka një ndërprerje deri më 11 janar 1925 ku ndryshon dhe emrin në “Skënderbeu” nga “Gjergj Kastrioti” që ishte, dhe më 18 janar 1925 drejtohet nga një

<sup>115</sup> *Zani i Naltë*, Nr. 11, Nëntor 1937, “Veteranët e Klerit Musliman”, fq 329-331,

<sup>116</sup> Për më tepër lexo “100 Personalitete Shqiptare të Kulturës Islame Shekulli XIX-XX.” Komunitet Musliman i Shqipërisë Shtator 2012.

<sup>117</sup> *Zani i Naltë*, Nr. 12, Dhjetor 1938, Hysni Hoxha, “28 Nandori Fatbardhsija e Shqipërisë”, fq 163-165,

komision i posaçëm. Më 2 mars 1925 ditën e hënë del dhe numri i saj i fundit (me numër 23) ku lajmërohet se “Për shkaqe teknike, nuk ka për t’u botuar më Fletore “Skënderbeu”.<sup>118</sup>

Nga ky historik i kësaj Fletoreje, i marrë nga leximi i të gjithë numrave të saj që gjenden në arkivin e Bibliotekës Kombëtare, periudha e nëntorit ka pasur ndërprerje dhe nuk kam arritur të shoh ndonjë pasqyrim të pavarësisë në këtë Fletore.

Organ tjetër i shtypit Orthodhoks ka qenë dhe “ZËRI I ORTHODHOKSISË” revistë fetare, botohet me përkujdesjen e Metropolitit të Korçës z. Jerotheut. Në arkivin e “Bibliotekës Kombëtare” gjendet vetëm numri 3 i saj e botuar më 1 Janar 1925 në Korçë me Drejtor dhe Kryeredaktor Pandeli Kotoku. Në të lajmërohet se “Botohet përkohësisht dy herë në muaj”. Edhe nga kjo revistë nuk ekziston në Bibliotekën Kombëtare asnjë numër i muajit nëntor, për të parë si pasqyrohet përvjetori i pavarësisë.<sup>119</sup>

Kuptohet se edhe Kleri Orthodoks Shqiptar nuk ngelet pas nga ndjenja e tij kombëtare. Këtë e tregon më së miri zgjedhja e ditës dhe e datës së organizimit të ceremonisë për ta shpallur Kishën Orthodokse Autoqefale Shqiptare, “KOASH”. Kjo ndodhi pikërisht “ditën e ngritjes së flamurit kombëtar më 28 Nëntor 1921 në Kishën e Evangjelizmos në Tiranë ku morën vendimin për shpalljen e KOASH”.<sup>120</sup>

#### 4.2.5 Revista “L.E.K.A.”

Revista “Leka”, organi zyrtar i “Urdhrit Jezuit”, njoftoi botimin e saj në vitin 1929 me 32 faqe, por numrin e saj të parë e pati në Janar të vitit 1930. Vitin e parë u botua çdo dy muaj, ndërsa nga viti i dytë i botimit (1931) doli çdo muaj. U botua në Shkodër në shtypshkronjën “Zoja e Papërlyme”. Kjo revistë ka dhënë nje ndihmesë të vyer në ngulitjen e ndërgjegjes kombëtare. Që në numrin e saj të parë, Janar 1930, boton një artikull me titull

---

<sup>118</sup> Fletore “Gjergj Kastrioti” më pas, Skënderbeu, Organ Shpirtnuer për Orthodoksët e Shqipnisë. 19 Tetor 1924-2 Mars 1925

<sup>119</sup> Revista Fetare “ZËRI I ORTHODHOKSISË” Nr. 3. 1 Janar 1925 Botuar në Korçë.

<sup>120</sup> Shyqyri Hysi, Histori e Komuniteteve Fetare shqiptare, Tiranë, 2006, fq.174.



“Ndjesia instiktive e atdheut” ku tregon se malli për atdheun e djek shpirtin e mërgimtarit.<sup>121</sup>

Në rubrikën ‘kulturë’ në numrin e nëntorit të vitit 1930, botohet një studim për problemet e gjuhës shqipe, e cila, siç dhe shkruhet, “Gjuha po na bastardohet”. Këtu u bëhet thirrje intelektualëve të japin kontributin e tyre në mbrojtjen e kësaj pasurie kombëtare.<sup>122</sup> Revista në rubrikën EDUKATË në nëntor të vitit 1931 boton shkrimin “Dita 28 Nanduer” duke shkruar se “Kjo ditë është një fotografi e këndshme, një kujtim i pashlyer i ditës 28 Nëntor 1912 në të cilën ai plak i ndershëm, Ismail Qemali bashkë me atdhetarë të tjerë të njohur nga populli, të besimeve të ndryshme, shpallën pavarësinë...”<sup>123</sup>

Po atë vit në numrin e dhjetorit në rubrikën EDUKATË botohet një shkrim sa edukativ aq dhe historik, duke u përpjekur që me anë të historisë, të zgjojë ndërgjegjen kombëtare tek brezi i ri. Ky shkrim “Shka pret prej nesh Atdheu i lir” na bën një paralelizëm se si ishte Shqipëria gjatë 500 viteve, si është sot dhe si duhet përdorur liria e fituar. Në të lexojmë: “Për ta rigjallëruar e përparuar Kombin nuk mjafton vetëm liria, por duhet vepruar”.<sup>124</sup> Në vitin 1942 revista “Leka” del me një “NUMËR TË VEÇANTË në vazhdim të numrave kujtimorë të 25-vjetorit të pavarësisë kombëtare” siç dhe e titullon redaksia. Është një numër me shumë materiale me vlera historike, të cilat redaksia i ka mbledhur për vite të tëra nga arkivat personale të protagonistëve të atyre ngjarjeve. Një pjesë e mirë e këtyre dokumenteve botohen për herë të parë pasi, siç njofton redaksia, tashmë jemi në vitin 1942 ku regjimi i Zogut nuk ekzistonte dhe kishte një farë lirie shtypi më të madhe për sa u përket atyre materialeve, që preknin drejtpërdrejt atë figurë. Redaksia njofton se ky është numri i dytë i veçantë me dokumente historike. Numri i parë është botuar me rastin e 25 vjetorit, në vitin 1937, ku janë botuar shkrime që nga Lidhja e Prizrenit, si dhe shkrime të tjera të cilat nuk preknin regjimin në fuqi, e në disa raste janë përdorur dhe pseudonime për autorët.<sup>125</sup>

---

<sup>121</sup> Leka, Nr. 1, Janar 1930, Z.Mark. Harapi, “Ndjesia instiktive e atdheut”, fq. 3

<sup>122</sup> Leka, Nr. 6, Nëntor 1930, “Gjuha po na bastardohet”, fq. 161-168

<sup>123</sup> Leka, Nr. 11, Nëntor 1931, “Dita 28 Nanduer”, fq. 323-329

<sup>124</sup> Leka, Nr. 12, Dhjetor 1931, “Shka pret prej nesh Atdheu i lir”, fq. 359

<sup>125</sup> Leka, numër i vetëm 1942 Mbas pesë Vjetësh, “NUMËR TË VEÇANTË në vazhdim të numrave kujtimorë të 25-vjetorit të pavarësisë kombëtare” fq. 3

#### 4.2.6 Revista “Kultura Islame”

Revista fetare-kulturore “*Kultura Islame*” organ i Komunitetit Musliman Shqiptar, e cila zëvendësoi revistën “Zani i Naltë”, numrin e saj të parë e pati në shtator 1939. Kjo revistë ishte mujore, me disa përjashtime dhe vazhdoi deri në muajin shkurt të vitit 1946.

Në rubrikën e saj “Të ndryshme” revista citon si lajm festimin e pavarësisë. “Kjo ditë e pavdekshme e madhështore për Shqipërinë tonë të shenjtë, sivjet u kremtua me një madhështi shembullore. Në xhaminë e Vjetër u kënduan Himne fetare nga kori i medresesë dhe fjalën e rastit e mbajti myftiu i Tiranës Muharrem Mullahi. Shkrimet që kanë ardhur për rëndësinë e kësaj ditë janë të shumta, por revista ishte vënë në shtyp”.<sup>126</sup>

Në poezinë “Dëshmorët e kombit” poeti u drejtohet dëshmorëve me disa pyetje retorike “A kujtoni se krejt jini harruar / A thoni se të zhdukur juve jini,/ a besoni vallë se s’ju kemi kujtuar / A thoni se emrin të humb’ e kini / Jo, jo, o burra, vëllazër të shtrenjtë / Kurr’ s’ju harrojmë, kurrë s’humbisni ...”<sup>127</sup>

Në një shkrim të karakterit historik për ngjarjen e pavarësisë, i bëhet jehonë festimit të kësaj feste “sot të bashkuar me Perandorinë Fashiste, më të fortë se çdo herë, jemi të sigurtë e të bindur se Shqipëria do të gëzojë liri dhe paqe, duke përmbledhur në gjirin e saj edhe tokat ku flitet shqipja e ku banojnë shqiptarë, për t’u bërë një Shqipëri e madhe, e fortë dhe ideale”.<sup>128</sup>

Në rubrikën të “Ndryshme” jepet njoftimi për festimin e kësaj dite “në një mënyrë të thjeshtë prej popullit të kryeqytetit në xhaminë e vjetër ku merr pjesë dhe Mëkëmbësi i mbretit të Italisë Françesko Jakomoni bashkë me suitën e tij, i cili u prit nga zyrtarët më të lartë Komunitetit Musliman, dhe një shumicë njerëzish, intelektualë, klerikë etj.”<sup>129</sup>

Në kujtimin e festës së pavarësisë revista boton një poezi “28 Nëntori” ku i këndohet bashkimit të trojeve shqiptare “Flamuri Shqiptar kryelartë / Valon n’erë dhe nën ngjyrat e tij / Vllaznit e shpërndam bashkon ma s’fundi ...”<sup>130</sup>

<sup>126</sup> *Kultura Islame*, Viti I. Nr.3 Nëntor 1939. Fq.124

<sup>127</sup> *Kultura Islame*, Viti I. Nr.4 Nëntor 1939, Refik H Bezhanit “Dëshmorët e kombit” Fq.153

<sup>128</sup> *Kultura Islame*, Viti II. Nr.15 Nëntor 1940, Refik H Bezhanit “Përvjetori i Njëzetetë i Pamvararis 28 Nëntor 1912” Fq.75

<sup>129</sup> *Kultura Islame*, Viti II. Nr.15 Nëntor 1940, “Të ndryshme” fq. 80

<sup>130</sup> *Kultura Islame*, Viti III. Nr.3-4 Nëntor-Dhjetor 1941, J. Kodra Guazzoni, “28 Nëntori” fq. 73

Me një shkrim replikues “Një përpjekje” ndaj atyre që e konsiderojnë revistën “Kultura Islame” me kuptimin pezhorativ “fetare”, lexojmë se “Përpjekja jonë është një përpjeke fetare, pse jo? Por është dhe një Përpjekje Shqiptare”. Në këtë shkrim theksohet kontributi i intelektualëve muslimanë në interes të pavarësisë kombëtare.<sup>131</sup> Në kujtim të dashurisë për Atdheun në këtë numër botohet një shkrim me karakter historik ku tregohet momenti që Profeti Muhamed, pasi e detyruan të largohet nga vendlindja e tij, thotë “Ti je vendi më i dashur në sipërfaqen e tokës dhe më i zgjedhur për mua. Po të mos më kishin përzënë larg teje, unë kurrë nuk do të largohesha nga ti”<sup>132</sup>

Në këtë numër botohet poezia “Jeni të gabuar”, vazhdimi i replikës ndaj atyre, që mundohen të fusin përçarje mes muslimanëve dhe besimeve të tjera, duke na kujtuar se shqiptarët u bashkuan të gjithë kundër pushtuesit pa dallim feje, “ishin gjithë shqiptarë, nuk dallonin Fe / Feja për ta ishte Liri e Atdhe.”<sup>133</sup> Kjo ndjenjë urrejtjeje është e re për Shqiptarin “Çajupi nga Jugu, Fishta nga veriu / pse kjo farë e hidhur ndër Ta nuk mbiu? / Si këta dhe shumë, kemi dhe të tjerë / po të kësaj toke, të Shqipërisë së mjerë.”<sup>134</sup>

Në 1943 në rubrikën “Pjesa Letrare” botohet një prozë e shkurtër “Flamuri” ku tregohet rëndësia që ka ky simbol për shtetet e ndryshme. Gjithashtu sqarohet dhe domethënia e flamurit tonë kombëtar “Më mirë me vdek duke derdhur gjak se sa të jetosh me fytyrë të zezë”.<sup>135</sup>

#### **4.3 Roli i komunikimit përmes objekteve të kultit Islam në Shqipëri**

Në vitet 1912-1939, vite të mungesës së shtetit shqiptar apo të ekzistencës së tij të dobët, institucionet fetare kryenin funksionet e administrimit të jetës shoqërore të besimtarëve.<sup>136</sup> Feja Islame dallonte nga fetë e tjera për nga brendia dhe funksionet shoqërore të saj. “Ajo bashkonte në vetvete parimet shpirtërore dhe shekullore, synonte të depërtonte në të gjithë sferat e jetës e të veprimtarisë së besimtarit. Dispozitat e saj

<sup>131</sup> *Kultura Islame*, Viti III. Nr.3-4 Nëntor-Dhjetor 1941, Pseudonimi A.S, “Një përpjekje” fq. 83

<sup>132</sup> *Kultura Islame*, Viti III. Nr.3-4 Nëntor-Dhjetor 1941, “Përhapja e Islamizmit” fq. 85

<sup>133</sup> *Kultura Islame*, Viti III. Nr.3-4 Nëntor-Dhjetor 1941, Pseudonimi Kom. “Jeni të gabuar!” fq. 86

<sup>134</sup> Po aty.

<sup>135</sup> *Kultura Islame*, viti V. Nr. 2-3 Tetor-Nëntor 1943, Veli Hafizi, “Flamuri” fq.50

<sup>136</sup> Shih Basha Ali f. 47.

përfshinin veprimtarinë ideologjike, shtetërore, politike, administrative, fiskale, ushtarake, juridike e familjare. Ky karakter shumëdimensional i fesë islame synonte të krijonte te besimtarët shprehitë për t'i vlerësuar të gjitha ngjarjet dhe dukuritë e jetës nëpërmjet prizmit të kanuneve fetare: Kur'anit, synefit si dhe të drejtës tradicionale myslimane – ligji i Sheriatit”.<sup>137</sup> Pra, në objektet e kultit Islam, përkatësisht xhamitë por jo vetëm, komunikohet ajo se si një person besimtar duhet të ishte i dobishëm për veten, shoqërinë, vendin dhe kombin e tij.

Në objektet e kultit komunikohet dhe vazhdon të komunikohet nevoja e njeriut për të studiuar, për tu shkolluar për të qene i ditur, pasi fitimi i dijeve është detyrë parësore e çdo myslimani sepse në vetvete thelbi i islamit është të mësohet dhe të përcjellësh dijen. Në librin “Rrugëtimi i islamit në Shqipëri”, studiuesi Ali M. Basha, shkruan: “... Myslimanët ndërton xhami dhe medrese, në të cilat lulëzoi dija për natyrën dhe shoqërinë, nëpërmjet një sistemi të qartë dhe të saktë arsimor”.<sup>138</sup>

Këshilli i Naltë i Sheriatit, me 14 dhjetor 1920, nxori urdhrin ku insistonte që të gjithë nëpunësit dhe kleri mysliman që ishin në shërbim të popullit ta mësonin gjuhën shqipe me shkrim dhe lexim dhe ta përdorin atë në kontaktet, predikimet dhe korrespondencën që mund të kishin në çështjet e përditshme.<sup>139</sup>

Njeriu është në kërkim të lumturisë së tij të brendshme dhe vendi i parë ku ai gjen lumturinë dhe prehjen është feja/besimi. Eliade,<sup>140</sup> filozof rumun, thotë se të jetuarit si njeri është një veprimtari fetare në vetvete. Ndërsa Schopenhauer thotë se njeriu është një krijesë metafizike. Sipas tij tempujt, kishat, pagodat, lutjet dhe përgjimet të cilat i hasim në çdo kohë dhe çdo vend me tërë ndriçimin dhe madhështinë e vet paraqesin prova të nevojës për elementin metafizik që e ruan ekzistencën e vet, që është ndikues dhe që s'humbet dot.<sup>141</sup> Pra njeriu asnjëherë nuk ka mundur të jetojë pa Zotin. E shenjta është pjesë e pandashme e jetës së tij. Modernizmi s'ka arritur ta kënaqë njeriun. Për këtë arsye njeriu i kohës sonë

---

<sup>137</sup> Stafanaq Pollo, fq. 22, Ali Basha, f. 50.

<sup>138</sup> Basha, A., f. 116.

<sup>139</sup> Po aty, f. 25.

<sup>140</sup> Eliade M., Dinin Anlam ve sosyal fanksiyonu.

<sup>141</sup> Bahtijarevic B., Socijolištiko društvo, crkra I religija (f. 9).

kërkon rrugë mënyra dhe alternativa të reja për të arritur lumturinë e humbur. Në mesin e këtyre metodave të kërkimit të lumturisë, vend të posaçëm zë religjioni.

Ashtu si shoqëritë e tjera post komuniste, vendi ynë kaloi një periudhe të ndryshimeve rrënjësore shoqërore, ekonomike dhe politike. Me këto ndryshime, njeriu i këtij nënqielli me një entuziazëm të flaktë iu kthye shpirtërores dhe fesë. Për shkak të ndryshimeve të dukshme fetare kjo periudhë mund të quhet edhe “periudha e kthimit në skenë e së shenjtës dhe hyjnore”<sup>142</sup>

Hulumtimin rreth komunikimit përmes objekteve të kultit të fesë islame në Shqipëri do ta grupoja në tre periudha edhe pse përfshin një kohë të gjatë me ndryshime të mëdha historike për pasojë me ndryshime edhe në metodikën e komunikimit verbal nëpër xhami. E para përfshin kohën që nga pavarësia e Shqipërisë deri në mbisundimin e regjimit komunist 1912-1966, periudhë kjo e cila gjen vend në trajtimin e temës në fjalë. E dyta është periudha komuniste 1966-1990; dhe e treta, periudha e demokracisë 1990 – 2014. Në dy periudhat e para do të ndalemi shkurtimisht për t’u thelluar më tepër në periudhën e tretë, pra atë të kohës së tranzicionit shqiptar (demokracisë).

Periudha e parë 1912-1966, karakterizohet nga kuadro fetarë intelektualë mjaft të përgatitur dhe shumëdimensional, ata ishin hafizë, letrarë, poetë, diplomatë, luftëtarë, e atdhetarë të flaktë. Shumica prej tyre ishin shkolluar jashtë dhe zotëronin disa gjuhë të huaja. “Shqipëria nga shpallja e pavarësisë më 1912 e pastaj me Qeverinë e Mbretit Zog derisa u ndalua feja më 1967 nga regjimi komunist ka pasur dijetarë të shquar islam si H. Vehbi Dibra, H. Ismet Dibra, H. Mahmud Dashi, Hafiz Ali Korça, Hafiz Ibrahim Dalliu, Hafiz Ali Kraja e shumë të tjerë që janë diplomuar në Stamboll dhe kanë bërë një seri përkthimesh e vepra origjinale.”<sup>143</sup>

Në këtë periudhë ajo çka komunikohet në objektet e kultit islam përveç fesë ishte edhe ndjenja e atdhetarizmit, ku kërkohet mbrojtja e atdheut nga pushtuesit. Në këtë periudhë nëpër xhami komunikohet rreziku i ateizmit të imponuar që do të sillte më vonë komunizmi, komunikohet dhe nxiteshin njerëzit të arsimoheshin dhe të përgatiteshin për veten, fenë dhe kombin e tyre, etj. “Teologët shqiptarë në 100 vjetorin e pavarësisë

---

<sup>142</sup> Pajaziti A., Modernizmi, feja dhe lumturia e njeriut.

<sup>143</sup> Intervistë: Balla, Xh. Komunikimi përmes hytbes, intervistoi Lika, F., Maj 2013.

vlerësohen për promovimin e vlerave morale të shoqërisë, që nuk e ndanë fenë nga atdheu dhe familja; kanë kontribuar për mësimin e gjuhës shqipe, si mësimdhënës dhe edukatorë të brezit të ri si dhe me edukatën fetare.

Periodha e dytë 1966-1990 është edhe periodha më e errët për religjionin dhe objektet e tij njëkohësisht dhe njerëzit e fesë. Institucioni i fesë u dobësua në mënyrë të pallogaritshme derisa edhe u shkatërrua totalisht.

Dyndjet masive nëpër xhami, pas shembjes së komunizmit, treguan se besimtarët i mbajtën fort bindjet e tyre fetare, pavarësisht nga përndjekjet. Të gjithë ata fetarë e atdhetarë që kundërshtuan idetë shkatërrimtare të këtij regjimi, u përdoqën, u vranë dhe u masakruan në mënyrën më çnjerëzore, por as kjo nuk mundi të shkulë rrënjët e besimit në vend. *“...Të gjithë elementët shqiptaro-fetar, si vëllezër të një gjaku e si besues të një Zoti të Amshueshëm, duhet me u bashkue e me u organizue në një front të përbashkët për ta luftuar ateizmin, që do me shkatërrue “Fe e Atdhe”. Kjo është lufta e shenjtë që duhet të bëjnë të gjitha fetë në Shqipëri”*, ishte kjo thirrja e myslimanëve kundër komunizmit. Qindra xhami u shkatërruan, ndërsa qindra njerëz të fesë, intelektualë e patriotë u pushkatuan, u burgosën apo u internuan, terror i cili vazhdoi deri në fillim të viteve ‘90.”<sup>144</sup> Në këtë periudhë nuk mund të flasim për një komunikim përmes objekteve të kultit pasi ato u shkatërruan, u mbyllën dhe u kthyen barbarisht në depo e magazina, por në këtë kohë ekzistoi një tjetër lloj komunikimi që njerëzit e fesë realizonin fshehurazi nëpër shtëpi siç ishte këndimi i mevludeve (vepra letrare, poema ku tregohet jeta e profetit Muhamed dhe misioni i tij).

Me shembjen e regjimit komunist në vitet ‘90, më 16 nëntor 1990, pas 23 vjetësh u këndua Ezani dhe u fal Xhumaja në Shkodër, në Xhaminë e Plumbit, e më pas në të gjithë vendin. “Dalëngadalë feja filloi të zërë vendin që i takonte në shoqërinë shqiptare. Paralelisht edhe Komuniteti Mysliman (Xhamitë) ndërmori një rol aktiv në jetën social-kulturore të vendit duke i paraprirë, madje dhe parandaluar probleme të shumta sociale, sepse as fuqia e ligjit nuk e ka fuqinë e bindjes dhe ndikimit të besimit. Por mbi të gjitha sot

---

<sup>144</sup> [10] Lika, F., 90 vjet Komunitet Mysliman Shqiptar, Revista Drita Islame, Shkurt 2013, “<http://www.dritaislame.al/90-vjet-komunitet-mysliman-shqiptar/>”.

liria e besimit triumfon, shpirti i besimtarit ndjehet i lirë të adhurojë Atë që i dha frymë, Atë që e ngjizi, Krijuesin e gjithësisë.”<sup>145</sup>

Pas viteve 90-të shumë të rinj myslimanë u shkolluan brenda e jashtë vendit nëpër shkollat islame në të gjitha nivelet. Për rrjedhojë xhamitë në Shqipëri sot kanë një kuadër të mirëpërgatitur për Islamin, por që siç duket edhe nga veprimtaria e tyre por edhe siç studiuesit e fushës i shohin, nuk janë në nivelin e atyre të para komunizmit. “Sot kemi një brez të ri kuadrosh fetarë, të diplomuar në universitetet fetare jashtë vendit, por që nuk e kanë pjekurinë e stazhin, që dhe këta të bëhen dijetarë të tillë. E ardhmja është pikërisht për këtë brez të kuadrove fetar imam-vaiza; që të vazhdojnë trashëgiminë e të parëve dhe t’u bëjnë brezave që vijnë edhe ata vepra fetare që të mbeten dijetarë islamë që kanë kontribuar për këtë vend.”<sup>146</sup>

#### **4.3.1 Roli i komunikimit përmes ligjërimeve të klerit katolik e orthodox**

Ligjërime e fjalime klerit të krishterë mbi tolerancën dhe bashkëjetesën fetare, raste të predikimit të bashkëjetesës fetare e kanë konstatuar dhe klerikë të krishterë perëndimorë të cilët kanë vizituar vendin tonë, madje dhe nga ata me poste më të larta të besimit të krishter. Një rast të tillë na e përmend revista Zani i Naltë, në një artikull të muajit Prill të vitit 1932, në të cilën shkruhet gjatë për vizitën që ka bërë Jezequele, Delegat i Lidhjes së Kishave, për Paqen Botërore. Më 28 mars 1932 P. Jezequel i Parisit, viziton Komunitetin Musliman Shqiptar dhe Medresenë e Përgjithshme. Atij jo vetëm që i bëjnë një pritje madhështore dhe tepër miqësore, madje në nder të prezencës së tij organizojnë një aktivitet të veçantë me nxënësit e Medresesë së Përgjithshme. Në largim nga kjo ceremoni ai ikën me përshtypje tepër positive dhe thotë: *Në kujtim të një pritje interesante që shpresoj se ka me sjellë një bashkëpunim të vërtetë për kthimin e paqes botërore.*<sup>147</sup>

Pa anashkaluar edhe një nga faktet më interesante për ilustrimin e bashkëjetesës fetare, të shprehur nga kleri i krishterë në Shqipëri, që pas formimit të Shtetit Shqiptar është

---

<sup>145</sup> Po aty.

<sup>146</sup> Balla, Xh, Intervista

<sup>147</sup> “Delegati i Lidhjes së Kishave, viziton Komunitetin Musliman Shqiptar dhe Medresenë e Përgjithshme”; Zani i Naltë, nr 7-8, Mars-Prill 1932

një kritikë e ashpër ndaj disa klerikëve ortodoksë filogrekë, dhe lavdërimi i muslimanëve. Ngjarja e meposhtme tregon se Dhespoti i Gjirokastrës ishte ankuar te organet shtetërore greke për Pavarësinë e Shqipërisë, duke kërkuar që të mos i lënë nën Shqipërinë me shumicë ‘muhamedane’ por ti përfshijnë nën shtetin grek. J.P.Vruho më 30 nëntor 1913 nga Tuba e largët e Egjiptit, në emër të Arqipeshkivë së Durrësit shkruan një letër në të cilën i lavdëron tej mase kryefatarët shqiptarë duke sjellë për shembull Gjergj Fishtën, Dom Nikollë Kaçorrin dhe Pren Biankin, dhe kritikon ashpër me fjalë të rënda, klerikët progrëkë. Këtë letër ai e boton në gazetën zyrtare të kohës Përlindja e Shqipërisë, me miratimin e Pren Biankit, Arqipeshkvit të Durrësit. Ndër të tjera ai thotë që *“Dhespotit të Gjirokastrës ti vijë turp për këtë që ka bërë nëse është sadopak shqiptar, pasi për Dhespotët e Korçës, Konicës dhe Meçovës nuk ndjen keqardhje për qëndrimet e tyre pasi ata janë totalisht grekë...”*<sup>148</sup> duke i ofenduar tepër rëndë këta klerikë antishqiptar, edhe pse i përkiste të njëjtës fe, pasi ai vetë ishte ortodoks. Jo vetëm kaq po ai akuzon këta klerikë si të ‘shitur’ të cilët për pak holla bëjnë gjithçka dhe nuk i përmbahen kurrsesi fesë. Duke e vulosur me një retorikë ndaj këtyre klerikëve ai shprehet se: *Pastaj kanë sy e faqe të këtillë flliqësinash që të qahen nga Muhamedanët Shqiptarë!?*<sup>149</sup>

Lahuta e Malësisë e At Gjergj Fishtës, është e njohur tashmë nga të gjithë si një vepër që mbart vlera. Në këtë vepër të tijën prifti françeskan shkruan: *“Si t’k’ishtenë, si muhamedanë, Shqipërinë bashku t’gjithë e kanë, e prandaj t’gjith do t’qindrojmë, do t’qindrojmë e do t’luftojmë, kemë m’u ba kortarë-kortarë, Prifënt, Fretër e Hoxhallarë, për Shqipërinë...”*<sup>150</sup> Fishta në një nga ligjërimet e tij mbi bashkëjetesën fetare është thënia e tij se: *Feja nuk i ndan shqiptarët e krishterë nga shqiptarët muslimanë; Shqipëria është e shqiptarëve; të gjithë nderojnë Zotin në qiell dhe kantë të njëjtin Zot.*<sup>151</sup>

At Shtjefën Gjeçovi, një tjetër klerik mjaft i njohur shqiptar si ka kontribuar për bashkëjetesën fetare në Shqipëri. Në luftën e Vlorës (1919) ai është mahnitur nga veprimet

<sup>148</sup> *“Qarkore e Arqipeshkëviës të Durrësit”*, Revista Përlindja e Shqipëniës, 14/27 dhjetor 1913, viti I, nr. 33, f. 3

<sup>149</sup> *“Qarkore e Arqipeshkëviës të Durrësit”*, Revista Përlindja e Shqipëniës, 14/27 dhjetor 1913, viti I, nr. 33, f. 3

<sup>150</sup> Fishta, Gjergj; *Lahuta e Malcis*; Uegen, Tiranë 2010, f. 202

<sup>151</sup> Merdani; Arlinda; *Mardhëniet ndërjetare në Shqipëri, Prespektiva të reja për Bashkimin Europian*; Onufri, Tiranë 2014; fq. 55



e popullit shqiptar dhe nga kjo është frymëzuar për disa vargje me plot kuptim. Ai ndodhej me detyrë në Vlorë kur shqiptarët luftuan për çlirimin e Vlorës në vitin 1919, dhe pa me sytë e tij se si shqiptarët pa asnjë dallim, të bashkuar, arritën që të përballen me një ushtri shumë mirë të organizuar. Ndër të tjera ai tha se: *“Nuk lufton shumica e ushtrisë, por besa, bashkimi e ndigjesa e urdhnit të kryepisave”*, më pas për nderim të Vlorës thuri disa vargje; *Rrnoftë Vllaznija! Rrnoftë Bashkimi! Rrnoftë Mbrojtja Kombëtare! Rrnoftë Vlona Shqiptare!...*<sup>152</sup> Për atdhedashurinë që tregoi në Vlorë, atë e transferuan me detyrë në zonën e Mirditës.

Prifti ortodoks Fan Noli ka qenë një nga klerikët më me ndikim në historinë e Shqipërisë në shekullin e kaluar, në veprimtarinë fetare, ardhetare, politike dhe letrare. Ai ishte nismëtar i organizimit të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare në SHBA, madje kontribuan për një organizim të tillë dhe në Shqipëri. Ai ishte simbol i bashkimit, që kur iu kërkua ta shfaqte nuk ngurroi kurrësi, madje për të treguar këtë fenomen ndër shqiptarët, ai përdori aftësitë e tij oratorike të jashtzakonshme dhe gjuhën angleze të cilën e kishte përvetësuar mjaft mirë para liderëve dhe diplomatëve botëror. Ai është pjesë e ekipit të shqiptarëve më 17 dhjetor 1920 në Gjenevë, dhe nga të vetmit që i dëgjohet fjala. Para ndërkombëtarëve ai shprehet se: *Kur në botë zhvillohen ende luftëra ndër fetare, në Shqipëri, muslimanët, katolikët, ortodoksët, jetojnë në harmoni dhe është një fakt i shkëlqyer për një vend me shumicë dërrmuese të popullsisë muslimane të përfaqësohej këtu nga një kristian dhe pikërisht një Prift (Fan Noli).*<sup>153</sup> Fan Noli, është pjesë e ekipit shqiptar në Lidhjen e Kombeve sërisht rreth 7 muaj pas atij fjalimi brilant që zuri faqet e shtypit botëror. Më 25 qershor të vitit 1921,<sup>154</sup> ai mban një tjetër fjalim në Lidhjen e Kombeve duke argumentuar kompaktësinë e shqiptarëve në të gjitha aspektet, në veçanti vlerat që kanë shqiptarët mbi bashkëjetesën fetare. Ai thotë se: *A nuk është e dukshme dhe a nuk duhet marrë si shembull tolerance fetare e shqiptarëve? Sipas statistikave Korça ka 41.070 të krishterë dhe 82.245 muslimanë, këta të fundit proporcionalisht duhet të kishin dyfishin e*

<sup>152</sup> Mata, Ruxhdi; *At Shtjefen Gjeçovi, Jeta dhe Vepra*; SHBLSH, Tiranë 1982, fq. 77

<sup>153</sup> Duka, Ferit; *“Sfondi historik i tolerancës fetare në Shqipëri”*, Simpozium ndërkombëtar ‘Këndëvështrimi i diversitetit fetar, kulturor dhe shoqëror në Ballkan nga prespektiva globale’, 25-26 Mars 2011 në Tiranë; Botim i PRIZMI, Tiranë 2012, fq. 103

<sup>154</sup> Grup autorësh; *Historia e popullit shqiptar III (1912-1939)*; Toena, Tiranë 2007, fq. 173

*deputetëve në Parlament, por ata përfaqësohen me numër të barabartë 5 deputetë ortodoksë dhe 5 deputetë muslimanë. Në Elbasan ku ortodoksët në bazë të numrit kishin të drejtë vetëm për 1 deputet, u zgjodhën 2 deputetë ortodoksë. Në rajonin e Dibërs, ku nuk ka asnjë familje ortodokse, zgjedhësit muslimanë të këtij rajoni zgjodhën 2 deputetë ortodoksë, me origjinë nga Shqipëria e Jugut. A nuk do të ishte pa kuptim çdo koment i këtyre fakteve? Dhoma e deputetëve është e përbërë nga 78 përfaqësues, nga të cilët 32 janë ortodoksë, 41 % e përfaqësuesëve. Madje kryetari dhe një nga sekretarët e saj u zgjodhën nga ortodoksët. A ka vallë një harmoni të tillë edhe në shtetet tjera?* <sup>155</sup>

Prifti ortodoks Fan Noli edhe pse klerik-prift ortodoks, i ngarkuar me detyrën e përfaqësimit të Shqipërisë para Lidhjes së Kombeve, për të mbrojtur interesat shqiptare i jep një shembull konkret, madje me sarkazëm thotë se gjithë këto fjalë nuk kanë absolutisht nevojë për koment nga pas. Megjithëse përqindja e popullsisë mbi përkatësinë fetare në këtë kohë paraqitej me përafërsi rreth 70% muslimanë, 20 % ortodoksë dhe 10 % katolikë. Noli me retorikë dhe për ti treguar botës se në Shqipërinë që ata po e persekutonin aq shumë padrejtësisht, gjithë këto shifra të përkatësisë fetare nuk kishin rëndësi për shqiptarët, të cilët ishin mjaft tolerantë dhe kishin një bashkëjetesë për tu patur shembull. Ai paraqet para botës se shqiptarët ishin aq të qytetëruar për të bashkëjetuar me bashkëkombasit e tyre pavarësisht besimit që ata kanë. E gjithë kjo ishte për t'ju treguar ndërkombëtarëve se jetesa ishte mëse normale në Shqipëri, madje për tu marë në shembull nga aspekti i tolerancës dhe bashkëjetesës fetare, dhe se kurrsesi nuk duhet të ngatërrohet përkatësia fetare me përkatësinë kombëtare. Kjo pasi ndërkombëtarët duke u nxituar nga fqinjët e tanë, shpesh ortodoksët i konsideronin si grekë apo sllavë, e në këtë mënyrë të shkëputej nga Shqipëria ndonjë pjesë tjetër toke në favor të fqinjëve. Fjalimi i fundit i Nolit para Lidhjes së Kombeve ishte më 29 shtator 1924, në Lidhjen e Kombeve, kritikon raportin e bërë nga Lidhja për shqiptarët muslimanë të Epirit. Kjo pasi në raport muslimanët e çamërisë ata i kishin konsideruar si minoritet turk, dhe kështu duhej të shkëmbeheshin me minoritetin grek që ndodheshin në Turqi. Noli me të drejtë thotë

---

<sup>155</sup> Noli, Fan S. *Ligjërime (1906 - 1964)*; përgatitur nga Nasho Jorgaqi; Dudaj, Tiranë 2002, fq. 122-123

se: “Është një e vërtetë e pamohueshme se muslimanët e Epirit nuk janë gjë tjetër përveçse shqiptarë.”<sup>156</sup>

Mitropoliti Visarion Xhuvani, Kryetari i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare (1929 -1937), si shembulli më brilant nga klerikët e krishter vendas e ka dhënë pa diskutim. Ai besoj ka qenë nje rast I rrallë I ruajtur në letra që jo vetëm ka patur mardhënie shumë të mira me hoxhallarët, klerikët, dijetarët dhe titullarët e Komunitetin Musliman Shqiptar, por ai i veshur me pushtetin e Kryetarit Ortodoks, gjithashtu i veshur me petkun fetar të një prifti, ka mbajtur një nga fjalimet më brilante, prekëse, me shumë kuptim dhe mbresëlënëse që është parë ndonjëherë në ceremonitë mortore. Visarion Xhuvani i prekur thellë nga ndarja nga jeta e mikut të tij të ndëruar, H. Vehbi Dirbës, ai jo vetëm që mer pjesë, por i pikëlluar mban një fjalim të “gjatë” ku ndër të tjera në këtë fjalim ai thotë se: *Haxhi Vehbiun e kam njohur si një nga të parët Kryetarë Shqiptarë që u dha dorën të krishterëve duke thënë se: ‘secili nga besimtarët ndjek besimin e të parëve tanë (muslimanë ose të krishterë), porse kudo në jetë ne jemi vllazër të pandashëm. Unë sot po e thyej pengesën e mospjesmarrjeve pjesë nga ana jonë në ceremoni të tilla.*<sup>157</sup>

---

<sup>156</sup> Noli, Fan S.; *Ligjërime (1906 - 1964)*; përgatitur nga Nasho Jorgaqi; DUDAJ, Tiranë 2002, fq. 240

<sup>157</sup> Dibri, Haxhi Vehbi; *Ç’urdhëron Kur’ani*; Komuniteti Musliman Shqiptar, Tiranë 2014, fq. 15

## KAPITULLI V

### ANALIZË MBI TOLERANCËN FETARE NË RANG NDËRKOMBËTAR

#### 5.1 Komunikimi ndërftar në sytë e një të krishteri

Thomas Michel<sup>158</sup>, do të shprehej: “Më është mbushur mendja se myslimanët e të krishterët, formojnë dy familje të mëdha feje që rrjedhin prej një paraardhësi të përbashkët: Abrahamit (Ibrahimit). Ne këtë vazhde reflektova rreth temës sime të studimit dhe se sa jehonë ka pasur kjo vlerë e shqiptarëve tek shumë autorë evropianë. Është vullneti i Zotit të jetojmë së bashku, në nderim të anasjelltë e në paqe, e të punojmë të dyja palët, që mbi tokë të bëhet vullneti i Tij. Myslimanë e të krishterë mendojnë se kanë shumë gjëra të përbashkëta, për faktin se besojnë se Zoti na ka zbuluar natyrën e vet. Kështu ata e njohin, si sovran të jetës dhe nëpërmjet atyre që iu dha hiri i profetësisë, Zoti zbuloi vullnetin e vet për njerëzimin”.<sup>159</sup>

Myslimanët të krishterët e mirëfilltë, i vlerësojnë si aleatë natyrorë kundër shekullarizimit, por besojnë se të krishterët për t’u dukur modernë shpesh kanë dalë nga natyra e vet, pohon Thomas Michel, një prift katolik amerikan. Ndonjëherë të krishterët krenohen me të qenët modern dhe thonë se myslimanët janë të prapambetur, thotë Michel, kurse për myslimanët, të krishterët nuk e kuptojnë se deri në çfarë mase ata e kanë kompromentuar besimin e tyre me elemente të kulturës moderne dhe pikërisht mbi termat e modernizmit, të krishterët duhet të ndërmarrin një dialog të vërtetë me myslimanët.<sup>160</sup>

---

<sup>158</sup> Prof. Dr. Thomas Michel, pedagog i teologjisë katolike, njëkohësisht një klerik jezuit nga SHBA. Ai ka pasur gjithashtu edhe detyrën e sekretarit për dialog ndërftar për shumë vite në Vatikan, si dhe ka dhënë mësim në shumë universitete të vendeve myslimane, si lektor i teologjisë së krishterë në fakultetet e Shkencave Islame, si Turqi, Indonezi, Filipine, etj.

<sup>159</sup> Michel, Th., “Për të kuptuar kristianizmin: Një i krishterë i paraqet myslimanëve fenë e tij”, isg edizioni, pa vit botimi, Tiranë, f. 4, 9.

<sup>160</sup> Po aty, f. 114.

Dialogu mes te krishterëve dhe myslimaneve, nuk duhet të ndahet kurrë nga dialogu mes kulturave, dhe ajo çfarë do kishte akoma me rëndësi duhet të dialogohet me të varfrit. Dialogu ndërfitar mund të kthehet mjaft lehtë në një ushtrim elite, në të cilin studiues dhe autoritete fetare të krijojnë një vëllazëri të tyre në formë klubi për të përjetësuar dhe, në rastin më të keq, justifikuar *status quo*-në ekonomike dhe shoqërore.

Në këtë dialog të krishterët nuk duhet të hezitojnë të kërkojnë bazën në traditën e madhe profetike të Shkrimeve të tyre, shembuj të cilët gjenden tek Gjon Pagëzori (Profeti Jahja a.s.), në letrën e Jakobit (Jakubit a.s.), etj.<sup>161</sup>

Jo shpesh herë në situata dialogu mes të krishterëve dhe myslimanëve është dëgjuar të citohen këto elemente qëndrore. Pikërisht janë këto gjëra që duhet t'i flasim me myslimanët, -thotë Michel -, këto janë aspektet e besimit tonë, që kemi nevojë t'i komunikojmë njëri-tjetrit. Kurse myslimanët kanë nevojë të njohin elementet e çlirimit për të varfrit. Ne kemi nevojë të zbulojmë traditën e fortë profetike të pranishme në Kur'an, si dhe elementet e çlirimit që hasen në shtyllat e Islamit dhe në Sheriat, – nënvizon Thomas Michel në librin e tij.<sup>162</sup>

Ai thekson se, është shenjë e paditurisë sonë fakti se shumë të krishterë përgjigjen: “Nuk e dinim se në Islam ishin të pranishme aq shumë elemente të çlirimit; mendonim se Islami i shtypte të varfrit, gratë, mëkatarët; kishim përshtypjen se Islami ishte pasiv dhe fatalist ndaj padrejtësive dhe të keqes.” Por mjafton të frekuentosh për gjysmë ore një librari myslimane për të zbuluar tituj si “Islami: feja e drejtësisë”, “Islami dhe çlirimi i grave”. Por edhe myslimanët në përgjithësi nuk janë më të informuar mbi fenë tonë nga ç’jemi ne për të tyre.<sup>163</sup>

Pengese që i ndalon të krishterët të vlerësojnë dhe të zhvillojnë dialogun me myslimanët mbi elementet e përbashkëta të çlirimit është fakti i dhimbshëm se shpesh, si të krishterët, ashtu edhe myslimanët janë të mbyllur në konflikte të besimit, në të cilat përkatësia fetare, nëse nuk është arsyeja e konfliktit, luan një rol të rëndësishëm në

---

<sup>161</sup> Për më tepër, shih: Mt 57; Lk 5, 12-49.

<sup>162</sup> Michel, Th., Për të kuptuar kristianizmin: Një i krishterë i paraqet myslimanëve fenë e tij, isg edizioni, pa vit botimi, Tiranë, f. 118.

<sup>163</sup> Po aty, f. 118.

vendosjen e njërës palë kundra tjetrës, duke e parë njëri-tjetrin si armiq dhe si një kërcënim të ndërsjellë.

Autori thotë se: “Në pjesën më të madhe të myslimanëve të zakonshëm, Islami është para së gjithash e mbi të gjitha një përgjigje ndaj Zotit, një mënyrë për të takuar Krijuesin dhe për të bërë vullnetin e Hyjit mbi tokë.” Ai thekson se: “Me myslimanët që nuk interesohen për politikën, për revolucione, apo konflikte civile, pikërisht se janë shumë të angazhuar për të mbajtur familjen, për t’u mësuar fëmijëve frikën ndaj Zotit, etj., duhet të hapet dialogu mbi të Vetmin Zot, i aftë për të çliruar njerëzimin nga mëkati dhe nga strukturat shtypëse që kemi ndërtuar.”<sup>164</sup>

Nëse të krishterët dhe myslimanët do të jenë të zotët që së bashku t’u ofrojnë të gjithëve një rrugë për të jetuar në planetin tonë në mënyrë më paqësore, njerëzore dhe të çelur ndaj shpresës, ata do të mund të luajnë rolin për të cilin Zoti i ka krijuar.<sup>165</sup>

Ky autor shpjegon gjithashtu një ndodhi të vetën në qytetin e Konias, në Turqi, në vitin 1988, kur kishte shkuar për të ligjëruar në universitetin e këtij qyteti për 7 muaj. Kur e pyetën njerëzit se çfarë detyre kishte, ai u përgjigj me fjalën origjinale që përdoret në Kur’an në arabisht, por që përdoret edhe në turqisht “*rahib*”. Ata menjëherë e kishin pyetur se a kishte nevojë për ndonjë gjë, ndërkohë që ai sapo kishte zënë një shtëpi me qira pa plaçka dhe kishte nevojë për çdo gjë. Menjëherë komshinjtë e tij, familje punëtorësh, i kishin dhënë, njeri një karrige, njeri një tavolinë dhe për tre ditë ia kishin kompletuar shtëpinë të tërën, deri tek enët e kuzhinës.

Sërish i kishin trokitur në derë dy burra në orët e vona të natës, dhe At Thomasi kishte menduar se mos ishte policia. Ata kishin hyrë dhe kishin kontrolluar se çka i kishte mbetur mangët. Të nesërmen nuk mungonte asgjë. Më pas i kishin thënë se gratë e komshinjve do t’i sillnin ushqime, kur ishte në leksion në universitet, por dera kishte qenë e mbyllur. Kështu Ati ishte detyruar që ta linte derën të pakycur kur dilte në mëngjes. Kur kthehej pasdreke ai gjente shtëpinë e pastruar, të rregulluar, plaçkat e lara dhe të hekurosura dhe tavolinën e shtruar me gjellë të ngrohta.

---

<sup>164</sup> Po aty, f. 119-120.

<sup>165</sup> Michel, Thomas, “Për të kuptuar kristianizmin: Një i krishterë i paraqet myslimanëve fenë e tij”, isg edizioni, pa vit botimi, Tiranë, f. 138-140.

Gjatë 7 muajve At Micheli nuk i kishte parë asnjëherë ato gra, si duket ato e shihnin kur dilte dhe pastaj i bënë punët në banesën ku ai banonte. Kur kishte ardhur koha që ta linte qytetin, ai ishte përshëndetur me një burrë të lagjes dhe i kishte kërkuar që t'i takonte gratë që ia kishin bërë punët pa u lodhur gjatë gjithë atyre muajve, por ai kishte marrë një përgjigje befasuese:

“Nuk është e nevojshme t'i falënderosh, ato nuk e kanë bërë këtë për ty, e kanë bërë për hir të Zotit. Në Kur'an është shkruar se ne duhet t'i trajtojmë mirë murgjit. Ky është një akt besimi ndaj Zotit dhe Ai i sheh se ç'kanë bërë këto gra dhe i shpërblen ato”, – i kishte thënë burri. Kështu që nuk kishte qenë e nevojshme që At Thomasi t'i falënderonte ato.

Autori ka bërë një studim të mirëfilltë në lidhje me argumentet që jep Nursi në marrëdhëniet e të krishterëve të vërtetë me myslimanët, në veprën e tij “Risale-i Nur” dhe në bashkëpunimin e tyre në kohët moderne kundër armiqve të përbashkët si ateizmi, darvinizmi, imoraliteti, etj., duke u bashkuar në besimin tek Zoti si një dhe i Vetëm.

## **5.2 Toleranca në fenë Islame dhe hulumtuesit e paanshëm të Perëndimit**

De Lacy O'Leary thotë: “Historia na e ka bërë shumë të qartë se legjenda se Islami është përhapur me shpatë anembanë botës është prej legjendave më të ultë, të cilën fatkeqësisht historianët perëndimor e kanë përsëritur vazhdimisht”<sup>166</sup>.

Trittoni thotë: “Fotoja e myslimanëve luftëtarë të cilët në një dorë kanë shpatën dhe në tjetrën kanë Kuranin është një foto shumë falso”.<sup>167</sup>

Leonardo thotë: “E gjej veten të detyruar të konfirmoj se Muhammedi e refuzon dhe nuk e pranon dhunën në fe”.<sup>168</sup>

Gustaf Lebenon thotë “Rruga të cilën duheshe ta ndjekin kalifët ishte e qartë. Ata kishin kuptuar se nuk duhet të detyrojnë me forcë njerëzit të braktisin fenë e tyre... dhe në çdo vend publikuan se i respektojnë besimet e popujve, doket dhe zakonet e tyre”.<sup>169</sup>

---

<sup>166</sup> De Lacy O'Leary, Arabic thought and its place in History, fq. 8.

<sup>167</sup> (A.S. Triton, Islam, fq. 21).

<sup>168</sup> A.G. Leonard, Islam, fq. 72).

<sup>169</sup> (Gustav Lebon, Civilizimi arab, fq. 134).

M. ROY thotë: “Prapavija historike e Islamit dhe rrethanat shoqërore në të cilin është zhvilluar e kanë ngjyrosur me ngjyrë të tolerancës, që ia bënë të qartë edhe syrit që nuk sheh se nuk përputhet me shpirtin fanatik që në zakonisht e ndërlidhim me islamin, madje vetëm *dëshmia fjala la ilahe il-lallah* krijon tolerancën”.<sup>170</sup>

Orientalistja italiane Laura Veccia Vaglieri thotë: “Nuk është hiperbolizim nëse me ngulm insistojmë se Islami jo vetëm që ka thirrë në tolerancë fetare por e ka bërë pjesë të ligjeve që zbatohen vazhdimisht”.<sup>171</sup>

Shkrimtari i njohur Britanez H.G. Wells thotë: “Ajo që tërhoqi zemrat e shumicës së njerëzve kur erdhi Muhammedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, me fenë Islame ishte ideja e Hyjit, Allahut, që do të thotë me perceptimin e natyrshëm në të cilën i ka krijuar e vërteta njerëzit, dhe me pranimin e tyre të sinqertë të Islamit dhe metodës së tij, në një kohë kur bota ishte e mbushur me mosbindje, trillime dhe ndarje të egra, para tyre u hap një derë e gjerë e vëllazërisë së madhe njerëzore dhe të zhvilluar, saqë edhe në firdes, shenjtorët, priftërit dhe mbretërit nuk e zënë vendin më të lartë por edhe aty realizohet barazia mes ithtarëve të një feje, pa simbole mistike, apo rituale të errëta, apo veprime priftore. Muhammedi e solli këtë sistem të vlerave morale të zemrat e njerëzimit. Islami krijoi një shoqëri të çliruar nga dhuna dhe shtypja shoqërore të panjohur më parë në shoqëritë e atëhershme”.

Ai gjithashtu thotë: “Islami u përhap dhe dominoi sepse i dha njerëzimit sistemin më të mirë politik dhe shoqëror të cilin mund t'ia jepte koha. Sistem i cili paraqet idenë politike më të gjerë, më të pastër dhe më të filtruar të mundshme, i cili gjer më tani realizohet në rruzullin tokësor”.<sup>172</sup> ( Kurse në librin tjetër, “Historia e botës- version i shkurtuar” thotë: “Elementi i tretë i forcës së Islamit qëndron në insistimin në vëllazërinë dhe barazinë e plotë para Zotit mes të gjithë besimtarëve pa marrë parasysh dallimin e ngjyrave apo qendrave të tyre ligjore apo shoqërore”.<sup>173</sup>

---

<sup>170</sup> (M. Roy Historical role of Islam, fq. 40-41).

<sup>171</sup> (Laura Veccia Vaglieri, An Interpretation of Islam”, fq. 26).

<sup>172</sup> H.G. Wells Outline of History, fq. 211 dhe 271- 272).

<sup>173</sup> H.G. Wells Short history of the World, fq. 146).



### 5.3 (In)toleranca fetare dhe laike; *Rast studimor*

Është e çuditshme se si modeli shqiptar është superior edhe sot megjithëse në kushte krejt të ndryshme. Pavarësisht lirive të garantuara shpesh aplikimi i tyre lë për të dëshiruar. Përplasja mes lirisë së fjalës dhe asaj të besimit tregon se abuzivizmi ka shumë më tepër hapësirë sesa liria ose thënë më saktë liria e fjalës mund të çënojë lirinë e besimit por e kundërta jo. Kjo mpleksje përveç paqartësisë ligjore shpesh shfaqet si një përplasje mes të dyjave që tregon se sa i brishtë është koncepti i tolerancës edhe në kushte paqësore.

*Në një botë gjithnjë e më të globalizuar, në të cilën të gjitha fetë janë duke u bërë gjithnjë e më tepër fe 'të diasporës', lidhjet ndërkombëtare mes feve kanë dobi pozitive për të ofruar kanale të pasqyrimin në kontekste të ndryshme kulturore. Por, tragjikisht, ato mund të bëhen edhe përçuese përmes të cilave konfliktet janë transportuar nga një pjesë e botës në një tjetër.*

*Stereotipet me portretizime negative rreth myslimanëve nëpër media, vetëm sa e kanë rritur më tej dyshimin ndaj tyre. Ekziston gjithashtu një mungesë e qartë e informacioneve rreth Islamit në shoqëritë perëndimore, me përjashtim të disa universiteteve dhe specialistëve të veçantë. Por ekziston gjithashtu edhe një mungesë e theksuar e informacionit rreth Perëndimit në shumë shoqëri myslimane.*

Një studim nga Prof. Paul Weller<sup>174</sup>, nxjerr në pah problemet dhe shkaqet e tyre në lidhje me stereotipet që ekzistojnë sot mes Perëndimit dhe Botës Islame. Sipas tij në të gjitha shoqëritë tona ekzistojnë 'kundërshti' ose 'kontradikta' lokale të veçanta dhe specifike, që mund të çojnë në konflikt. Por në botën bashkëkohore, kudo që jetojmë, për shkak të ndikimit në botën moderne të asaj që historiani britanik Arnold Toynbee e ka quajtur "asgjësimi i distancës"<sup>175</sup>, ne të gjithë jetojmë gjithashtu në një kontekst më të gjerë global. Në lidhje me këtë botë të globalizuar të komuniteteve etnike dhe fetare

---

<sup>174</sup> Profesor i marrëdhënieve ndërfaqetare në Universitetin e Derbit, Britani e Madhe dhe pedagog i jashtëm në Qendrën për Krishterimin dhe Kulturën, Oxford, Regent College Park, Universiteti i Oksfordit.

<sup>175</sup> Toynbee, A., "Krishterimi mes Feve të Botës", Oxford University Press, London, 1958: 87.

ndërkombëtare, Gylen ka vërejtur se, mjetet moderne të komunikimit dhe transportit e kanë transformuar botën në një fshat të madh, global. Kjo kohë është një periudhë e marrëdhënieve ndërvepruese. Kombet dhe njerëzit janë më në nevojë dhe më të varur nga njëri-tjetri, gjë që shkakton afërsi në marrëdhëniet reciproke.<sup>176</sup>

Në një botë gjithnjë e më të globalizuar, në të cilën të gjitha fetë janë duke u bërë gjithnjë e më tepër fe ‘të diasporës’, lidhjet ndërkombëtare mes feve kanë dobi pozitive për të ofruar kanale të pasqyrimin në kontekste të ndryshme kulturore. Por tragjikisht ato mund të bëhen edhe përçuese përmes të cilave konfliktet janë transportuar nga një pjesë e botës në një tjetër. Si pasojë e kësaj, ndërsa disa kundërshtime dhe kontradikta janë të veçanta për shoqërinë tonë, ka edhe të tjera, të cilat mund t’i quajmë ‘kundërshtime globale’, që vrapojnë thellë dhe gjerësisht në mes të të gjitha shoqërive dhe rajoneve të botës. Këto ‘kundërshtime globale’ përfshijnë ato në mes të ‘fetarëve’ dhe ‘laikëve’, si dhe mes atyre sferave, që në të vërtetë janë të lidhura ngushtë, por ngjan sikur janë të dallueshme nga njëra-tjetra, pra në mes “shkencës” dhe “fesë”. Ato gjithashtu përfshijnë kundërshtitë mes ‘Perëndimit’ dhe ‘Lindjes’, si dhe atyre që gjithashtu lidhen, por që janë edhe të dallueshme mes njëra-tjetrës, pra midis “Krishterimit” dhe “Islamit”.<sup>177</sup>

Duke menduar rreth laicizmit në drejtim të kundërvënies së tyre me botën fetare, Paul Weller ka vënë në dukje se:

1. Në tërësinë e një perspektive globale historike, është ndoshta me vlerë të rikujtohet se është “laicizmi”, ai që duhet të konsiderohet një eksperiment i ri në organizimin dhe integrimin shoqëror.
2. Origjina reaktive e ‘laicizmit’ mund të gjendet në trashëgiminë evropiane të inkuizicionit, “monopolin shtetëror të fesë” dhe ndikimin e luftërave, që ka nxitur feja gjatë shekullit të XVII, gjë që solli si kundër-reagim lëvizjet revolucionare të liberalizmit ekonomik, republikanizmit, si dhe shfaqjen e socializmit dhe të marksizmit.

---

<sup>176</sup> G. M. Fethullah, “Drejt një Qytetërimi Botëror të Paqes dhe Tolerancës” (vers. angl.), New Jersey: Light, 2004: 230.

<sup>177</sup> Weller, Paul, kumtesë me temë: “Gylen dhe Arti i Bashkëjetesës në një Epokë të Kundërshtive Globale”, simpozium: “Këndvështrim i diversitetit fetar, kulturor dhe shoqëror në Ballkan nga perspektiva globale; Përvoja e F.G. si Model dhe Harmonia Ndërfetare në Shqipëri”, Tiranë 25-26 Mars 2011.

3. Rrënjët evropiane të 'laicizmit', të cilat mund ta bëjnë atë problematik për shoqëritë e tjera, përvoja e të cilit është importuar nga Evropa, ka qenë e lidhur me ndërmarrjet koloniale dhe imperialiste.
4. Është e nevojshme për t'u parë sidomos se si 'laicizmi' mund të lidhet me trashëgiminë civilizuese myslimane.
5. Njohja e nevojës të marrjes në konsideratë në mënyrë eksplicite të 'laicizmit', mund të rezultojë në formulimet e mëparshme me "sens të përbashkët" të problemeve dhe çështjeve që janë rikthyer si aktuale, duke bërë të mundur, që ato të shihen nga perspektiva të reja dhe të panjohura më parë.<sup>178</sup>

### 5.3.1 Abuzivizmi me lirinë dhe konfliktet sociale përtej kufijve shqiptarë

Gazeta më e madhe daneze, në shtator të 2005-ës, "Jyllands Posten", porositi hartimin e disa karikaturave për Profetin Muhamed (a.s.) nën motivacionin "*Muhammeds ansigt*" – "*Fytyra e Muhamedit.*" Do të duheshin pak ditë dhe në mëngjesin e 30 shtatorit të po atij viti, ato letra të bardha tashmë të mbushura me ngarkesa emocionale, të cilat dilnin përtej kontekstit të ngushtë në të cilin qenë pikturuar, të shpërndareshin në çdo pikë shitjeje të Danimarkës. "Jyllands Posten", kryegazeta daneze ishte ajo e cila mori përsipër të botonte karikaturat në të cilat satirizohej një ndër profetët më të mëdhenj të njerëzimit, domethënia shpirtërore e jo më pak se 2 miliardë njerëzve, vetë Profetin Muhamed. Justifikimi ishte i thjeshtë dhe si zakonisht i standardizuar kur bëhet fjalë për të argumentuar qëllimin e një aksioni të tillë mediatik. "Liria e shprehjes", që fraza e cila nxitoi të mbulonte me status ligjor botimin e karikaturave. Në një formë pandemie, botimi i karikaturave shpejtoi të përhapej në shumë media të shkruara prestigjioze, duke marrë flamurin e lirisë së shprehjes. Por gjatë gjithë ecejakeve të veta mediatike, këto botime nuk

---

<sup>178</sup> Për më tepër lexo artikujt mbi "të Drejtat e Njeriut", "Fenë" dhe "Laicizmin". Konfigurime të ndryshueshme të Fesë(ve), Shtetit(eve) dhe Shoqërisë(ve) u prezantuan nga *Institute of Commonwealth Studies*, Clemens Nathan Research Centre dhe Martinus Nijhoff Publishers në "Pyetësorin rreth të Drejtave të Njeriut dhe Fesë" të zhvilluar në *Institutin e Studimeve të Komunuelthit*, Londër më 28 Shkurt 2005. Këto forma të përmbledhura u prezantuan në një referat konference të pabotuar nga autori rreth "Të brendshëm dhe të Jashtëm? Grupimet Fetare, Shoqëria e Sjellshme dhe Shteti (post?)Modernist në St. Columb's Park House, Forumi i 8-të i Inter-Isles rreth "Fesë dhe Shtetit: Mbajtja e Peshores Drejt", mbajtur në University of Westminster, Londër, 27 Janar 2007.

u shoqëruan kurrë me kriterin bazë që ka liria e shprehjes, kriterin e së vërtetës, të lidhjes reale, që këto afishime sarkastike kishin me të vërtetën. Ngjarja e 2005-ës u pasua me një ripërsëritje të një karikature në formë filmi, nga Sam Bacile, ngjarje e cila, ashtu si në rastin e parë të karikaturave, shkaktoi tensione dhe konflikte të cilat prekën cepat e globit, kryesisht në vendet myslimane, të cilat u pasuan me dhunime të përfaqësive diplomatike, por edhe me vrasjen e plagosjen e qindra personave përfshirë edhe Ambasadorin amerikan në Bengazi. Kështu, një debat i gjerë mori udhë në të gjithë hapësirën intelektuale dhe institucionale të globit lidhur me legjitimitetin e botimit të karikaturave, si dhe të drejtën për besim të individit, të drejtën për të qenë i lirë në besimin e tij.

Këtu po marr përsipër të analizoj dhe të bëj krahasueshmërinë e teorive dhe fakteve në të cilat të dyja palët mbështeten në këtë konflikt, përmes mirëkuptimit të konceptit të lirisë, do të përpiqemi të analizojmë bazamentet juridiko-administrative mbi të cilat mbështetet dhe aplikohet liria në rendin e ri juridik. Në të, do të sillen konceptet e lirisë të cilat i nënshtrohen një rendi të caktuar kufizimesh, si dhe faktit që liria është bashkudhëtare me përgjegjshmërinë. Për të thelluar më tej të kuptuarit e lirisë, nga dy boshte qytetërimore të ndryshme, siç është rasti i Perëndimit dhe i botës myslimane, do të sjellim në vëmendje konceptet perëndimore mbi lirinë, si dhe ligjet e konventat të cilat e garantojnë këtë liri, pastaj do të bëjmë përshkrimin e konceptit të rendit qeverisës brenda Islamit, si dhe konceptet mbi institucionet dhe të drejtën që ka ky rend qeverisës. Kështu, përmes analizës dhe referencave do të përballim dy qasje të ndryshme qytetërimore lidhur me lirinë dhe të drejtën e saj për të ekzistuar në shoqëri. Do ta bëjmë këtë, për faktin se ngjarja përfshiu dy boshte qytetërimore, të cilat kanë një këndvështrim të ndryshëm mbi lirinë e besimit dhe hapësirën e saj në shoqëri. Duke arritur të kuptojmë të dy sistemet do të mund të ndërtojmë qasje më të qenësishme mbi ngjarjen dhe pretendimet dhe duke i sjellë ato në vëmendjen e audiencës do të përpiqemi të japim një kontribut sado të vogël për të rritur mirëkuptimin e ndërsjellë.

Është interesante të futemi në një dimension jo shumë të njohur të lirisë, por që është themelor për një qytetërim, ku liria konsiderohet si atribut transcendent. Ky dimension është dimension i metafizik i lirisë, i cili përbën edhe bazamentin moral të saj. Për këtë do të përpiqemi të bëjmë dallimin themelor mes lirisë racionale dhe lirisë

irracionale, si shkaktare të konfliktit. Pastaj do të analizojmë qasjen e shtetit sekular mbi lirinë, ku do të duhet të futemi në konceptin e kritikës dhe kritikizmit sekular, si arma më e fortë me të cilën shoqëritë sekular-liberale përpiqen të ruajnë hegjemoninë e tyre në hapësirën publike dhe do të përpiqemi të provojmë sesi kritika sekulare përmes formash e zhanresh të ndryshme, përfshirë edhe karikaturën, shpesh nuk respekton dimensionin religjioz të individit, duke u bërë kështu premisë konfliktualiteti mes grupeve shoqërore, apo edhe shoqërive me format të ndryshëm botëkuptimor. Botimi i karikaturave dhe filmi i Sam Bacile, përdorën hapësirën publike me anën e kanaleve të komunikimit mediatic për t'u afishuar dhe komunikuar me audiencën. Për këtë arsye e shohim të domosdoshme që të ndalemi tek koncepti i hapësirës publike të shoqërive respektive për të bërë edhe dallimin mes hapësirës publike sekulare dhe asaj religjioze dhe faktit se pse u përdor hapësira publike sekulare për të komunikuar me një hapësirë tjetër publike, siç është ajo religjioze përmes një zhanri të kritikës sekulare si karikatura. Hapësira sekulare publike, si pasojë edhe e historisë së saj në shtetet perëndimore, ka pasur si detyrë kryesore shtyrjen e religjionit në hapësirën private të individit duke e larguar atë nga teatri i arsyes publike. Ne, do të mundohemi të argumentojmë se në fakt, hapësira sekulare publike edhe këtë “marrëveshje” nuk po e respekton sepse pikërisht karikaturimi i Profetit Muhamed (a.s.), ishte rasti tipik kur hapësira publike dhunon privatësinë e individit në religjiozitetin e tij duke u bërë premisë konflikti.

Një tjetër qasje ku ne do të ndalemi është fuqia e karikaturës në ndezjen e konflikteve sociale. Për këtë na duhet të ndërhyjmë në strukturën ideore të karikaturës për të kuptuar misionin dhe përmbajtjen e saj. Pastaj do të duhet të zbërthejmë konceptin e ideografisë dhe retorikës vizuale, si armë të cilat materializojnë në formë artistike kundërshtitë sociale. Pas kësaj do të argumentojmë se pse karikaturat daneze nuk ishin përfaqësuese të një strukture karikature tradicionale dhe faktin se si retorika vizuale ishte përdorur jashtë misionit, kontekstit, kompozimit dhe kondensimit të saj duke dhënë si produkt, karikatura brenda karikaturës. Interesante do të jetë edhe një qasje e mundshme në mes lirisë së fjalës, apo fobisë ndaj emigrantëve, për të zbuluar nëse pretendimet për liri të fjalës ishin vërtet merak i madh për fatet e lirisë, apo përdorëshin për të maskuar një fobi në rritje ndaj emigrantëve, si bartës të kulturave të tjera migratore në shtetet perëndimore.

Në shtator të vitit 2005, një grup prej 12 karikaturistësh vendosën t'i merrnin pafajësinë letrës së bardhë duke rrëshqitur në të lapsat e tyre tërësisht jashtë naivitetit, për të projektuar vizionin, që ata kishin lidhur me fenë Islame dhe Profetin Muhamed (a.s.). Do të duheshin pak ditë, dhe në mëngjesin e 30 shtatorit të po atij viti, ato letra të bardha, tashmë të mbushura me ngarkesa të rënda emocionale, në të cilat Profeti i Islamit portretizohej si simboli i dhunës dhe perversitetit, të shpërndareshin në çdo pikë shitjeje të gazetave të shoqëruara me një koment nga Fleming Rose, redaktori i kulturës së kësaj gazete.<sup>179</sup> Ky publikim nuk zgjati shumë dhe shkaktoi një zemëratë me përmasa globale në mesin e myslimanëve, të cilët i konsideruan këto karikatura si thellësisht fyese dhe përçmuese. Në fakt, brenda pak muajve, kundërshtitë ndaj publikimit të këtyre karikaturave u përshkallëzuan në një konflikt social me përmasa ndërkombëtare të shkaktuar nga përhapja e tyre në formë pandemie në shumë media, kryesisht në Evropë.

Më 12 tetor 2005, 11 ambasadorë të vendeve arabe i kërkuan takim Kryeministrit danez Anders Fogh Rasmussen i cili refuzoi të takohej me ta për çështjen në fjalë, ndërkohë që njëzet e dy ish-ambasadorë danezë kritikuan ashpër Kryeministrin danez për këtë refuzim. Pas këtij presioni, Kryeministri Rasmussen u takua me ambasadorët e vendeve myslimane në Kopenhagen vetëm më datën 2 shkurt 2006. Më 14 tetor 2005, mbi 5000 vetë morën pjesë në një demonstrim paqësor para zyrave të "Jylland-Posten" në Kopenhagen. Më vonë e gjithë kjo u pasua me një delegacion të përbërë nga disa përfaqësues të organizatave dhe institucioneve islame në Danimarkë, të cilët udhëtuan drejt Egjiptit, Sirisë, Turqisë e Libanit me qëllim sensibilizimin e liderëve të këtyre vendeve lidhur me publikimin e këtyre karikaturave.<sup>180</sup> Nëntori i po këtij viti shënoi vendosjen e këtyre ngjarjeve në agjendën e samitit të radhës të Organizatës së Konferencës Islamike, e cila më pas në mbledhjen e 8 dhjetorit shpreh:

*Shqetësimin lidhur me rritjen e urrejtjes kundër Islamit dhe myslimanëve dhe dënon aktet e diskreditimit të imazhit të Profetit të Shenjtë Muhamed (s.a.u.s) në mediat e disa vendeve*

---

<sup>179</sup> "Muhammeds ansigt", *Jyllands-Posten*, 30 Shtator 2005.

<sup>180</sup> H. M. Fatah, "At Mecca Meeting, Cartoon Outrage Crystallized", *The New York Times*, 9 shkurt 2006.

*dhe thekson përgjegjësini e të gjitha qeverive për të garantuar respekt të plotë të të gjitha religjioneve dhe simboleve të tyre.*<sup>181</sup>

Me pas ishte edhe Këshilli i Ligës Arabe, i cili dënoi ashpërsisht publikime të tilla dhe shprehu gjithashtu edhe habinë për qëndrimin e qeverisë Daneze. Pas një reagimi të tillë, me një kokëfortësi e cila pati për justifikim lirinë e shtypit, në fund të 2005-ës dhe fillimet e 2006-ës, mbi 70 gazeta nga 40 vende i ribotuan të njëjtat karikatura, duke kontribuar në ndezjen akoma më shumë të konfliktit. Më 26 janar të 2006-ës, Arabia Saudite dhe më pas Siria, Irani dhe Libia, tërhoqën ambasadorët e tyre nga Danimarka, ky veprim diplomatik u pasua me një bojkot masiv të produkteve daneze nga ana e myslimanëve në mbarë globin. Në datën 4 shkurt të po këtij viti, konflikti kulmoi me dhunimin dhe djegien e ambasadave të Danimarkës, Suedisë, Norvegjisë dhe Kilit në Damask. Të njëjtin fat pësuan edhe ambasadat e vendeve evropiane në Liban, Iran dhe Indonezi. Në gjithë këtë konflikt humbën jetën 139 persona dhe mbi 820 të tjerë u plagosën përgjatë përplasjeve me forcat e sigurisë së këtyre vendeve.<sup>182</sup>

Qëndrimi i Rose nuk përshtatej me këndvështrimin që kishin për botën vende si Indonezia, e cila hapur mbështeti protestat dhe bëri thirrje publike, që gazeta “Jyllands-Posten” të kërkonte të falur. Ndërkohë që Irani jo vetëm që tërhoqi ambasadorin e vet nga Danimarka, por në të njëjtën kohë nuk lejoi gazetarët danezë të futeshin në territorin e vet. Po ashtu, autoritetet iraniane shpallën hapjen e një konkursi publik për krijimin dhe më pas publikimin e karikaturave me temë holokaustin në mënyrë që, siç e quanin ata, të përcaktoheshin se ku ndodheshin vërtetë kufijtë e lirisë së shprehjes.<sup>183</sup>

Më 30 janar 2006, kryeredaktori i “Jyllands-Posten”, Carsten Juste publikisht u shfajësua për ofendimet e shkaktuara nga gazeta të cilën ai e drejtonte.<sup>184</sup> Menjëherë pasi kjo falje publike u realizua, Kryeministri i Danimarkës, Rasmussen deklaroi se karikaturat qenë keqkuptuar nga shumë myslimanë dhe qenë perceptuar si fyese nga ana e tyre, e në të

---

<sup>181</sup> [www.oic-oci.org/english/is/ex-3/fc-exsumm-en.htm](http://www.oic-oci.org/english/is/ex-3/fc-exsumm-en.htm) (vizituar më 31 mars 2013).

<sup>182</sup> [www.cartoonbodycount.com](http://www.cartoonbodycount.com) (vizituar më 31 mars 2013).

<sup>183</sup> <http://www.therevival.co.uk/forum/general/1707> (vizituar më 1 prill 2013).

<sup>184</sup> <http://www.guardian.co.uk/media/2006/jan/31/religion.saudi-arabia> (vizituar më 1 prill 2006).

62. Engebriksen Ada, “Good Governance? The Prophet Muhammad Controversy and the Norwegian Response”, *Norwegian Social Research, Nova*, 2010 fq.76

njëjtën kohë shpresonte, që falja publike e gazetës të kontribuonte në ristabilizimin dhe lehtësimin e dëmit moral të shkaktuar.

Duhet theksuar se në deklaratën e tij, Kryeministri danez, përsëri veçoi se qeveria e tij nuk mund të kërkonte falje për llogari të një gazete të pavarur dhe të lirë. Interesant është fakti se qeveria norvegjeze, jo vetëm që i kërkoj falje pothuaj të gjitha vendeve myslimane për atë çka kishte ndodhur me publikimin e karikaturave, por kërkoj edhe falje paraprake për çdo lloj publikimi fytes ndaj tyre, që mund të botohej në të ardhmen.<sup>185</sup> Në të njëjtën mënyrë veçoi edhe qeveria suedeze, e cila së bashku me atë norvegjeze, duket sikur kundërshtuan pohimin e kryeministrit danez Rasmusen, ku një qeveri nuk mund të kërkonte falje në emër të një organi të pavarur shtypi.

Shumëkush mund të ketë ngelur i habitur me faktin se si një gazetë e një vendi si Danimarka, që në vitin e publikimit të karikaturave kishte jo pak por pothuaj 9 % të popullsisë së saj me emigrantë të kulturave dhe religjioneve të ndryshme, dhe me një popullsi prej rreth 200 mijë banorësh myslimanë<sup>186</sup>, të hezitonte që me shpejtësi të mbyllte konfliktin, i cili me shumë gjasa mund të transformohej në një minë me sahat në rrafshin social për shoqërinë daneze. Të habitur mund të kenë ngelur edhe të tjerë, kur mësuam se botuesit e gazetës ishin përballur me bojkote të vazhdueshme nga artistë të ndryshëm, të cilët i ishin përgjigjur negativisht ftesave pararendëse të gazetës për të pikturuar Profetin Muhamed (a.s.) në disa libra fëmijësh për nivelet e shkollave fillore daneze. Megjithatë, insistimi i gazetës më të madhe daneze për të vazhduar me projektin e saj, lë hije dyshimi mbi atë se, duke qenë organ mbi të gjitha politik, duhej ta dinte se një sipërmarrje e tillë provokuese do të shkaktonte zemëratë publike dhe një konflikt social lidhur me pothuaj 10% të popullsisë, që edhe pse nuk ishin të gjithë myslimanë, do të përfshiheshin në kategorinë e të qenët kulturalisht ndryshe, e për pasojë viktimë të stigmatizimit, talljes dhe përçmimit.

---

<sup>186</sup> Hedetoft, U. "Denmark: integrating immigrants into a homogeneous welfare state", *Migration Information Source*. 2006. Marrë nga, <http://www.migrationinformation.org/Profiles/display.cfm?id=485> (vizituar më 1 prill 2013).



Habi mund të shkaktonte fakti se si nuk kuptohej se publikimi i karikaturave, të cilat personifikonin Profetin Muhamed (a.s.) si terrorist, mund të shkaktonte një cunam në marrëdhëniet ndërkombëtare me jo pak, por dhjetëra e dhjetëra shtete, të cilat si besim parësor të tyre kishin Islamin dhe shtyllë morale e fetare Profetin Muhamed (a.s.). Është theksuar shpesh se krahu i djathtë konservator qeverisës në Danimarkë, por jo vetëm, ka tentuar gjithmonë të radikalizojë marrëdhëniet me kulturat migratore në vend dhe si rrjedhojë, është parë nga ana e tyre se lufta kundër këtyre kulturave migratore në rritje brenda shoqërisë daneze, do të mund të bëhej më së miri duke sulmuar boshtin e këtyre kulturave të cilat zanafillojnë me religjionin.

Ndodhi pikërisht ashtu siç edhe pritej të ndodhte. Ngjarja ndau mediat e përfaqësuesit e tyre me popullsinë e thjeshtë dhe politikanët e diplomatët mes njëri-tjetrit, të cilët u vendosën në një pozicion të vështirë mes ruajtjes së balancës në marrëdhëniet sociale shtesore, si dhe popujve religjiozë të cilët përbënin një pjesë të konsiderueshme të shoqërive respektive.

Në fillim të tetorit të 2005-ës, shoqatat myslimane iu drejtuan ligjit danez dhe më saktë Kodit Penal danez dhe neneve 140 dhe 266b të tij, në të cilat thuhej se *çdo person që përbuz dhe tall doktrinat religjioze, apo aktet e adhurimit të çdo feje të njohur ligjërisht në Danimarkë, do të jetë subjekt i burgosjes së jo më shumë se 4 muajve*. Ndërsa më poshtë në nenin 266(b), thuhet se *çdo person që publikisht bën deklaram apo përhap deklarata, të cilat kërcënojnë një grup njerëzisht të tjerë lidhur me racën, ngjyrën, origjinën etnike, religjionin apo prirjen seksuale, do t'i nënshtrohet gjobitjes deri në burgosje jo më shumë se 2 vjet*.<sup>187</sup> Në fakt Prokurori i rajonit të Viborg-ut, deklaroi në vendimin e tij të 6 janarit 2006, se liria e shprehjes duhej ekzekutuar së bashku me respektin e duhur përkarshi të drejtave të tjera të njeriut, por për Prokurorin, gazetarët gëzojnë të drejta më të mëdha lidhur me interesin publik dhe për këtë arsye ai e pushoi çështjen. Kështu konflikti u la hapur pa pasur zgjidhje dhe për më tepër ky vendim inkurajoi ribotimin e këtyre karikaturave në fillimet e muajit shkurt të po atij viti nga edhe më shumë gazeta të vendeve

---

<sup>187</sup> Jakobsen Søren Sandfeld, *The Case Regarding the Danish Muhammad Drawings*, Copenhagen Business School (<http://merlin.obs.coe.int/iris/2006/8/article105.en.html>).

evropiane. Kështu, media e shkruar mori një licencë ligjore për të vazhduar më tej në thellimin e konfliktit social.

Presidenti i Komisionit Evropian asokohe më 15 shkurt të 2006-ës, Barroso, shprehej lidhur me situatën në deklaratën zyrtare të përbërë prej disa pikash <sup>188</sup>se;

*Liria e shprehjes është një liri e panegociueshme e institucioneve evropiane dhe po në të njëjtën kohë, liria e besimit të individëve si dhe komuniteteve fetare është po ashtu një liri e panegociueshme. Le të jemi të qartë, – vazhdon ai, – se opinionet e shprehura nga individët, angazhojnë vetëm ato, e për pasojë ato nuk përfaqësojnë një vend, popullsi apo religjion. Ndërkohë që myslimanët duhet të jenë të lirë të praktikojnë fenë e tyre në të njëjtën mënyrë, si çdo pjesëtar i komuniteteve të tjera fetare në territorin evropian.*

Vendet myslimane, nën ombrellën e Organizatës së Konferencës Islamike, shprehej në deklaratën tjetër të saj të 18 janarit 2006, në emër të Sekretarit të Përgjithshëm të saj, Ekmeleddin Ihsanoglu, se aktet islamofobike shkojnë përtej çdo forme të lirisë së shprehjes, apo lirisë së shtypit, duke dëmtuar parimet ndërkombëtare të etikës dhe vlerave të bazuara në deklaratat dhe rezolutat e Kombeve të Bashkuara. Liria e shprehjes duhet ushtruar në respekt të vlerave me të cilat edhe mund të mos biesh dakord, sepse thelbi i demokracisë i trupëzuar në lirinë e shprehjes nuk konsiston në lejimin e fyerjes së vlerave dhe simboleve të shenjta të të tjerëve. Aq më tepër kur kjo bëhet duke portretizuar dhe stereotipizuar myslimanët dhe profetin e tyre si injorantë, djallëzorë dhe terroristë.<sup>189</sup>

Si pasojë e kësaj situate të nderë konfliktuale në marrëdhëniet ndërkombëtare, nuk u lanë pa u bërë edhe insinuata, lidhur me aplikimin e standardeve të dyfishta nga ana e institucioneve ndërkombëtare. Nga njëra anë nuk mund të hidhej as edhe një dyshim, apo stigmatizim ndaj vuajtjeve të hebrenjve nga nazistët, dhe nga ana tjetër ofendimi ndaj Profetit të myslimanëve, etiketohej si ushtrim i lirisë së shprehjes dhe si thelb i demokracisë. Nga njëra anë kodi i etikës gazetareske promovohet si një arritje në marrëdhëniet e shtypit të lirë me ngjarjet dhe individët e një shoqërie, nga ana tjetër në rastin e karikaturave daneze, ky kod shihet si i plotësuar në të gjitha detajet e veta. Aplikimi i këtyre standardeve të ndryshme në ngjarje apo situata të cilat puqeshin për nga përmbajtja,

<sup>188</sup> [http://www.eu-un.europa.eu/articles/en/article\\_5696\\_en.htm](http://www.eu-un.europa.eu/articles/en/article_5696_en.htm) (vizituar më 3 prill 2013).

<sup>189</sup> <http://www.oic-oci.org/press/english/2006/January%202006/denmark-3.htm%3E> (vizituar më 3 prill 2013).

thelloi diferencimet kulturore në një terren evropian ku emigracioni shihej si forca motore dhe gjallëruese e një Evrope demografikisht në plakje të pakthyeshme.

Grupet e vendeve të cilat tashmë e konsideronin lirinë e shprehjes si liri e cila nuk duhet të ngrihej duke shkelur mbi truallin e shenjtërisë së të tjerëve, i bashkohet edhe Vatikani, i cili në deklaratën e vet për shtyp të 4 shkurtit 2006 shprehet se: *“Liria e shprehjes dhe mendimit e cila është një ndër të drejtat themelore të parashikuara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, nuk duhet të përmbajë të drejtën për të fyer ndjenjat fetare të besimtarëve”*.<sup>190</sup> I Dërguari Special i Komisionit të Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen ndaj formave të racizmit, ksenofobisë dhe intolerancës z. Doudou Diene, lidhur me publikimin e karikaturave nga gazetatat në përgjithësi, shprehej *se po përjetonte situatën më degraduese dhe manifestimin më serioz të islamofobisë*.<sup>191</sup> Përmasat e rënda të konfliktit i cili kaloi territoret nacionale duke u transformuar tashmë në një përplasje ndërkombëtare, jo vetëm idesh mbi mënyrën dhe konceptimin e lirisë, por edhe në përplasje të dhunshme me viktime dhe të plagosur, e tregon edhe një deklaratë e përbashkët e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Konferencës Islamike dhe të Ligës së Shteteve Arabe, zëvendës Kryeministrit dhe Ministrit të Jashtëm të Katarit, Ministrit të Jashtëm të Spanjës dhe Ministrit të Jashtëm të Turqisë, të cilët bashkërisht deklaruan se :

Si pasojë e polarizimit të tejskajshëm të situatës, qëndrimet diplomatike përmes deklaratave të përfaqësuesve të tyre ishin shpesh të kaheve të ndryshme duke ndarë qëndrimet në pro dhe kundra publikimit të karikaturave. Qëndrimi i Britanisë së Madhe në fjalët e Sekretarit për Marrëdhëniet me Jashtë Jack Straw, përmbledhej në një kërkesë publike që i bëri mediave të mos publikonin karikaturat dhe e quajti botimin e tyre nga disa media evropiane si “të pasjellshme”.<sup>192</sup> Po ashtu gazeta daneze “Politiken” i bën një kritikë të fortë “Jyllands-Posten” dhe zbulon një fakt interesant në të cilin, “Jyllands” kishte refuzuar publikimin e karikaturave mbi “ringjalljen e Krishtit” dy vite më parë, më 2003-in, me justifikimin se këto mund të perceptoheshin si fyese dhe “nuk ishin aspak për të

<sup>190</sup> Deklaratë per Shtyp e Selisë së Shenjtë, 4 shkurt 2006, [www.vatican.va/news\\_services/index\\_news.htm](http://www.vatican.va/news_services/index_news.htm)

<sup>191</sup> UN Doc. E/CN.4/2006/17, 13 February 2006, paragraf. 23-28.

<sup>192</sup> [http://news.bbc.co.uk/2/hi/uk\\_news/4676524.stm](http://news.bbc.co.uk/2/hi/uk_news/4676524.stm) (vizituar më 4 prill 2013).

qeshur”.<sup>193</sup> Më 5 shkurt 2006 Ministri i Transportit të Irakut ngrin të gjitha kontratat me Danimarkën dhe Norvegjinë, ndërkohë që kompania daneze “Arla Foods” raporton miliona euro humbje si pasojë e bojkotit të bërë nga myslimanët ndaj produkteve të saj. Irani po ashtu ndaloi të gjitha marrëdhëniet tregtare me Danimarkën duke prishur marrëveshjet që kishte me Unionin Evropian. Po në fillim të shkurtit 2006, mijëra myslimanë mblidhen në Bruksel duke organizuar një protestë paqësore kundër botimit të karikaturave.

Konferenca Evropiane e Rabinëve hebre në të njëjtën ditë, shpreh pakënaqësinë e saj lidhur me publikimin e karikaturave të cilat nënçmojnë ndjenjat e myslimanëve dhe bënë përngjasimin e tyre me karikaturat antisemite.<sup>194</sup> Mbi një mijë protestues marshuan për orë të tëra në Paris si kundërpërgjigje e publikimit të “Jyllands-Posten”. Kryeministri francez asokohe, Dominique de Villepin, dënoi dhunën e ushtruar dhe bëri thirrje për njohje të së drejtës ndaj besimeve, tolerancë dhe respekt ndaj tyre. Kriza dhe ndikimet e saj u demonstruan deri në atë pikë sa Ministri i Jashtëm i Danimarkës në fillimet e shkurtit të 2006-ës, i bënte thirrje qytetarëve danezë të mos shpenzonin pushimet e tyre në vende si Emiratet e Bashkuara, Katar, Bahrein, Egjipt, Marok, Tunizi, Libi, Oman, Jordani etj., duke i shkaktuar një dëm kolosal financiar bashkëqytetarëve të vet. Po e njëjta Ministri lëshonte rekomandime për shoqëritë ajrore daneze të anulonin fluturimet drejt Egjiptit. Kryeministri Britanik Tony Blair dhe Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jaap de Hoop Scheffer, shprehën solidaritetin e tyre me Danimarkën në lidhje me djegien e ambasadave të tyre në shtetet myslimane.<sup>195</sup> Terri Davis, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës u deklarua se publikimi i karikaturave kaloi kufirin etik edhe pse ishte korrekt ligjërisht.

Në Filipine, në kryeqytetin Manila, u mbajtën protesta përballë ambasadës daneze në kundërshti të publikimit të karikaturave. Ndërsa për Humans Right Watch, një NGO mbi monitorimin e të drejtave të njeriut, në mënyrë ironike e shpalli publikimin e karikaturave daneze si rastin kampion të lirisë së shprehjes.<sup>196</sup> Me mijëra myslimanë protestuan në një marshim në Hong Kong duke kundërshtuar publikimin në mediat e shkruara të karikaturave

---

<sup>193</sup> “The Guardian”, “*Danish paper rejected Jesus cartoons*”, 6 shkurt 2006.

<sup>194</sup> Conference of European Rabbis, “*The right to satirise is not the right to injure or humiliate*”. Press release. 5 February 2006.

<sup>195</sup> Danmarks Radio, “*Blair supports Denmark*”, 6 February 2006.

<sup>196</sup> Human Rights Watch, “*Questions and Answers on the Danish Cartoons and Freedom of Expression*”, 15 shkurt 2006.

në fjalë. Duke parë zhvillimet e vullshme dhe konfliktuale, kreu i Kishës Katolike, Papa Benedikti i XVI, bëri thirrje për respektimin e religjioneve botërore dhe shmangien e nëpërkëmbjes së ndjenjave fetare të besimtarëve.<sup>197</sup> Situata vazhdoi të tensionohej përsëri kur Partia Nacionale Britanike, një fraksion i ekstremit të djathtë, pas demonstratave të dhunshme në Londër, vendosi t'i botonte karikaturat ndaj Profetit Muhamed (a.s.) në faqen e vet zyrtare on-line. Ky veprim elektrizoi situatën politike në Britani e cila u pasua me një reagim kritik të menjëhershëm nga i gjithë spektri politik britanik.<sup>198</sup> Në ditët në vijim mbi 125 veta u vranë në Nigeri në përplasjet mes myslimanëve dhe të krishterëve lidhur me këto publikime të karikaturave, ndërkohë që rreth 30.000 veta protestuan në Karachi të Pakistanit duke hedhur parulla kundër blasfemisë, kundër Amerikës dhe vendeve evropiane. Më 3 mars të 2006-ës, shoqatat dhe organizatat myslimane me bazë në Danimarkë hartuan një ankesë zyrtare drejtuar Komisionit për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara lidhur me gazetën daneze si shkaktare e situatës dhe degradimit të saj.<sup>199</sup> Tre javë më vonë, Ministrja e Punëve të Jashtme të Suedisë, Laila Freivalds jep dorëheqjen nga posti i saj, e akuzuar së po pengonte publikimin e karikaturave në një faqe on-line, e si pasojë ky veprim i saj u interpretua si ndërhyrje në lirinë e shtypit nga mediat vendase të cilat i bënë presion për dorëheqje. Pothuajse në të njëjtën kohë, pasuesi i saj Ministri i ri i Jashtëm i Suedisë së asaj kohe Carin Jamtin, nuk u lejua të hynte ne Darfur të Sudanit për një vizitë zyrtare duke u shpallur person “non grata” për arsye të përfshirjes suedeze në publikimin e karikaturave.

Në mars të vitit 2007, vendet myslimane lobuan për hartimin e një rezolute në Këshillin e të Drejtave të Njeriut pranë Kombeve të Bashkuara, thelbi i së cilës ishte të ndalonte përdhosjen e religjionit.<sup>200</sup> Pas një qetësie relative, situata filloi përsëri të turbullohej kur në shkurt të 2008-ës, tre persona me shtetësi të huaj planifikuan të vrisnin autorin e karikaturave Kurt Westergaard. Menjëherë pas kapjes nga policia vendase të tre personave, për të cilët nuk u vërtetua kurrë se kishin planifikuar ndonjë aksion, të gjitha

---

<sup>197</sup> <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/4734454.stm> (vizituar më 5 prill 2013)  
<sup>198</sup> CBS News, “*Pakistan Police: 25,000 Protest Cartoons*”, 26 shkurt 2006.

<sup>199</sup> “The Guardian”; Day, Julia “*Danish paper threatened with legal action*”. Londër, 17 mars 2006.

<sup>200</sup> “Der Spiegel”, 30 mars 2007.

mediat e shkruara daneze i ripublikuan edhe një herë karikaturat<sup>201</sup>. Kjo shkaktoi trazira përsëri në Danimarkë të cilat u pasuan me djegie të makinave në rrugë dhe të disa objekteve. Protesta u konsiderua e dhunshme edhe për faktin se tre të dyshuarit u deportuan në vendet e origjinës pa bërë një proces gjyqësor ndaj tyre. Në të njëjtën kohë, Egjipti ndaloi shpërndarjen e gazetave “Wall Street Journal” dhe “The Observer” të cilat i ribotuan përsëri këto karikatura. Ndasitë që shkaktoi ngjarja në fjalë nuk ngelën pa prekur edhe botën ndërkombëtare akademike. Universiteti i famshëm i Yale dhe shtëpia botuese e saj “Yale University Press”, në gusht të vitit 2009, teksa kishte pranuar të botonte librin e profesorit Jytte Klaussen me titull “The Cartoon that Shook the World” (“Karikaturat që Tronditën Botën”), me vendim të bordit të vet të profesorëve, hoqën të gjitha karikaturat dhe ilustrimet e tjera të këtij libri dhe e botuan librin pa to.<sup>202</sup> Në krahun tjetër të botës akademike, Kancelarja gjermane Angela Merkel, në shtator të 2010-ës nderon me çmimin M100 të medias autorin më të spikatur të karikaturave Kurt Westergaard për, ashtu siç e konsideronte ajo, kurajën e tij për të mbrojtur vlerat demokratike.<sup>203</sup> Ndërkohë që në tetor të po këtij viti Ministrja e Jashtme e Danimarkës Lene Espersen, gjatë një takimi në Kajro me Kryemyftiun e Universitetit të Al-Az-harit deklaronte se lëndimi i shkaktuar myslimanëve nga publikimi e ripublikimi i karikaturave kundër Profetit Muhamed (a.s.), ishte shumë i madh dhe se Danimarka nuk kishte pasur si qëllim të lëndonte ndjenjat e askujt.<sup>204</sup> Në dhjetor të 2010-ës bomba e quajtur “Wikileaks” ndër të tjera tregon edhe për korrespondencën dhe veprimet diplomatike që Ambasadori i asaj kohe i Shteteve të Bashkuara në Danimarkë, James Cain, kishte bërë me autoritetet daneze. Në këtë kabllogram flitet për ndërhyrjen e Ambasadorit Cain tek autoritetet daneze për të ndalur tentativën e gazetës “Jyllands-Posten” e cila kishte vendosur që në shtator të 2006-ës, të ribotonte karikaturat me rastin e një vjetorit të konfliktit.<sup>205</sup>

---

<sup>201</sup> BBC News. 14 shkurt 2008.

<sup>202</sup> Cohen, Patricia “Yale Press Bans Images of Muhammad in New Book”. “New York Times”. 13 gusht 2009.

<sup>203</sup> BBC News; “Merkel honours Danish Muhammad cartoonist Westergaard”. 8 shtator 2010.

<sup>204</sup> <http://jyllands-posten.dk/international/article4388323.ece> (vizituar më 6 prill 2013).

<sup>205</sup> Aftenposten; “Cartoon anniversary: Danish paper decides against reprinting Mohammed drawings”. 28 dhjetor 2010.

Në 2012 një person i quajtur Nakoula Basseley Nakoula, që më vonë përdori pseudonimin Sam Bacile, postoi përmes rrjetit të videove Youtube, një filmim prej 13 minutash të titulluar fillimisht “The Real Life of Muhammad”, dhe një ditë më pas të transformuar në “Muhammad Movie Trailer”. Më vonë përfundimisht kjo video e shkurtër amatoreske u titullua “Innocence of Muslims” (Pafajësia e Myslimanëve). Ky segment i cili nuk kishte as atributet e një filmi, fillonte me një sekuencë të ditëve të sotme ku paraqitet policia egjiptiane e cila bën sehir ndërkohë që një grup myslimanësh po shkatërronin pronat dhe shtëpitë e disa kooptëve të krishterë egjiptianë. Nga e tashmja ky filmim kthehet në të shkuarën, duke përçmuar me një gjuhë primitive dhe duke pështjelluar thënie nga disa libra të shenjtë, paraqet një aktor në rolin e Profetit Muhamed (a.s.) i cili përfshihet në skena të ulëta. Po ashtu paraqitet i njëjti person duke folur me një gomar si dhe disa personifikime myslimanësh të cilët me shpatë ulërijnë për gjak. Ky filmim ishte bërë duke përdorur sfondin e një filmi tjetër dhe për më tepër aktorët, të cilët ishin zakonisht aktorë filmash pornografikë, ishin të dubluar duke mos e ditur se për çfarë qëllimi do të përdorej më vonë filmi që ato po luanin. Nakoula kishte përdorur regjisorin Alan Roberts dhe stafin e tij për të xhiruar një film të titulluar “Desert Warrior” që supozohej se do të shfaqej në vitin 2011. Në këtë projekt me Roberts nuk flitej fare për tematikë fetare dhe as që nuk kanë qenë të supozuar që të përdorej asgjë nga feja islame.<sup>206</sup> Sam Bacile preu pjesë nga projekti i mëhershëm me Roberts, dubloi aktorët të cilët kishin luajtur për një tjetër skenar dhe i dha formë një produkti mizerabël për nga ana artistike dhe profesionale. Fillimisht Bacile u deklarua se ishte hebre, por autoritetet izraelite konfirmuan se në bazë të kërkimeve të tyre nuk rezultonte asnjë person me një emër të tillë të ketë shtetësinë izraelite as edhe besimin hebre. Një nga mbështetësit kryesorë të realizimit të filmit dhe bashkëpunëtori më i ngushtë i Bacile-s në këtë sipërmarrje ishte edhe pastori Terry Jones, i njohur si personi i cili dogji Kuranin në kishën e tij publikisht.<sup>207</sup> Jones ishte një ndër iniciatorët që kjo video të shfaqej fillimisht në Florida dhe më pas në disa vënie në skenë private mes një grupit të reduktuar

---

<sup>206</sup> <http://gawker.com/5942748/it-makes-me-sick-actress-in-muhammed-movie-says-she-was-deceived-had-no-idea-it-was-about-islam> (vizituar më 8 prill 2013).

<sup>207</sup> [http://articles.orlandosentinel.com/2012-09-12/news/os-terry-jones-movie-embassy-bombing-20120912\\_1\\_florida-pastor-islam-protests](http://articles.orlandosentinel.com/2012-09-12/news/os-terry-jones-movie-embassy-bombing-20120912_1_florida-pastor-islam-protests) (vizituar më 8 prill 2013).

njerëzish. Më pas kjo video u përkthye edhe në gjuhën arabe dhe në fillim të korrikut 2012 u postua në internet në Youtube.

Kësaj radhe provokimi ishte jo në formën e karikaturave, por të një filmimi të shkurtër të postuar elektronikisht dhe jo i botuar në gazeta siç ndodhi me karikaturat e vitit 2005. Ashtu siç edhe pritej reagimi u përhap ndërkombëtarisht duke përfshirë të gjitha vendet myslimane si dhe vendet ku myslimanët jetonin si komunitet. Meqenëse filmimi kësaj radhe zanafilloi në Shtetet e Bashkuara, edhe protestat e myslimanëve atje u përhapën në shumë qytete nga Washington D. C. , Filadelfia, Çikago, New York City e deri në Canton. Më 15 shtator 2012 rreth 2000 veta demonstruan pranë Shtëpisë së Bardhë në Washington. Po ashtu më 22 shtator mbi 1.500 veta protestuan para konsullatës së Sh.B.A-ve në Toronto në Kanada. Protesta pati edhe në Brazil, në Rio de Janeiro, në Sao Paulo, kryesisht nga myslimanë me banim atje. Në Paris, po më 15 shtator pati mbi 100 të arrestuar nga protestat që u mbajtën para Ambasadës së Shteteve të Bashkuara atje.<sup>208</sup> Në Gjermani pati protesta në mijëra vetë në Dortmund e Freiburg. Me mijëra të tjerë protestuan para Ambasadës Amerikane në Romë. Në Holandë politikani i ekstremit të djathtë Gert Wilders futi linkun e videos së Sam Bacile në faqen e tij zyrtare dhe në faqen zyrtare të partisë së tij “Party of Freedom” me justifikimin e mbrojtjes së lirisë së shprehjes. Pas këtij veprimi pati protesta në Amsterdam por edhe në Danimarkë në Kopenhagen.<sup>209</sup> Mijëra të tjerë protestuan në Oslo të Norvegjisë gjithashtu. Ndërsa Rusia planifikoi të bllokonte aksesin në Youtube nëse Google nuk e bënte atë shpejt. Ndërkohë Ministria e Transportit dhe Komunikimit në Turqi, duke respektuar një vendim gjykatë në lidhje me këtë çështje, bllokoi hyrjen për tek Youtube. Kryeministri Rexhep Tajip Erdoan u shpreh se: “Protesta ligjore dhe paqësore nga ana e myslimanëve është një veprim korrekt, por protestuesit nuk duhet të shfaqin asnjë lloj dhune apo terrori”<sup>210</sup>. Në Britani protesta pati pothuaj në të gjitha qytetet kryesore ku veçohen ato të Londrës, Birmingemit, Kardifit etj., të cilat u zhvilluan kryesisht para Ambasadave apo konsullatave amerikane atje. Në

---

<sup>208</sup> Press TV; “Rally against anti-Islam film held in front of White House”, 07 tetor 2012.

<sup>209</sup> Volkskrant.nl; “*Geert Wilders: ‘Publiceren en linken anti-islamfilmje’ – Binnenland – VK*”. 17 shtator 2012

<sup>210</sup> <http://www.hurriyetdailynews.com/pm-warns-muslims-of-provocation-over-film.aspx?pageID=238&nID=30196&NewsCatID=338> ( vizituar më 8 prill 2013)



Pakistan protestat përfshinë Islamabadin, Karaçin, Lahoren, Peshavarin ku mijëra vetë protestuan dhe u përplasen me forcat e sigurisë së Ambasadës së SH.B.A-ve. Harta e revoltës dhe protestave u shtri në Afganistan, Bangladesh, Kinë ku mbi 3.000 protestues demonstuan në rrugët e Hong Kongut, në Indi, Nigeri, Johannesburg, Kenia, Indonezi. Në Japoni, në Tokio mbi 200 veta protestuan për filmin anti-mysliman, po ashtu edhe në Malajzi, Filipine, Singapor, Tajlandë, Irlandë, Greqi, Norvegji, Zvicër, Ukrainë.

Në vendet e Lindjes së Mesme dhe vendet arabe protestat ishin më intensive. Në Egjipt, protestuesit për ditë me radhë në shtator të 2012-ës, demonstuan para Ambasadës Amerikane në Kajro. Qeveria e Egjiptit i kërkoi Interpolit mandat arresti për 8 personat që kontribuuan në hartimin e filmit, përfshirë edhe pastorin Terri Jones, me akuzën e dëmtimit të unitetit të kombit dhe shpifje ndaj fesë islame. Në Iran protestuesit u mblodhën para Ambasadës së Zvicrës e cila mbulon përfaqësinë e Shteteve të Bashkuara në Teheran. Policia iraniane arriti të zmburste turmën duke mos shkaktuar incidente. Në Irak pati protesta në qytetet e Basrës, Sadr City, Naxhaf etj. Në Jordani mbi 1500 veta u mblodhën në qendër të kryeqytetit Aman, ndërkohë që e njëjta gjë ndodhi edhe në Liban në Bejrut. Në kryeqytetin e Kuvajtit në Kuvajt City, qindra protestues u mblodhën para Ambasadës Amerikane atje. Protestat u shtrinë në Marok në Kazablanka dhe Sale me të njëjtin motivacion. Në Palestinë u bënë protesta në Rripin e Gazës dhe në Nablus. Mbi 2.000 veta marshuan në Doha në kryeqytetin e Katarit drejt Ambasadës Amerikane për të denoncuar publikimin e videos anti-islame. Ndërsa në Emiratet e Bashkuara Arabe, Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit bllokoi hyrjen për në Youtube me justifikimin e tejkalimit dhe dhunimit të normativave kulturore.<sup>211</sup> Në Konsullatën e Shteteve të Bashkuara në Sidnej, mbi 500 veta u mblodhën më 15 shtator 2012 për të protestuar kundër filmit. Në këtë protestë pati përplasje me policinë e cila përdori gaz lotsjellës dhe mjete të tjera për të shpërndarë turmën. Nga përplasja pati gjashtë policë të plagosur, dhjetëra protestues gjithashtu. Në Izrael pati protesta në Tel-Aviv dhe Jeruzalem. Protestuesit u mblodhën para Ambasadës së SH.B.A-ve atje duke hedhur parulla anti amerikane. Më 2 tetor një grup izraelitësh mblidhen para Ambasadës Amerikanë në Tel-

---

<sup>211</sup> <http://gulfnews.com/news/gulf/uae/general/telecommunication-authority-orders-to-block-anti-islam-video-1.1077828> (vizituar më 8 prill 2013)

Aviv për të demonstruar mbështetjen e tyre ndaj amerikanëve dhe trupës së tyre diplomatike.<sup>212</sup>

Një ngjarje e cila ia vlen të ndalesh dhe që është e lidhur me rastin e videos së Sam Bacile, është ngjarja e Benghazi. Ashtu si edhe në vendet e tjera, në Libi në kryeqytetin e saj në Tripoli, por edhe në qendrën tjetër të madhe të saj në Benghazi, kishin filluar protestat popullore kundër publikimit dhe shpërndarjes së videos në fjalë. Më 11 shtator 2012, Konsullata Amerikane në këtë qytet, sulmohet nga një grup paramilitar, të cilët arritën të vrisnin 4 punonjës sigurie si dhe Ambasadorin Amerikan në Libi, Christopher Stevens, i cili ndodhej në një vizitë në konsullatën e Benghazi. <sup>213</sup> Dhjetë ditë më vonë pasi kjo ngjarje tronditi botën dhe i dha tjetër domethënie protestave, më 21 shtator 2012 mbi 30 mijë qytetarë libianë marshuan në rrugët e Benghazi duke mbajtur parulla në të cilat kërkonin drejtësi për vrasjen e ambasadorit. Turma iu drejtua zyrave të grupeve paramilitare që ishin formuar që nga koha e luftës ndaj ish-diktatorit Kadafi dhe u përlesh me to. Si pasojë e kësaj përplasjeje dhjetë vetë u vranë dhe dhjetëra të tjerë u plagosën. Ditën tjetër banorët e Benghazi arritën të largonin forcat paramilitare nga qyteti dhe e gjithë logjistika e tyre iu dorëzua Ushtrisë Kombëtare të Libisë.

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Barak Obama deklarohet kundra denigrimit të besimeve fetare dhe kundra akteve të dhunës. Ndërkohë që Kryeministri i Egjiptit Hisham Kandili, deklaroi se ajo çka ndodhi në Ambasadën Amerikane në Kajro është e papranueshme dhe e refuzuar nga populli egjiptian duke marrë parasysh edhe faktin që këta njerëz që prodhuan filmin nuk kanë të bëjnë aspak me qeverinë amerikane.<sup>214</sup> Kryeministri Libian Mustafa Abushagur, dënoi fuqimisht aktin e dhunës dhe vrasjen e të pafajshmëve në Benghazi. Këshilli Amerikan për Marrëdhëniet Islame (CAIR) dënoi aktin e dhunës në Benghazi dhe shprehej se ata që e bënë këtë ranë në kurthin e atyre që prodhuan filmin. Të gjitha vendet evropiane po ashtu edhe vendet myslimane dënuan aktin e vrasjes së Ambasadorit amerikan në Benghazi natën e 11 shtatorit 2012. Byroja Federale e

---

<sup>212</sup> Ziri, Danielle; "After Arab embassy hits, Israelis hold pro-US rally". *The Jerusalem Post*, 2 tetor 2012.

<sup>213</sup> [53]. Lt. Colonel Tony Shaffer; "To live and die in Benghazi, Libya without leadership from America". *Fox News*. 30 tetor 2012.

<sup>214</sup> Reuters; "US ambassador to Libya killed in Benghazi attack", 12 shtator 2012.

Investigimeve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (FBI), e mbikëqyri Nakoulën për arsye të shndërrimit të tij tashmë në një rrezik me potenciale të mëdha në të gjithë globin. Më 27 shtator 2012, FBI e arrestoi atë në Los Angeles me akuzën e përdorimit të identitetit të rremë në një produksion filmik dhe më pas me akuza të tjera për mashtrime të shumta financiare që ai kishte bërë ndaj shtetit dhe institucioneve private amerikane.

Dobia më e madhe e gjithë këtyre ngjarjeve të cilat u shtrinë në kohë, nuk ishin vetë karikaturat apo filmimet si punime, as edhe aksioni mediatik që i shoqëroi ato, por ishte debati i madh që u hap në lidhje me sjelljen që duhej t'i atribuohet lirisë së shprehjes kur ajo përballëj me një liri tjetër shumë thelbësore të të njëjtit subjekt siç është njeriu, atë të lirisë së besimit. Kjo ngjarje tregoi në shkallë globale se parametrat me të cilat shoqëria njerëzore është ndërtuar, kanë nevojë herë pas here të korrigjohen në drejtim të të kuptuarit të qenët ndryshe të tjetrit.

Debati i cili u përhap në të gjithë globin, përfshiu shumë rrafshë të sferës sociale. Ngjarja shtroi pikëpyetje të forta mbi të kuptuarit së pari të kontekstit ligjor dhe konstitucional të konceptit të lirisë së jashtme të shoqërisë me lirinë e brendshme të ndërgjegjes së individit. Hapi debatin nëse do të duhej të modifikohet liria e shprehjes në një botë tashmë të re, ku qasja religjioze po fitonte terren gjithnjë e më tepër. Krijoi perceptimin se masat ligjore ndaj fyerjes dhe *“hate speech”* nuk ishin të mjaftueshme dhe nuk përfaqësonin sensibilitetet e shtresave sociale si dhe ishin të ndryshme në vende të ndryshme. Nxori si domosdoshmëri ripërcaktimin e kufijve të lirisë së shprehjes duke e shtrirë atë përtej kufizime social-politike dhe racore, drejt një dimensionit më religjioz dhe përcaktoi kufirin ndarës mes konceptit klasik dhe modern të lirisë së shprehjes.

Ajo çka ndodhi, nuk ishte gjë tjetër veçse paaftësia e të kuptuarit dhe të interpretuarit të tjetrit kulturalisht. Prodhimi i vazhdueshëm i industrisë së frikës që zgjerohet gjithnjë e më shumë, pasurohet përmes kanaleve të komunikimit në dhjetëra forma të ndërlikuara. Të gjitha këto forma kontribuojnë në ndarjen e madhe sociale, ku nga njëra anë demokracia liberale, arsyeja, laicizmi apo edhe sekularizmi, projektohen si vlera të bashkëngjitura Perëndimit, dhe nga ana tjetër religjioni, autoritarizmi, tirania si anë e kundërt e përparimit dhe progresit, perceptohen të bashkëngjitura Islamit. Kjo ndarje e nënkuptuar e cila gjallon në atmosferën mediatike ka kontribuar dhe kontribuon në prodhimin e konflikteve të mëdha

qytetërimore. Një bashkëjetesë brenda një planeti e cila aktualizohet mbi bazë keqkuptimi, domosdoshmërisht që e ka jetën e shkurtër. Ngjarje të tilla të kësaj natyre, nuk mundet asesi të mos ushqejnë dhe thellojnë këtë ndasi. Kur shoqëria përballet me konflikte të këtyre përmasave siç ishin edhe ato të shkaktuara nga portretizimi i simboleve të fesë përmes zhanresh përçmuese, atëherë përplasja nuk ngelet vetëm në këndvështrimin social, por shtrihet edhe më tej duke formuar një zonë gri juridike mes të drejtash të cilat shoqëritë moderne ia kanë lejuar sot vetes. Kjo zonë gri, që shtrihet mes lirisë së shprehjes dhe të drejtës për të mos qenë i dëmtuar nga kjo liri e shprehjes, qëndron e pa mbuluar me një shpjegim të qartë juridik. Nga njëra anë kemi retorikën mediatike lidhur me karikaturat dhe filmimet denigruese e blasfemuese, e cila tërësisht mbështetet mbi principin e të drejtës liberale, dhe nga ana tjetër kemi popullsi të tëra besimtarësh identitarë myslimanë, që të drejtën e shohin të bazuar tek principi i dëmit të shkaktuar. Nëse juridikisht do të anohet vetëm drejt njërit prej këtyre dy qëndrimeve atëherë do të legalizojmë një koncept të pjesshëm të liberalizmit, pluralizmit dhe tolerancës.

## KAPITULLI VI

### PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

#### Përfundime

- Qeveria e Shtetit të parë Shqiptar, (qeveria e Ismail Qemalit e vitit 1912) reflektoi një gjithpërfshirje të balancuar të komuniteteve fetare në vend, madje në nivele shumë të larta.
- Përfaqësuesit e Klerit fetar në Shqipëri me veprime konkrete, mbështetën pavarësinë e vendit dhe përçuan mesazhe bashkëpunimi.
- Për shkak të popullsisë kryesisht muslimane, impakti i ligjërimit fetar të klerit musliman ishte i gjërë, i fortë dhe shumë ndikues.
- Konstatohet lehtësisht se ligjërimi fetar i bërë nga përfaqësuesit e klerit musliman në të gjitha nivelet, përcon mesazhin e tolerancës, harmonisë dhe bashkëjetesës fetare në vend.
- Kleri musliman shqiptar në mënyrë të vendosur, ndoqi të njëjtën rrugë atë të mëvetësisë nga Komuniteti musliman turk duke krijuar kështu premisat që të ketë fizionominë e vet dhe të zhvillojë tiparet e veta.
- Është fakt që përfaqësuesit e klerit fetar në vend , në mënyrë të qartë dhe lehtësisht të identifikueshme kanë bashkëpunuar kur bëhej fjalë për çështje kombëtare.
- Ligjërimet fetare të cdo besimi kanë evidentuar klerikë muslimanë dhe të krishterë të cilët përveç përkatësisë së tyre fetare, ishin atdhetarë dhe nacionalistë të mirëfilltë.
- Toleranca, harmonia dhe bashkëjetesa ndërfitare në vendin tonë, është një tipar që nuk ka cënuar zhvillimin e besimeve fetare në rrugën e tyre në Shqipëri edhe në fazat me rixhide të tyre.
- Përfaqësuesit e klerit fetar në Shqipëri , kanë patur nivel shkollimi, në përgjithësi më të lartë se ai i popullsisë dhe ky nivel i tyre në shumicën e rasteve, është përdorur në interes të kombit shqiptar në mënyrën më të pjekur të mundshme.
- Përpjekjet e bëra në periudhën e mbretit Zog që të krijohet një shtet shqiptar laik

dhe që tu krijonte hapësirë besimeve të zhvilloheshin në rrugën normale të tyre, shënon një arritje të madhe.

- Toleranca dhe harmonia ndërfetare në Shqipëri është tipar që rrjedh nga pranimi i diversitetit, respekti për përkatësinë e besimeve dhe respekti për vlerat, historinë dhe përpjekjet e sakrificat e çdo komuniteti fetar .
- Ligjërimet e pasqyruara në organet fetare të kësaj periudhe 1913-1944, vënë në dukje se teologët e të gjitha besimeve kanë dhënë kontributin e tyre të çmuar në shpalljen e pavarësisë.
- Ligjërimet fetare të analizuara përmes botimeve periodike institucionale pa dyshim kanë ndihmuar që në mes shqiptarëve të mos ekzistojnë ndjenja urrejtjeje apo fobie ndaj anëtarëve të besimeve të ndryshme, vlerë kjo për të cilën krenohemi të gjithë.

### **Rekomandime**

Toleranca, harmonia dhe bashkëjetesa ndërfetare në Shqipëri, është një tipar lehtësisht i evidentueshëm dhe si i tillë duhet studiuar, njohur, ruajtur dhe zhvilluar më tej.

- Për të kuptuar më mirë shkaqet se nga buron kjo tolerancë dhe harmoni, është e nevojshme që të ketë studime të thelluara për periudha të veçanta të historisë së besimeve dhe të fokusohemi dhe në vetë ligjërimet e klerit fetar, pasi aty do të mund të ekstraktohet esenca e qëndrimeve të tyre.
- Rekomandojmë që objekt studimi të jetë periudha 1945-1967 dhe gjithashtu edhe periudha 1990- 2015.
- Rekomandojmë që objekt studimi të jetë edhe ligjërimi I klerit katolik dhe atij ortodoks për të njëjtat periudha.
- Rekomandojmë që përmes praktikave të ligjërimet fetar të influencohet në përcjelljen e lidhjes mes brezave dhe transmetimin e tipareve karakteristike që ka besimi në Shqipëri, të lidhura me ato nacionale, duke qëndruar larg ndikimeve të huaja aspak të përshtatshme për vendin tonë.
- Rekomandojmë përfshirjen në kurrikulën arsimore në të gjitha nivelet të lëndëve të edukatës religjioze, me zgjedhje, duke zgjedhur si model atë anglez ose nordik.

- Ekzistenca e një shteti laik , që krijon mundësinë e zhvillimit të besimeve pa cënuar lirinë e tyre, do të krijonte një mundësi që ky tipar të ruhet dhe të zhvillohet edhe në të ardhmen.
- Rekomandohet një kujdes i vecantë nga ana e politikëbërjes në mënyrë që të mos ngatërrohet koncepti i *shtetit laik* me atë *ateist*.
- Për besimtarët e çdo besimi, duhet të pranohet që koncepti i epërsisë shkon në kundërshtim me tolerancën dhe dëmton bashkëjetesën ndërfetare.
- Roli i ligjërimit fetar mbetet akoma një armë shumë e fuqishme në përcjelljen e mesazhit të tolerancës, harmonisë dhe bashkëjetesës ndërfetare në vend.
- Rekomandohet krijimi i infrastrukturës institucionale dhe ligjore në mënyrë që ushtrimi i lirive të besimit të jetë i garantuar.

## Literatura

1. Abbott, A. (2001), *Chaos of Disciplines* (Chicago: University of Chicago Press).
2. Abbott, A. (2002), 'The Disciplines and the Future', in S. Brint (ed.), *The Future of the City of Intellect: The Changing American University* (Stanford CA: Stanford University Press).
3. Adler, E. (1997), 'Seizing the Middle Ground Constructivism in World Politics', *European Journal of International Relations*, 3/3: 319-63.
4. Adorno, T. and Horkheimer, M. (1972), *The Dialectic of Enlightenment* (New York: Herder).
5. Al-Attas, S. (1993). *Islam and Secularism*. Kuala Lumpur: Art Printing Works Sdn. Bhd.
6. Anzuldua, G. (1999), *Borderlands/La Frontiera*, 2nd edn (San Francisco: Aunt Lute Books).
7. Bobi, Gani (2011). *Interesi publik dhe religjioni*.
8. Michael Barnett, "Social Constructivism", në John Baylis dhe Steve Smith, eds., *The Globalization of World Politics*, 3<sup>rd</sup> ed. (Oxford: Oxford University Press).
9. Dervishi, Kastriot; *Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005*; Shtëpia botuese 55, Tiranë 2006
10. Dibra, Haxhi Vehbi; *Ç'urdhëron Kur'ani*; Komuniteti Musliman Shqiptar, Tiranë 2014
11. Duka, Ferit; "Sfondi historik i tolerancës fetare në Shqipëri", Simpozium ndërkombëtar 'Këndëvështrimi i diversitetit fetar, kulturor dhe shoqëror në Ballkan nga prespektiva globale", 25-26 Mars 2011 në Tiranë; Botim i PRIZMI, Tiranë 2012
12. Edith Durham; *Brenga e Ballkanit*; Tiranë 1991.
13. Fallmerayer, J. Ph. (2003). *Elementi shqiptar në Greqi*. Tiranë: Saraçi.
14. Feja Laiciteti dhe Hapësira Publike në Shqipëri. <http://www.fes-tirana.org/>
15. Fevziu, Blendi; *100 vjet-një ekskursion në politikën e shtetit shqiptar nga 1912-2012*; UET-PRESS, Tiranë 2012
16. Fierke, K. M. dhe Jorgensen, Knud Erik (2001), "Constructing International Relations: The Next Generation", Armonk NY: M. E. Sharpe. Libri pasqyron një dialog transatlantik mbi domethënien e konstruktivizmit.
17. Finnemore, Martha (1996), "National Interests and International Society", Ithaca NY: Cornell University Press. Një hulumtim i rolit të normave në marrëdhëniet ndërkombëtare
18. Fishta, Gjergj; *Lahuta e Malcis*; Uegen, Tiranë 2010
19. Fustel de Coulanges (1927), p. 256.



20. Frasheri, Kristo; *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë 28 nëntor 1912*; Akademia e Shkencave, Tiranë 2008
21. Foucault, Michel (1972) *The Archaeology of Knowledge and the Discourse on Language*. USA: New York: Tavistock Publications Ltd.
22. Fuga, Artan (2010). *Rrugë drejt dialogut ndërjetar në Shqipëri; Studime, Reflektime: Aspekte filozofike të dialogut ndërjetar*. Tiranë: Fondacioni "Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrveshjeve".
23. Gellner, E. (1998). *Nationalism*. London: Phoenix.
24. Gripshi, Genc; *Historia e Peqinit*; Reklama, Tiranë, 2014,
25. Grup autorësh; *ENCIKLOPEDI – 100 Personalitete shqiptare të kulturës Islame gjatë shek. XIX – XX*; KMSH, Tiranë 2012
26. Grup autorësh; *Fjalor i shqipes së sotme*; botimi i parë nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë 1984; ribotim nga Toena, Tiranë 2002
27. Grup autorësh; *Historia e popullit shqiptar III (periudha e Pavarësisë 1912-1939)*; Toena, Tiranë 2007
28. Katzenstein, Peter (1996), “*The Culture of National Security: Norms and Identity in World Politics*”, Nju Jork: Columbia University Press. Një koleksion i edituar i një game të gjerë studimesh empirike që aplikojnë një analizë konstruktiviste.
29. Kotherja, Hyqmet; *Pavarësia e Elbasanit 1912*; Dy Lindje Dy Perëndime, Tiranë 2012
30. Kraja, Hafiz Ali; *A duhet feja, a e pengon bashkimin kombëtar?*; Botim i parë në vitin 1934; Komuniteti Musliman Shqiptar, Tiranë 2010
31. Kratochwil, Friedrich (1989), “*Rules, Norms and Decisions: On the Conditions of Practical and Legal Reasoning in International Relations and Domestic Affairs*”, Kembrixh: Cambridge University Press.
32. Kruja, G. (2008). *Shqiptarët përballë sfidave të mirëkuptimit ndërjetar*. Tiranë: Arbëria
33. Mata, Ruxhdi; *At Shtjefen Gjeçovi, Jeta dhe Vepra*; SHBLSH, Tiranë 1982
34. Merdani, Arlinda; *Mardhëniet ndërjetare në Shqipëri, Prespektiva të reja për Bashkimin Europian*; Onufri, Tiranë 2014
35. Morozzo della Rocca, Roberto (1994) *Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944*. Tiranë: Elena Gjika -
36. Maalouf, A. (2001). *Identitete vrastare*. Tiranë: Onufri.
37. Noli, Fan S.; *Ligjërime (1906 - 1964)*; përgatiti Nasho Jorgaqi; DUDAJ, Tiranë 2002
38. Nosi, Lef; Dok. Nr. 2, *Dokumenta Historike 1912-1920*; Tiranë 2007

39. Onuf, Nicholas (1989), “*World of Our Making: Rules and Rule in Social Theory and International Relations*”, Columbia SC: University of South Carolina Press.
40. Popoviç, Alexandër; *Islamizimi Ballkanin*; Dituria, Tiranë 2006
41. Popper, Karl (1966). *The Open Society And Its Enemies*. London: Routledge, vol 1-2.
42. Qemali, Ismail; *Kujtime*; Toena, Tiranë 2009
43. Shqarri, Muharrem; *Atdhetari Sheh Hamid Kraja*; OMBRA GVG, Tiranë 2014, f. 85
44. Xhelili, Qazim; *Vehbi Dibra – personalitet dhe veprimtar i shquar i lëvizjes kombëtare*; Albin, Tiranë, 1998
45. Wendt, Alexander (1999), “*Social Theory of International Politics*”, Kembrixh: Cambridge University Press.
46. Kleger / Müller (1985), p. 47 sq.
47. Anter, A. (2003) : « Charisma und Anstaltsordnung. Max Weber und das Staatskirchenrecht seiner Zeit », in : Lehmann, H. / Ouédraogo, J. M. (éd.) : *Max Webers Religionssoziologie in interkultureller Perspektive*, Göttingen : Vandenhoeck-Ruprecht, p. 29-49.
48. Assmann, J. (2000) : *Herrschaft und Heil. Politische Theologie in Altägypten, Israel und Europa*, München : Hanser.
49. Durkheim, E. (1895) : *Les Règles de la méthode sociologique*, Paris : Alcan.
50. Forst, R. (2003) : *Toleranz im Konflikt : Geschichte, Gehalt und Gegenwart eines umstrittenen Begriffs*, Francfort-sur-le-Main : Suhrkamp.
51. Kallscheuer, O. (2003) : « Papismus und Internationalismus : Zur Rolle des Vatikan in der Weltpolitik », in : Minkenbergh, M. / Willems, U. (éd.) : *Politik und Religion*, Wiesbaden : Westdeutscher Verlag, p. 523-542.
- 52.** Strayer, J. R. (1958) : « The State and Religion : An Exploratory Comparison in Different Cultures. Greece and Rome, the West, Islam », *Comparative Studies in Society and History*, 1, p. 38-43.
53. Hysamedin Feraj, *Skice e mendimit politik*, Logos 2011
54. Enis Sulstrova, “Arratisje nga Lindja”, 2006
- 55.** Canefe, Nergis. 2004. “Foundational Paradoxes of Balkan Nationalisms – Authenticity, Modernity and Nationhood (Last accessed: July 5, 2006).
56. Chakrabarty, Dipesh. 2000. *Provincializing Europe: Postcolonial Thought and Historical Difference*. Princeton, NJ: Princeton University Press.
57. Kadare, Ismail. 2006. *Identiteti evropian i shqiptarëve*. Tirana: Onufri.

58. Fleming, K.E. 2000. "Orientalism, the Balkans, and Balkan Historiography." *American Historical Review*, Vol. 105, No. 4.
59. Arendt, H. (1964), *Eichmann in Jerusalem: A Report on the Banality of Evil* (New York: Viking).
60. Aristotle (1984), *The Complete Works of Aristotle: The Revised Oxford Translation*, edited by J. Barnes (Princeton NJ: Princeton University Press).
61. Asad, T. (1993), *Genealogies of Religion: Discipline and Reasons of Power in Christianity and Islam* (Baltimore MD: Johns Hopkins University Press).
62. Ashley, R. (1989), 'Living on Boarder Lines: Man, Poststructuralism and War', in J. Der Derian and M. Shapiro (eds.), *International/Intertextual Relations: Postmodern Readings of World Politics* (Lexington KY: Lexington Books), 259-322.
63. Baghwati, J. (2004), *In Defence of Globalization* (Oxford: Oxford University Press).
64. Ball, T. (2004), 'History and the Interpretation of Texts', in G. Gaus and C. Kukathas (eds), *Handbook of Political Theory* (London: Sage Publications).
65. Bensmaia, R. (2003), *Experimental Nations: Or, the Invention of the Maghreb* (Princeton NJ: Princeton University Press).
66. Bernstein, R. (1979), *The Restructuring of Social and Political Theory* (London: Methuen).
67. Bhabha, H. (1994), *The Location of Culture* (New York: Routledge).
68. Edward Carr (1987), *What Is History?*, 2nd edn (London: Penguin).
69. Checkel, J. T. (1999), 'Social Construction and Integration', *Journal of European Public Policy*, 6/4: 545-60.
70. Collins, R. (1975), *Conflict Sociology: Towards an Explanatory Science* (New York: Academic).
71. Collins, R. (1998), *The Sociology of Philosophies: A Global Theory of Intellectual Change* (Cambridge MA: Belknap).
72. Rorty, R. (1967) (ed.), *The Linguistic Turn* (Chicago: University of Chicago Press).
73. Cassidy, Edward. *Ecumenism and Interreligious Dialogue*. New York: Paulist Press, 2005.
74. Dawe, Donald and Carman, John, eds. *Christian Faith in a Religiously Plural World*. New York: Orbis Books, 1978.
75. Dinoia, J.A. *The Diversity of Religions*. Washington: Catholic University of America Press, 1992.
76. Dunne, John. *The Way of All the Earth*. Notre Dame: Notre Dame University Press, 1978.
77. Griffin, David Ray. *Deep Religious Pluralism*. Louisville: Westminster/John Knox, 2005.

78. Griffiths, Paul, ed. *Christianity through Non-Christian Eyes*. New York: Orbis Books, 1990.
79. Haight, Roger. "Catholic Pluralism on Religious Pluralism" in *The Future of Christology*. New York: Continuum, 2005, 103-22.
80. Hick, John. *A Christian Theology of Religions*. Louisville: Westminster: John Knox, 1995.
81. Netland, Harold. *Encountering Religious Pluralism: The Challenge to Christian Faith and Mission*. Downers Grove, IL: Inter Varsity Press, 2001.
82. Race, Alan. *Christian and Religious Pluralism*. London: SCM Press, 1963.
83. Rahner, Karl. "Christianity and Non-Christian Religions," *Theological Investigations*. Baltimore: Helicon, 1966, V, 115-35.
84. Smith, Wilfred Cantwell. *Religious Diversity*. Ed. Willard Oxtoby. New York: Harper and Row, 1976.

### **Burime arkivore**

1. A.Q.SH. Fondi 482, Dosja, 14, viti 1925, f. 191
2. A.Q.SH. Fondi *Qeverisë së Përkohshme e Vlorës*, Dosja III, 5/2, fleta 632
1. Kultura Islame; viti 1944, "Tirana", Tiranë 1942
2. Kultura Islame; viti 1942, "Tirana", Tiranë 1944
3. Përilindja e Shqipëniës; Vlorë 1913
4. Përilindja e Shqipëniës; Vlorë 1914
5. Udha e s'Vërtetës; viti parë, nr. 2, "Ora" Shkodër, Tetor 1923
6. Zani i Naltë; viti 1923, "Mbrothësia", Tiranë 1923
7. Zani i Naltë; viti 1927, "Ora", Shkodër 1927
8. Zani i Naltë; viti 1928, "Ora", Shkodër 1928
9. Zani i Naltë; viti 1932, "Ora", Shkodër 1932
10. Zani i Naltë; viti 1935, "Ora", Shkodër 1935
11. Zani i Naltë; viti 1936, "Ora", Shkodër 1936
12. Zani i Naltë; viti 1938, "Ora", Shkodër 1938

## SHTOJCË 1

### Fjalorth terminologjik

**Arqipeshkvi** - Klerik i lartë katolik që drejton punët fetare të një vendi, të një krahine, të një qarku.

**Ateizmi** – nje sistem pikepamjesh te cilat mohojne cdo ekzistence te perendise dhe eshte kunder gjithe besimeve fetare.

**Besim fetar** – pranimi i teologjise fetare nga individi apo grup individesh dhe aderimi i tij apoi tyre ne ate besim fetar, i cili njihet ne menyre zyrtare.

**Bashkëjetesa fetare** - Jetesha bashkë e besimeve të ndryshme në Shqipëri.

**Dogma** – nje teze themelore e nje besimi fetar te caktuar, e cila pranohet nga besimtarët e atij komuniteti, qe perfaqeson kete besim fetar.

**Dhespot** - Titull fetar në kishën ortodokse ndërmjet priftit dhe mitropolitit, peshkop; ai që mban këtë titull, kryetar i një dioqezë ortodokse.

**Feja** –marredhenie shpirtërore praktike e personit me boten, e cila lidhet me ide te mbinatyrshe. Shpesh njerezit kur thone fe, nenkuptojne ekzistencen e perendise. Feja është nje sistem mendimi, ndjenje, dhe veprimi që ushtrohet nga një grup dhe që u jep anëtarëve një synim përkushtimi; një normë e sjelljes nga e cila individët mund të gjykojnë pasojat vetjake dhe shoqërore të veprimeve të tyre; dhe një model drejtues me të cilin individët mund të lidhen me grupin e tyre dhe gjithësinë e tyre.

**Fetishizim** – nderimi ose adhurimi i sendeve, jofrymore.

**Fondamentalizëm** – prirje regresive qe mbeshitet kryesisht te dhuna ne te gjitha fomat dhe qe synon ruajtjen me fanatizem te te gjitha parimeve te besimit fetar, qe perfaqeson.

**Harmonia fetare** - Mirëkuptimi, marrëdhënie miqësore e të ngrohta ndërmjet besimeve fetare të ndryshme.

**Haxhi**- Titull që u jepet besimtarëve myslimanë të cilët kryejnë ritualet në vendin e “Shenjtë”, Meka.

**Hoxhë** –Titull që u jepet klerikëve myslimanë; ai që ka këtë titull, që vishet me xhybe e me çallmë dhe kryen shërbimet fetare.

**Hytbet** –ligjërim fetar periodik (javor).

**Islamizim** – Perhapja dhe shtrirja e fese islame.

**Katolik**- besimtari praktikant i besimit të krishterë.

**Kombesia** - bashkësi të qëndrueshme njerëzish që është formuar historikisht gjatë shthurjes së mardhënieve fisnore në bazë të bashkësisë së gjuhës, të territorit e të kulturës, e cila ka ardhur duke u zhvilluar dhe duke u forcuar.

**Komuniteti fetar** – nje grup njerëzish, te cilet respektojnë dhe pranojnë te aderojnë ne te nejtin besim fetar dhe qe, drejtohen nga nje qender organizative fetare, e cila eshte e njohur me ligj nga shteti dhe zakonisht perkrahet prej tij.

**Komuniteti Musliman Shqiptar**- Organi më i lartë i fesë Islame në Shqipëri - **KMSH**

**Kryemyftiu**- I pari i myftinjve të një vendi

**Laik** – ai njeri, i cili nuk ka sens fetar, s'ka permbajtje fetare, s'merret me probleme fetare apo me vete fene dhe qe nuk i perket klerit apo fese te cfaredolloj besimi.

**Medrese** -Shkollë e mesme për të përgatitur hoxhallarë e myderrizë.

**Monoteizmi** – Besimi në një perëndi të vetme; fe a dogmë fetare që predikon se krijuesi i botës është një zot i vetëm; (.Mono=nje, theos=Zot, pra besimi ne nje Zot).

**Musliman** – besimtari praktikant i besimit islam

**Myfti** – Klerik i lartë musliman që drejton punët fetare të një vendi, të një krahine, të një qarku

**Nacionalizmi**- Ideologjinë apo pikpamjen që sipas të cilës një komb quhet më epror ndaj kombeve të tjera.

**Ortodoks**- besimtari praktikant i besimit ortodoks.

**Politeizmi/Paganizmi** – besimi ne ekzistencen e shume perendive.

**Prift katolik**-Titulli fetar më i thjeshtë në kishën e krishterë; ai që mban këtë titull dhe kryen shërbesat e zakonshme fetare

**Prift Ortodoks**- Titulli fetar më i thjeshtë në kishën ortodokse; ai që mban këtë titull dhe kryen shërbesat e zakonshme fetare

**Sekt fetar** – Grup i vogël besimtarësh me një dogmë të veçantë, që janë shkëputur nga një bashkësi e madhe fetare ose që dallohen brenda saj. Sektet fetare. Sekti bektashian. Sekte heretike.

**Shtet laik** – Shteti në të cilin ka një ndarje të qartë mes shtetit dhe fesë

**Tarikat** – kjo fjalë misticizmen islame do të thote: ruge, rend, vellazeri, pjese e shkeputur nga trungu i besimit islam.

**Toleranca fetare-** Toleranca fetare është qëndrimi miqësor dhe i paanshëm ndaj besimeve dhe praktikimeve fetare të panjohura.

**Vazë-** Predikim Fetar në ditën e Xhumasë/ Premtes

**Xhami** - Ndërtesë ku bëhen shërbesat sipas riteve fetare të myslimanëve, faltore e myslimanëve (në vendet ku vepron feja islame).

**Zani i Naltë** –Revistë Periodike e Komunitetit Musliman Shqiptar - **ZN**

## SHTOJCË 2

### Papa Françesku përshëndet Shqipërinë si model i harmonisë fetare

Papa gjatë një vizite një-ditore në Shqipëri, në të cilën ai mbajti në vend të vogël ballkanik si një model i harmonisë fetare. Në atë që u interpretua si një referencë ndaj sundimeve të egëra, tha papa 77-vjeçar të dielën se askush nuk duhet të përdore Zotin si një "mburojë" me që për të justifikuar "aktet e dhunës dhe shtypjes".

Në udhëtimin e tij të parë evropian jashtë Italisë, dhe e tij të parë në një vend me shumicë myslimane, Papa tha se "Fryma autentike fetare është duke u çoroditur" në shumë pjesë të botës dhe se "dallimet fetare janë duke u shtrembëruar dhe të manipuluar".

Vatikani tha se Papa kishte zgjedhur për të vizituar Shqipërinë relativisht e panjohur, sepse ai donte të nxirrte në pah harmoninë midis të krishterëve dhe myslimanëve, në një kohë kur perplasjet dhe terrori janë kthyer në mankth.

Gjatë një fjalimin në pallatin presidencial, tha se ben kontrast të lartë intoleranca fetare në pjesët e tjera të botës me shembullin e Shqipërisë, një vend me tre milionë banorë, ku rreth 60 për qind janë myslimanë, 15 për qind katolikë dhe pjesën tjetër të krishterë ortodoks.

"Ka një karakteristikë mjaft të bukur e Shqipërisë, një që më jep gëzim të madh: Unë jam duke iu referuar të bashkëjetesës paqësore dhe bashkëpunimin që ekziston në mes të ndjekësve të feve të ndryshme," tha Papa gjatë vizitës së tij një-ditore në një vend ballkanik, ku feja u shtyp për dekada të tëra nga diktatori Enver Hoxha.

"Klima e respektit dhe besimit të ndërsjellë në mes të katolikëve, ortodoksëve dhe myslimanëve është një dhuratë e çmuar për vendin", tha ai.

Burra të moshuar veshur kapele të bardha qëndronin në krah të grave veshur me kostume të qëndisura, dhe se si katolikët që kishin udhëtuar nga Maqedonia fqinje, Kosova dhe Mali i Zi të cilët tundnin flamujt e tyre kombëtarë.

Ishte një fotolajm gjatë mesazhit të Papës mbi tolerancën fetare, kur një njeri ka mbajtur një pankartë ku shkruhej "Unë e dua Biblën dhe Kuranin, sepse unë jam shqiptar."



### SHTOJCË 3

#### Raporti i mbi Lirinë Fetare Ndërkombëtare – Albania 2014

##### *Përmbledhje*

Kushtetuta garanton lirinë e ndërgjegjes dhe të fesë dhe thekson se gjithkush është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet. Qeveria miratoi një ligj që lejon bashkësitë fetare për të ndërtuar dhe menaxhuar varrezat e tyre fetare. Qeveria ka bërë pak përparim në adresimin e kërkesave nga grupet fetare për kthimin apo kompensimin e pronave të marra gjatë ish epokës komuniste, dhe shumë prej kërkesave pronësore mbetën të pazgjidhura. Mosmarrëveshjet pronësisë bërë të vështirë për disa grupe fetare për të blerë tokë të re në të cilën për të ndërtuar vende adhurimi.

Nëpërmjet Këshillit Ndërfetare të Shqipërisë, udhëheqësit e myslimanëve suni, ortodoksë, katolikë, protestantë, dhe komuniteteve bektashiane diskutuan shqetësimet e përbashkëta dhe lëshuan deklaratatë të përbashkëta publike mbi një sërë çështjesh që prekin komunitetet fetare.

Zyrtarët amerikanë ambasada vazhdoi të kërkojë qeverisë që të trajtojë pretendime për prona fetare dhe kthehen në grupet fetare në ndërtesat, toka, dhe prona të tjera të konfiskuara gjatë kohës së komunizmit. Përmes një programi të edukimit qytetar, zyrtarët e ambasadës vizitoi islame, katolike dhe shkolla fetare ortodokse, shkollat e mesme publike, dhe institucionet e tjera arsimore për të promovuar lirinë dhe tolerancën fetare.

##### *Seksioni I: Demografia Fetare*

Qeveria e SHBA vlerëson popullsinë e përgjithshme në 3 milion (korrik 2014 vlerësim). Gati 20 për qind e të anketuarve nuk pranoi të përgjigjet në pyetjen opsionale mbi përkatësinë fetare në regjistrimin e fundit në vitin 2011. Sipas këtij regjistrimit, myslimanët sunitë përbëjnë afro 57 për qind të popullsisë, katolikët 10 për qind, të krishterët ortodoksë (Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipëria) gati 7 për qind, dhe bektashinjtë (një

formë e sufizmit shiit) 2 përqind. Grupet e tjera aktuale përfshijnë besimeve të ndryshme protestante, si dhe Bahá'í, Dëshmitarët e Jehovahit, Kishën e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme (Mormonët), dhe një komunitet të vogël hebre. Komiteti Shtetëror për Kultet raporton rreth 230 grupe fetare, organizata, fondacione dhe institucione arsimore që veprojnë në vend.

## ***Seksioni II Statusi i Respektimit nga Qeveria për Lirinë Fetare***

### *Kuadri ligjor*

Kushtetuta thotë se nuk ka fe zyrtare dhe të gjitha fetë janë të barabarta. Kushtetuta garanton lirinë e fesë dhe thotë gjithkush është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet e tij saj apo dhe t'i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në jetën publike apo private. Kushtetuta gjithashtu thotë askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohet të marrë pjesë në një bashkësi fetare ose në praktikat e saj, ose për të bërë bindjet e tij ose të saj ose publike besimin.

Sipas ligjit, Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi pranon dhe procedon ankesave për diskriminim, duke përfshirë edhe ato në lidhje me praktikën fetare. Ligji specifikon Komitetit Shtetëror të Kulteve, nën juridiksionin e zyrës së kryeministrit, rregullon marrëdhëniet midis qeverisë dhe grupeve fetare, mbron lirinë e fesë, dhe promovon bashkëpunimin dhe mirëkuptimin ndërfaqetare. Ligji gjithashtu drejton komitetin për të ruajtur të dhënat dhe statistika për grupet e huaja fetare që kërkojnë ndihmën e saj, dhe për të ndihmuar punonjësit e huaj të grupeve fetare në marrjen e lejeve të qëndrimit.

Qeveria nuk kërkon regjistrim apo licensim të grupeve fetare. Çdo grup fetar mund të fitojë status zyrtar duke u regjistruar me Gjykatën e Rrethit Tiranë si shoqatë jofitimprurëse. Procesi i regjistrimit përfshin dorëzimin e informacionit mbi formën dhe qëllimin e organizatës, objektivat e aktivitetit të saj, identitetet e themeluesve të organizatës dhe përfaqësuesve ligjorë, strukturat drejtuese dhe mënyrën e tyre të operimit, një adresë në të cilën organizata mund të arrihet, dhe pagesën e një tarife 1,000 lekë (\$ 9) deri Gjykatën e Rrethit Tiranë. Një gjyqtar caktohet rastësisht brenda 3-4 ditëve nga data e paraqitjes së

aplikacionit dhe procesi zakonisht përfundon brenda një seancë. Regjistrimi i jep grupeve fetare të drejtën të mbajnë llogari bankare, prona e vet, dhe për të marrë disa shkallë të statusit të përjashtimeve tatimore.

Në korrik, qeveria miratoi një ligj që lejon bashkësitë fetare për të ndërtuar dhe menaxhuar varrezat fetare në vendin që komunitetet zotërojnë.

Sipas ligjit, shkollat publike janë shekullare dhe ligji ndalon mësimin fetar në to. Sipas shifrave zyrtare, grupet fetare, organizatat dhe fondacionet kanë 125 shoqata e fondacione lidhur menaxhimin 103 institucionet arsimore. Sipas ligjit, Ministria e Arsimit dhe Sportit duhet të licencojë këto shkolla, dhe kurrikula jo-fetare duhet të jenë në përputhje me standardet kombëtare të arsimit.

#### *Praktikat e Qeverisë*

Qeveria rriti mbështetjen financiare në buxhet për komunitetet katolike, myslimane, ortodokse dhe bektashiane. Ajo parashikon mbështetje financiare të këtyre grupeve dhe hartoi një ligj të veçantë, vazhdoi të mos sigurojë mbështetje financiare për organizatat.

Edhe pse nuk ka pasur ndalesa ligjore kundër veshjeve apo simboleve fetare, drejtorët e shkollave ruajturi të drejtën për të vendosur standardet për "veshjen e përshtatshme," e cila në disa raste përfshinte kufizime ndaj ekspozimit publik të simboleve fetare.

Gjatë vitit, tre ankesa të tjera të diskriminimit mbi bazë të përkatësisë fetare janë bërë të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në një rast, që përfshin një pretendim nga një punonjëse femër në shërbimin postar se ajo ishte shkarkuar nga puna e saj, sepse ajo rregullisht ka marrë kohë nga puna e saj për t'u lutur në një xhami, komisioneri vendosi shkarkimin e punonjësit nuk ishte bazuar në besimin fetar, por për mangësitë në punën e saj.

Qeveria vazhdoi të trajtonte pretendimet nga grupet fetare lidhur me kthimin apo kompensimin e pronave të marra gjatë ish epokës komuniste; megjithatë, shumë pretendime pronësore mbetën të pazgjidhura. Agjencia Shtetërore për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave u kërkohet me ligj për t'i dhënë përparësi pronave të zotëruara nga grupet fetare, por grupet fetare raportuan se përparimi ishte i ngadaltë. Në disa raste, qeveria ofroi grante tokës në vend të kthimit të pronës. Sfidat administrative dhe ligjore të lidhura me

pretendimet pronësore është bërë kthimi i pronës të vështirë për individët dhe organizatat, përfshi grupet fetare. Gjatë vitit, qeveria përfundoi kthimin e katër pronave të Kishës Ortodokse nëpërmjet procesit të kthimit. Qeveria ka restauruar gjithashtu një pronë të Kishës Katolike, dhe kompensohet komuniteti mysliman në Shkodër për një pronë.

Gjatë vitit, negociatat vazhduan të zgjidhnin një rast të 2013, në të cilën përmbartesit privatë të punësuar nga qyteti i Përmetit kanë hequr me forcë disa anëtarë të klerikëve ortodoksë dhe objekte fetare nga një pronë e kontestuar.

Në nëntor, qeveria i dha Komunitetit Musliman Shqiptar një leje për të ndërtuar një xhami të re qendrore në Tiranë .

Qeveria u zotua për të financuar përfundimin e një vendi kulti për komunitetin bektashian, ndërtimi i të cilit ishte shtyrë për arsye financiare. Në tetor, qeveria ka filluar shperndarjen e fondeve për komunitetin bektashian.

### ***Seksioni III: Statusi i Respektimit nga Shoqëria për Lirinë Fetare***

Kur feja dhe etnia janë të lidhura ngushtë në disa raste, është e vështirë të kategorizohen disa incidente si të bazuar vetëm në identitetin fetar. Kryepiskopi Anastas, kreu i Kishës Ortodokse Autoqefale të Tiranës, Durrësit dhe të gjithë Shqipërisë, u përball me disa kritika shoqërore drejtuar në origjinën e tij greke dhe kombësinë.

Udhëheqësit fetarë shpesh morën pjesë në festimet e komuniteteve të tjera fetare, si një shenjë respekti. Në shtator krerët e pesë komuniteteve të mëdha fetare kanë marrë pjesë në meshën e mbajtur nga Papa Françeskut dhe u takua me të gjatë vizitës së tij në Tiranë.

### ***Seksioni IV: Politika e Qeverisë së SH.B.A.***

Zyrtarët e Ambasadës Amerikane vazhduan të nxisnin qeverinë që të trajtonte pretendimet për prona fetare dhe kthehen në grupet fetare në ndërtesat, toka, dhe prona të tjera të konfiskuara gjatë kohës së komunizmit. Ambasadori dhe zyrtarë të tjerë e shpesh kanë angazhuar udhëheqësit fetarë dhe anëtarët e komunitetit, veçanërisht nga musliman suni, bektashiane, katolike, ortodokse, dhe bashkësive protestante, në ngjarje të tilla si iftari

vjetor i Ambasades, ku Ambasadori theksoi vlerën e tolerances fetare. Zyrtarët amerikanë vizituan kisha, xhami dhe objekte fetare gjatë gjithë vitit për t'u angazhuar me komunitetet gjatë pushimeve lokale fetare dhe diskutuan tolerancën fetare dhe sfidat e komuniteteve.

Për të publikuar rëndësinë e angazhimit të komunitetit në promovimin e tolerancës fetare, ambasada organizoi një ceremoni në shtator për të nderuar muslimanet dhe banorët katolikë të fshatit Malbardhë për bashkëpunimin e tyre në ndërtimin e një kishë të re për komunitetin katolik.

Në korrik ambasada organizoi dhe financoi udhëtimin e Baba Edmond Brahimaj ("Baba Mondit"), kreu i rendit botëror Bektashi e sufizmit, për t'u takuar me zyrtarë të lartë të Departamentit të Shtetit të SHBA për të diskutuar mbi çështjet e lirisë fetare.

Në janar të Ditës Përkujtimore të Holokaustit, ambasada organizoi një diskutim ndërfaqësor në mes të studentëve dhe përfaqësuesve të besimit islam dhe komunitetet katolike mbi rëndësinë e tolerancës në dritën e Holokaustit.